VULLNETARIZMI NË SHQIPËRI

STUDIM KOMBËTAR

Financuar nga LevizAlbania

Në projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Përgatitën studimin:
Oltiana Rama
Armela Xhaho

Redaktoi: Miranda Goleci
Design: M&B Botime dhe Studio Grafike
Tiranë, Shqipëri 2021

ISBN: 978-9928-353-16-0
© Autorët & "Projekte Vullnetare Ndërkombëtare"

Ky botim u realizua nga "**Projekte Vullnetare Ndërkombëtare**" në kuadër të projektit strategjik "**VullnetarizmiPikëAL**", mbështetur nga "**LëvizAlbania**", projekti i **Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC.**

Mendimet dhe opinionet e shprehura në të u përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

Botuar: M&B Botime dhe Studio Grafike
Rruga "Isa Boletini", Nd.2, H.12, Nj.A.nr.9, 1017, Tiranë
Tel. 069 20 68 603 068 65 08 441
E-mail: mbbotime@gmail.com

Printuar: M&B Botime dhe Studio Grafike, maj 2021.

Tabela e lëndës

Përmbledhje 5
Shkurtime/Akronime 9
Konceptet 11

I. HYRJE 15
II. VULLNETARIZMI: PERCEPTIMET, VLERAT DHE PËRFITIMET INDIVIDUALE E SHOQËRORE 19
2.1 Shprehja e vullnetarizmit dhe përfitimet shoqërore 20
2.2. Impakti i vullnetarizmit në nivel individual 21
2.3 Kuadri rregullator ndërkombëtar mbi vullnetarizmin 22

III. VULLNETARIZMI NË SHQIPËRI 25
3.1 Konteksti 26
3.2. Kuadri rregullator dhe institucional mbi vullnetarizmin 29
3.2.1 Kuadri ligjor kombëtar mbi vullnetarizmin 29
3.2.2 Kuadri strategjik mbi vullnetarizmin 30
3.2.3 Kuadri institucional mbi vullnetarizmin 31

IV. METODOLOGJIA 33

V. RAPORTIMI I GJETJEVE TË STUDIMIT 37
Të dhënat demografike 38
5.1 Njohuri të përgjithshme dhe perceptimet rreth vullnetarizmit 41
5. 1.1 Perceptimi dhe koncepti i i vullnetarizmit 41
5.1.2 A është i nevojshëm kontributi vullnetar në Shqipëri? 43

5.1.3 Përfitimet nga kontributi vullnetar 46
5.1.4 Njohuritë mbi mundësitë për të ofruar kontribut vullnetar 50
5.1.5 Njohuritë rreth Ligjit të Vullnetarizmit dhe Librezës së Vullnetarit 53
5.2 Eksperiencat, trendet dhe preferencat për kontribut vullnetar 54
5.2.1 Eksperiencat vullnetare 54
5.2.2 Tendenca për kontribut vullnetar në 12 muajt e ardhshëm 57
5.2.3 Vullnetarizmi digjital trend dhe/apo domosdoshmëri? 62
5.3. Sfidat e vullnetarizmit në Shqipëri 64
5.4. Disa praktika dhe eksperienca pozitive të ofruesve të vullnetarizmit 72
5.4.1 Vullnetarizmi në institucionet vendore dhe qendrore 72
5.4.2 Vullnetarizmi në organizata të shoqërisë civile 73
5.4.3 Vullnetarizmi në qendrat komunitare 76
5.4.4 Disa praktika pozitive 77
5.5 Si mund të motivohen vullnetarët dhe ofruesit e vullnetarizmit? 82
5.6 Perspektiva dhe nxitja e vullnetarizmit 85

VI. Përfundime 91

Rekomandime 97

Referencat 103

Shtojca 1: Pyetësori 108
Shtojca 2: Fokus grupet 117
Shtojca 3: Intervistat 120

PËRMBLEDHJE

Ky studim ofron një analizë sasiore dhe cilësore rreth perceptimeve, sfidave dhe preferencave të qytetarëve përkundrejt angazhimit vullnetar, duke analizuar, gjithashtu, sfidat dhe mundësitë e ofruesve të vullnetarizmit në Shqipëri, si dhe institucioneve politikëbërëse në vend. Vullnetarizmi konsiderohet si një forcë shtytëse për zhvillimin dhe kohezionin social e, nga ana tjetër, vullnetarët janë dhe duhen konsideruar si aktorë kyçë për progres shoqëror dhe fuqizim të komunitetit.

Ky studim nxori në pah se vullnetarizmi perceptohet si një detyrim moral, shoqëror dhe personal në dobi të komunitetit, dhe një dëshirë e pakushtëzuar që buron nga vetë individi dhe nevoja për të qenë i dobishëm në komunitet. Perceptimi i vullnetarizmi ndryshon krahasuar me moshën: mosha e mesme dhe mosha e tretë e lidh atë me të shkuarën, ndryshe nga të rinjtë, të cilët nuk gjejnë aspak lidhje me të. Ky evoluim i konceptit të vullnetarizmit reflektohet me përqasjen pozitive dhe të kuptuarit e rëndësisë së vullnetarizmit si nga qytetarët, ashtu dhe nga institucionet. Pjesa më e madhe (77%) besojnë se kontributi vullnetar në Shqipëri është shumë i nevojshëm, edhe pse nuk kanë mjaftueshëm njohuri në lidhje me institucionet që mund të ofrojnë mundësi dhe hapësirë për kontribut vullnetar.

Megjithatë, studimi tregoi se tendenca për kontribut vullnetar janë në rritje, rreth 68% e qytetarëve duan të japin kontributin e tyre vullnetar në 12 muajt e ardhshëm, ndonëse për një periudhë relativisht të shkurtër kohore. Disa nga targetgrupet më të përzgjedhura të cilët do të dëshironin të jepnin kontributin vullnetar, nga pjesëmarrësit në studim ishin banorët e komunitetit/lagjes, fëmijët dhe të rinjtë, minoritetet, persona në vështirësi ekonomike dhe të moshuarit. Nga të dhënat vihet re tendenca dhe interesi i vullnetarëve që duan të ofrojnë shërbimin dhe kontributin e tyre është më i lartë në komunitet (46.7%), duke vijuar me preferencat në shkolla (25.2%) dhe së treti në qendrat rinore dhe sociale me 11.8%.

Mënyrat e angazhimit të vullnetarëve nga ofruesit e vullnetarizmit janë kryesisht me bazë projektesh apo forma spontane afatshkurtra të organizimit. Edhe pse, në përgjithësi, ka interes për t'u përfshirë në punë vullnetare, nuk ka orientim nga institucionet dhe angazhimi apo procedurat e rekrutimit apo organizmit mbeten krejtësisht *ad hoc*. Tendencat për vullnetarizmin digjital janë në rritje, veçanërisht gjatë krizës së pandemisë, duke e konsideruar atë sa nevojë, aq dhe trend, rreth 73 % e qytetarëve mendojnë se është domosdoshmëri.

Për më tepër, studimi tregon në mënyrë shumë evidente dhe vullnetin e ofruesve të vullnetarizmit (OSHC, pushteti vendor, qendra të shërbimit ditor etj.,) për të nxitur dhe qenë ofrues potencialë, të organizuar dhe bashkëpunues në fushën e vullnetarizmit, ndonëse secili aktor përballet me një sërë sfidash që duhen tejkaluar.

Vullnetarizmi në Shqipëri përballet më një sërë sfidash institucionale, ligjore, praktike, strukturore, individuale etj. Vështirësia kryesore është mungesa e një mekanizmi në nivel kombëtar apo qendror, që të organizojë, orientojë dhe mobilizojë qytetarët që duan t'i vijnë në ndihmë komunitetit në situata të tilla, por jo vetëm. Gjithashtu, disa sfida të tjera kryesore që institucionet përballen janë: mungesa e eksperiencave dhe kapaciteteve të institucioneve që ofrojnë vullnetarizëm, mungesa e informacionit dhe ndërgjegjësimi i ulët mbi mundësitë e vullnetarizmit dhe koordinim jo fort i mirë mes institucioneve. Infrastruktura jo e duhur ligjore, strukturore dhe burokracia e institucioneve bëhet shpeshherë pengesë për organizatat joqeveritare, të cilat konstatojnë se ekziston, në përgjithësi, një klimë jofavorizuese dhe burokratike.

Miratimi i "Ligjit të Vullnetarizmit" në vitin 2016 vlerësohet si një nismë e mirë. Ky ligj mbron vullnetarët dhe sektorin, por zbatimi efektiv i ligjit në praktikë përballet me shumë sfida. Pjesa më e madhe e të anketuarve (87%) nuk janë në dijeni të ekzistencës së librezës së vullnetarit dhe një pjesë e konsiderueshme (2/3) nuk kanë informacion as për Ligjin mbi Vullnetarizmin. Gjithashtu, mungesa e informacionit mbi ligjin dhe librezën është shumë evident edhe tek ofruesit e vullnetarizmit e, ndërsa ata që kanë njohuri bien dakord se në aspektin praktik ligji sjell pengesa në praktikë, organizatat e kanë shumë të vështirë të paguajnë sigurimet shëndetësore për vullnetarët. Ligji ka nevojë të përshtatet për të qenë më gjithëpërfshirës, të adresojë të gjitha llojet/format e vullnetarizmit dhe të jetë i zbatueshëm dhe më fleksibël. Të gjithë aktorët, pjesë e studimit, bien dakord se duhet të ngrihen grupe pune për të përmirësuar si kuadrin ligjor, ashtu dhe atë programatik, për të përmirësuar infrastrukturën e vullnetarizmit në vend.

Studimi nxjerr të dhëna se mungojnë praktika të mirëfillta dhe të mirëorganizuara të rekrutimit, orientimit, menaxhimit dhe vlerësimit të vullnetarëve si nga institucionet qendrore, vendore, ashtu dhe ofruesit e vullnetarizmit, përfshirë këtu OSHC, qendra ditore, komunitare etj. Sigurisht, rast pas rasti ka disa institucione dhe OSHC që kanë praktikat e veta që rezultojnë pozitive, veçanërisht këto praktika vijnë nga organizata të mëdha në vend si World Vision në Shqipëri apo organizata të cilat punojnë me vullnetarë europianë, ndërkombëtarë apo me Korpusin e Paqes. Shumë prej tyre kanë adaptuar apo ndjekin procedurat dhe protokollet e këtyre programeve, të cilat mund të jenë shumë efektive dhe lehtësisht të përdorshme dhe për organizatat lokale të cilat nuk kanë procedura dhe praktika të standardizuara. Rastet e emergjencave civile si tërmeti në 2019 dhe më pas kriza e pandemisë COVID-19 nxori në pah një mobilizim shumë të lartë qytetar, dëshirë dhe gatishmëri për të dhënë kontribut vullnetar nga ana e qytetarëve, ashtu dhe sektorit të shoqërisë civile. Kjo është një praktikë pozitive dhe një tregues shumë i mirë i vullnetit qytetar, por nga ana tjetër këto raste na treguan se ka nevojë për praktika më të mira rregulluese dhe koordinuese nga ana e institucioneve dhe sektorit të shoqërisë civile për të ofruar infrastrukturë më të sigurt për vullnetarët.

Diskutim shumë i gjerë gjatë fokus grupet është se kush dhe si duhet të nxisë, koordinojë dhe menaxhojë shërbimet vullnetare. Institucionet publike qendrore dhe vendore, si dhe ato të edukimit, mendoj se OSHC kanë rol kyç dhe me shumë eksperiencë krahasuar me institucionet publike apo private, por nga ana tjetër OSHC

argumentojnë se përballen me sfida të bashkëpunimit ndërsektorial, barriera ligjore dhe burokratike, ndërgjegjësim dhe vlerësim i ulët i konceptit dhe kontributit vullnetar nga institucionet politikëbërëse, si dhe vështirësi të qëndrueshmërisë financiare, ndaj e kanë shumë të nevojshëm bashkëpunimin dhe mbështetjen ndërinstitucionale. Studimi tregon se 27.9 % e qytetarëve mendojnë se rol kyç në nxitjen e vullnetarizmit luajnë vetë individët, 22.6 % OSHC-të, 22.5 % pushteti vendor, duke vijuar më pas me rolin e pushtetit qendror (15.4%) dhe medias (11.6 %). Duke marrë në konsideratë gjithë gjetjet, qëndrimet, eksperiencat dhe modelet e vendeve të ndryshme, del në pah se nxitja dhe zhvillimi i vullnetarizmit kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, ka nevojë për bashkëpunim ndërsektorial midis gjithë aktorëve kyçë politikëbërës dhe ofrues vullnetarizmi, komunitetit dhe qytetarëve.

93% e të pyeturve dakordësohen me idenë që vullnetarizmi në Shqipëri duhet të nxitet, fuqizohet dhe promovohet. Po ashtu, studimi tregoi që edhe pse ka praktika pozitive të menaxhimit të vullnetarëve në institucione, mungojnë tërësisht protokollet apo rregulloret e brendshme, çka bën që vullnetarët të shprehin skepticizëm në lidhje organizimin e këtyre praktikave. Vullnetarizmi i qëndrueshëm mund të nxitet duke krijuar një mjedis më mundësues dhe favorizues institucional, infrastrukturor, programatik dhe ligjor për ofruesit e praktikave vullnetare dhe ndërgjegjësim mbi përfitimet e vullnetarizmit për qytetarët, ashtu dhe për aktorët kyçë kompetentë.

SHKURTIME/AKRONIME

AMShC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
AKAFPK	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PVN	Projekte Vullnetare Ndërkombëtare
MAR	Ministria e Arsimit dhe Rinisë
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
DFG	Diskutimet në Fokus Grupe
KRV	Këshilli Rinor Vendor
KKSHC	Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile
SHKP	Shërbimi Kombëtare i Punësimit
WV	Word Vision

KONCEPTET

Ky sesion ofron një përmbledhje dhe listim të disa koncepteve kyçë, terma të cilat ndodh që mbivendosen, gërshetohen apo zëvendësohen me vullnetarizmin.

Vullnetarizëm – Sipas Ligjit të Vullnetarizmit, vullnetarizmi është investimi me vullnet të lirë i kohës, njohurive dhe aftësive për kryerjen e aktiviteteve ose shërbimeve nga vullnetari, në dobi të ofruesit dhe/apo përfituesit të vullnetarizmit. Vullnetarizmi kryhet pa pagesë, pa kompensim ose ndonjë përfitim tjetër material. Sipas këtij ligji vullnetarizmi nuk përfshin kryerjen e punëve ose shërbimeve që një person është i detyruar t'i kryejë për një person tjetër, b) kryerjen e punëve ose shërbimeve që janë të zakonshme në familje, shoqëri apo në marrëdhëniet e fqinjësisë; c) dhurimin e gjakut; ç) realizimin e detyrimeve të caktuara me vendim gjykate të formës së prerë.

Vullnetar është çdo individ, i cili ofrohet me vullnet të lirë, pa pagesë, ka zotësi të plotë për të vepruar, për të dhënë kontributin e tij/saj për kryerjen e aktiviteteve apo shërbimeve vullnetare. Është e rëndësishme të theksojmë se vullnetar mund të jetë kushdo mbi moshën 15 vjeç.

Ofrues vullnetarizmi mund të jetë një organ publik, bashkësi fetare ose organizatë jofitimprurëse, mund të jetë edhe një person juridik vendas ose i huaj, i cili në ofrimin e vullnetarizmit nuk synon veprimtari fitimprurëse.

Aktivizmi u referohet përpjekjeve për të promovuar dhe ndikuar politikat dhe reformat të cilat synojnë ndryshime sociale apo politike; aktivizimi u referohet përpjekjeve për të "sfiduar sistemin".

Vullnetarizmi dhe aktivizmi
A do të binte dakord dikush që është vullnetar në organizata bamirësie apo në ndihmë të komunitetit dhe grupeve në nevojë të përshkruante veten si aktivist? Dikush që aktivisht përfshihet në lëvizje për ndryshime sociale dhe politike, do të ishte dakord që të përshkruante veten si vullnetar? Do ta përshkruanin ata veten në ndonjë nga këto forma, apo të dyja?

Shumë studime nxjerrin të dhëna se vullnetarizmi dhe aktivizmi janë e njëjta gjë, pasi në të dyja rastet qëllimi është pjesëmarrja dhe ndryshimi social. Kjo është evidentuar dhe gjatë fokus grupeve në këtë studim. Ndërkohë, shumë studime të tjera gjejnë diferencë ndërmjet vullnetarizmit dhe aktivizmit në përmbajtje (shërbimi *vs* ndryshimit); impaktit (kohezioni social *vs* zgjidhjes së tensioneve); përfaqësimit social, ndërlidhjes psiko-sociale. *(Zlobina and Devila de Leon, 2020).*

Aktivizmi u referohet përpjekjeve për të "sfiduar sistemin" dhe "përballjes me të vërtetën", ndërsa vullnetarizmi mund të përshkruhet si një formë për të "përshtatur dhe ndihmuar sistemin". Aktivisti përpiqet për advokim dhe ndryshime politike apo sociale, të cilat mund të jenë dhe vullnetarisht. Vullnetarizmi i referohet ofrimit të shërbimeve në dobi të komunitetit, me vullnet të lirë dhe pa pagesë.

Vullnetarizmi formal dhe jo formal
Sipas një raporti nga Civikus dhe UN Volunteers, vullnetarizmi klasifikohet në vullnetarizëm formal dhe joformal. Zakonisht, këto terma përdoren dhe në vend të vullnetarizmit të strukturuar dhe vullnetarizmit sporadik, apo i pastrukturuar.

Vullnetarizmi formal nënkupton kontributin vullnetar të realizuar nën mbikëqyrjen e organizatave formale, që angazhojnë vullnetarë, që mund të jenë OSHC, entitete publike ose private. Në përgjithësi, ky lloj i vullnetarizmit është i mirëplanifikuar dhe i strukturuar, dhe vullnetari zakonisht vepron në bazë të rregullave dhe standardeve të organizatës. Vullnetari në këtë rast nuk është i pavarur, por vepron brenda strukturave dhe përmbush misionin e organizatës.

Vullnetarizmi joformal i referohet një spektri të aktiviteteve vullnetare, që ndërmerren jashtë organizatave formale, atëherë kur njerëzit veprojnë si individë ose grupe, si në baza të përkohshme, ashtu edhe në baza të përhershme. Disa praktika të vullnetarizmit joformal janë, për shembull, ndihma kundrejt një komuniteti të lagjes ose fetar, përmes medias sociale në internet ose në fushata ndërgjegjësuese, por që nuk lidhet drejtpërdrejtë, ose nuk bëhet në emër të një organizate formale (Çeku, 2013).

Vullnetarizmi digjital i referohet vullnetarizmit nëpërmjet internetit dhe përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve digjitale, gjithashtu i referohet si vullnetarizmi online apo vullnetarizmi virtual.

Shërbime vullnetare: Formë vullnetarizmi e organizuar apo formalizuar, kur një individ angazhohet pak a shumë me kohë të plotë apo të pjesshme për një periudhë të caktuar kohe, të paktën për disa muaj, shpeshherë një marrëdhënie e rregulluar më një kontratë. Një formë e tillë vullnetarizmi, në të cilat organizatat e shoqërisë civile janë të familjarizuara, është Shërbimi Europian Vullnetar (tashmë i emëruar Korpusi Europian i Solidaritetit), Vullnetarët e Korpusit të Paqes, Shërbimi Civil etj.

Intership apo praktika pune konsiderohet një angazhim formal (i/papaguar), eksperiencë pune për të rritur aftësitë praktike si pjesë e studimeve apo kurseve që individi ndjek. Zakonisht ndihmon studentët për kalimin nga studimet në tregun e punës (periudhë tranzitore). Dhe ky term shpeshherë ngatërrohet me vullnetarizmin, edhe pse janë dy koncepte të ndryshme si praktikisht, ashtu dhe ligjërisht.

Qytetari aktive nënkupton përfshirjen aktive të individëve në zhvillimin komunitar, si dhe zhvillimin e demokracisë në të gjitha nivelet. Qytetaria aktive mund të jetë në nivel lokal, si p.sh., pastrimi i rrugës në lagjen ku jetojmë apo në përmasa më të mëdha, si p.sh., edukimi i të rinjve rreth vlerave të demokracisë dhe pjesëmarrjes aktive. Është një hap shumë i rëndësishëm për shoqëri të shëndetshme dhe mirëfunksionale.

Kohezioni social: Koncepti i kohezionit social është shumë i diskutueshëm nga studime dhe perspektiva të ndryshme (sociale, sociologjike, ekonomike, politike etj.,). Sipas Këshillit të Europës, kohezioni social është kapaciteti i një shoqërie që të sigurojë mirëqenien e të gjithë anëtarëve, të minimizojë pabarazitë dhe polarizimet. Kohezioni social ka dy dimensione: ndjenjën e përkatësimit në komunitet dhe lidhjen ndërmjet anëtarëve të vetë komunitetit.

Aftësitë për jetën/aftësitë e buta konsiderohen aftësitë e përshtatjes, që mundësojnë çdo individ për t'u përballur efektivisht me situatat, kërkesat dhe sfidat e jetës. Këto aftësi përcaktohen si një grupim i kompetencave psiko-sociale dhe aftësive ndërpersonale, që ndihmojnë individët të ndërmarrin vendime të informuara, të zgjidhin efektivisht problemet, të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese, të kenë komunikim të qartë dhe efektiv, të ndërtojnë marrëdhënie të shëndetshme, të përshtaten dhe të menaxhojnë jetën e tyre në mënyrë të shëndetshme.

Bamirësia nënkupton dhënie vullnetare e ndihmës njerëzve në nevojë, si një akt humanitar.

1 HYRJE

Vullnetarizmi ndodh dhe zhvillohet në çdo shoqëri. Koncepti i vullnetarizmit, si dhe format e angazhimit të tij, mund të variojë në gjuhë dhe kultura të ndryshme, por vlerat e vullnetarizmit në thelb janë të njëjta dhe universale: dëshira për të kontribuar në të mira të përbashkëta, me vullnet të lirë dhe me ndjenjën e solidaritetit, pa pritur kompensim financiar. Kontributi vullnetar ndikon në mënyrë thelbësore në zhvillimin e aftësive për jetën te vullnetarët, nxit zhvillimin shoqëror dhe kohezionin social. Angazhimi vullnetar u ofron individëve mundësi për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitete, duke ndikuar pozitivisht në nxitjen dhe promovimin e qytetarisë aktive, zhvillimin komunitar dhe solidaritetit, elemente kyçe këto të demokracisë dhe të vlerave evropiane. Nga ana tjetër, kontributi vullnetar ndikon pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin e aftësive personale, ndërpersonale dhe profesionale të vullnetarëve.

Vullnetarizmi është një proces i ndërsjellë, reciprok dhe i gërshetuar, kur i referohemi ndikimit pozitiv që ka në nivel personal, komunitar, institucional dhe shoqëror. Përgjithësisht, vullnetarizmi apo dëshira për të qenë vullnetar i ka fillesat apo lidhet shumë ngushtë me ndihmën që japim ndaj individëve apo grupeve që kanë më shumë nevojë. Megjithatë, të gjithë ata që kanë eksperienca si vullnetarë, ndoshta do të mendoheshin gjatë dhe do ta kishin të vështirë të ndanin në mënyrë të prerë se kush përfiton më shumë në një angazhim vullnetar, ofruesi (vullnetari/ja) apo përfituesi i drejtpërdrejtë i shërbimit vullnetar (individi apo grupi në nevojë). Rreth 80 % e vullnetarëve që janë angazhuar në aktivitete direkt vullnetare kanë pohuar se arsyeja pse kanë vullnetarizuar ka qenë për të ofruar ndihmën e tyre, por gjatë procesit kanë kuptuar se kanë përfituar vetë më shumë *(Rama dhe Xhaho, 2020).*

Në Shqipëri nuk ka studime të cilat sjellin të dhëna rreth perceptimit të vullnetarizmit në tërësi, si dhe impaktit që vullnetarizmi ka në nivele të ndryshme: ndërpersonal, komunitar, institucional dhe shoqëror. Nga ana tjetër, nuk ka studime të cilat masin dhe analizojnë sfidat, nevojat, mundësitë dhe perspektivat në nivele të ndryshme. Ndonëse ka pak studime mbi vullnetarizmin në Shqipëri, ato përqendrohen kryesisht në një qasje jo gjithëpërfshirëse, duke eksploruar kryesisht angazhimin rinor, pra, duke ofruar një tablo të pjesshme të kontributit vullnetar.

Ky studim synon të hedhë dritë mbi perceptimin dhe përvojat e qytetarëve shqiptarë mbi vullnetarizmin, duke marrë në konsideratë të gjitha moshat mbi 15 vjeç. Së pari, studimi synon të eksplorojë perceptimet e përgjithshme të qytetarëve për kontributin vullnetar dhe njëkohësisht të vlerësojë eksperiencat dhe ndikimin e këtyre eksperiencave te ta. Së dyti, studimi synon të ofrojë një perspektivë të re mbi zbulimin e shkaqeve për mosangazhimin si vullnetarë, duke eksploruar njëkohësisht mënyrat më efektive dhe perspektivat/trendet për të nxitur vullnetarizmin, duke

analizuar perceptimet dhe përqasjen e vullnetarëve nga njëra anë, përqasjen dhe vlerësimin e mundësive nga ofruesit e vullnetarizmit, si dhe institucionet politikëbërëse në vend, nga ana tjetër. Ky studim kontribuon në literaturën ekzistuese për mënyrën se si qytetarët shqiptarë e perceptojnë dhe angazhohen në fushën e vullnetarizmit. Njëkohësisht, studimi synon të ofrojë disa rekomandime për ofruesit dhe përfituesit e vullnetarizmit, për vendimmarrësit në nivel vendor dhe qendror, me qëllim përmirësimin e infrastrukturës së vullnetarizmit dhe krijimin e një mjedisi më mundësues për sektorin. Kjo nevojë bëhet akoma më e dukshme në kushtet kur politikat dhe legjislacioni mbi vullnetarizmin mbeten ende të paqarta për një pjesë të konsiderueshme të OSHC-ve, duke krijuar vështirësi të vazhdueshme për mënyrën se si këto institucione duhet t'i angazhojnë vullnetarët në programet e tyre. Së fundmi, gjetjet dhe rekomandimet e studimit synojnë të sjellin një qasje të re të angazhimit vullnetar, duke e rikonceptuar atë përmes një modeli evropian dhe demokratik të kontributit vullnetar, që mbi të gjitha ka në qendër të vëmendjes nxitjen e qytetarisë aktive, solidaritetit dhe kohezionit social.

Raporti i studimit është i strukturuar në 6 kapituj: *Kapitulli i parë* sjell një përmbledhje të disa koncepteve bazë, si dhe situatës së përgjithshme të vullnetarizmit. *Kapitulli i dytë* sjell një panoramë të përgjithshme të të kuptuarit të vullnetarizmit, vlerave dhe benefiteve të tij, si dhe disa mekanizmave ndërkombëtarë që parashikojnë rregullimin e tij. *Kapitulli i tretë* është i fokusuar te vullnetarizmi në Shqipëri, perspektivat dhe kuadri rregullator. *Kapitulli i katërt* ofron një përmbledhje të metodologjisë që ka orientuar mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e tyre. *Kapitulli i pestë* jep një përshkrim të hollësishëm të rezultateve nga hulumtimi në terren, intervistat gjysmë të strukturuara dhe fokus grupet, duke diskutuar në mënyrë analitike gjetjet kryesore, ku kanë dhënë kontributin e tyre qytetar mbi 15 vjeç ofruesit e vullnetarizmit (organizata të shoqërisë civile, media, institucionet e edukimit dhe kujdesit etj.,), si dhe institucionet vendore dhe qendrore në vend. *Kapitulli i fundit* jep disa konkluzione përfundimtare, të shoqëruara me rekomandimet përkatëse.

Ky studim është realizuar nga Organizata Projekte Vullnetare Ndërkombëtare (PVN), në kuadër të projektit "VullnetarizmiPikëAL", i cili ka si qëllim krijimin e një mjedisi mundësues shumëdimensional, ku vullnetarizmi inkurajohet, mbështetet, njihet si mekanizëm kyç për nxitjen e qytetarisë aktive, solidaritetit dhe kohezionit social në Shqipëri. Ky projekt zbatohet nga organizata "Përtej Barrierave" në partneritet me organizatën "Projekte Vullnetare Ndërkombëtare" dhe "Qendra Progres dhe Zhvillim", me mbështetjen e instrumentit të granteve strategjike të "LëvizAlbania", një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

2 VULLNETARIZMI: PERCEPTIMET, VLERAT DHE PËRFITIMET INDIVIDUALE E SHOQËRORE

2.1 Shprehja e vullnetarizmit dhe përfitimet shoqërore

> *Vullnetarizmi është burim i fuqizimit të komunitetit, qëndrueshmërisë dhe kohezionit social. Ai sjell ndryshime pozitive sociale, duke inkurajuar solidaritetin, barazinë dhe pjesëmarrjen qytetare. Është një ndër asetet më jetike në shoqëri* (Ban Ki-moon, Dhjetor 2009)

Vullnetarizmi është i mbushur me vlerat e solidaritetit, reciprocitetit, besimit të ndërsjellë, përkatësisë dhe fuqizimit. Të gjitha këto kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në cilësinë e jetës. Vullnetarizmi është një ndër shprehjet më themelore të sjelljes njerëzore, lindur nga traditat e lashta për shkëmbime reciproke. Në thelbin e tij janë marrëdhëniet njerëzore dhe potenciali i tyre për të rritur mirëqenien e individëve dhe komunitetit. Vullnetarizmi lidhet, gjithashtu, me nevojën e individëve për të marrë pjesë aktivisht në shoqërinë e tyre, si dhe kujdesit që ata kanë për të tjerët. Ne besojmë se vullnetarizmi shkon shumë larg, përtej thjeshtë kryerjes së një detyre të caktuar, ai krijon dhe mban lidhje besimi dhe reciprociteti.

Njerëzit në të gjithë botën përfshihen në vullnetarizëm për një larmi arsyesh: për të ndihmuar në eliminimin varfërisë, për të përmirësuar shëndetin dhe edukimin, për të mbështetur grupet me mundësi më të pakta, për të adresuar dhe mbështetur çështje të mjedisit dhe ndryshimet klimatike, për të zvogëluar rrezikun e katastrofave, për të luftuar përjashtimin social etj. Në të gjitha këto fusha, vullnetarizmi kontribuon gjerësisht në paqe dhe zhvillim.

Vlerat e vullnetarizmit dhe shprehja e tij janë gjithashtu jashtëzakonisht të rëndësishme në forcimin e kapaciteteve për grupet me më shumë nevojë, që të arrijnë të sigurojnë jetesën dhe për të rritur mirëqenien fizike, ekonomike, shpirtërore dhe sociale. Për më tepër, vullnetarizmi mund të zvogëlojë përjashtimin social, i cili shpesh është rezultat i varfërisë, margjinalizimi dhe format e tjera të pabarazisë. Sot, mbase më shumë se kurrë më parë, kujdesi për njëri-tjetrin dhe solidariteti janë një domosdoshmëri, jo një veprim bamirësie.

Vullnetarizmi, gjithashtu, formon shtyllën kryesore të shumë organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, organizata të tjera të shoqërisë civile, si dhe lëvizjet shoqërore dhe politike; është i pranishëm dhe një shtyllë e rëndësishme në sektorin publik, në institucionet e edukimit dhe shëndetësisë, dhe po bëhet gjithnjë e më shumë një tipar i sektorit privat.

Vullnetarizmi nuk është një relikte nostalgjike e së kaluarës, edhe pse moshat

që kanë jetuar periudhën komuniste e bëjnë një lidhe direkte me të, por kemi tjetër këndvështrim dhe përqasje te të rinjtë, të cilët e konsiderojnë si një mundësi për zhvillimin e tyre dhe të shoqërisë. Është një koncept që po kuptohet dalëngadalë për vlerat që ai përcjell dhe elementët që ai përmban.

Statistikat dhe të dhënat në nivel ndërkombëtar janë gjithnjë në rritje, sepse vullnetarizmi promovon vlerat qytetare, zhvillimin e aftësive ndërpersonale dhe kohezionin social. Megjithatë, në shoqëritë në zhvillim, ashtu dhe në shoqërinë shqiptare, ne kemi nevojë më tepër të provojmë dhe inkurajojmë një njohje më të madhe të vullnetarizmit, si një forcë e fuqishme për zhvillim.

Vullnetarizmi duhet të nxirret në pah në diskursin e zhvillimit në nivel global, rajonal dhe kombëtar. Interesi në shumë aspekte i vullnetarizmit është rritur ndjeshëm kohët e fundit *(State of volunteering, Universal Values, UNV, 2011)*

Diskutime shumë të gjera në nivel ndërkombëtar zhvillohen mbi pyetjen se: A duhet të matet impakti i vullnetarizmit në shoqëri? A duhet të përcaktohen mekanizma specifikë për të matur kontributin vullnetar në aspekte të ndryshme, përfshirë dhe atë ekonomik? A do të jetë matja një mënyrë që vlerat të kuptohen dhe njihen nga secili aktor politikëbërës, ashtu edhe ofrues i vullnetarizmit? Nga ana tjetër, shumë pyetje ngrihen nëse matja e impaktit të vullnetarizmit (veçanërisht ai ekonomik) mos ndoshta do të zbehte vlerat e vullnetarizmit në vetvete, si ato të kohezionit social?

Është e nevojshme të bëhen më shumë studime në këtë këndvështrim dhe të vendosen disa indikatorë se si vullnetarizmi mund të matet efektivisht dhe praktikisht, pa zbehur vlerat dhe impaktin e tij, por, përkundrazi, të jenë një nxitje apo fakt se si këto vlera, qoftë dhe ekonomike, i përkasin çdo shoqërie. Nëse qeveritë do të marrin parasysh politikat kombëtare, ato duhet të kenë fakte dhe të jenë të bindur rreth vlerave që sjell, përfshirë këtu dhe ato ekonomike.

Shpeshherë institucionet politikëbërëse nuk janë të informuara dhe ndërgjegjësuara rreth impaktit të vullnetarizmit në segmente të ndryshme, si dhe vlerat që ai përcjell. Të dhëna të sakta dhe të besueshme do të ndihmonin institucionet politikëbërëse për të zhvilluar strategji të përshtatshme në nxitjen dhe mbështetjen e vullnetarizmit *(State of volunteering, Universal Values, UNV, 2011)*

Vullnetarizmi në BE jep një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë, shoqërisë dhe individit. Kontributi i vullnetarizmit për një vend është aq i rëndësishëm, saqë ndikon në një farë mënyre në rritjen e produktit të brendshëm bruto të vendit. Studimet sugjerojnë që vullnetarizmi kontribuon nga 0.5%, në më shumë se 5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto të BE-së *(Balkan web).*

2.2. Impakti i vullnetarizmit në nivel individual

Vullnetarizmi sjell një sërë përfitimesh në nivel individual, komunitar, institucional dhe shoqëror, një pjesë e mirë e integruar me vlerat që përçon në kauza dhe aktorë të ndryshëm. Ky sesion përmbledh veçanërisht disa nga përfitimet në nivel individual (për vullnetarin).

Fakti që vullnetarizmi kryhet pa asnjë shpërblim, nuk do të thotë që nuk sjell benefite personale për individin. Përkundrazi, kontributi vullnetar ndihmon në rritjen personale, zhvillimin e aftësive për jetën e individëve që angazhohen në aktivitete të tilla. Nga ana tjetër, vullnetarizmi është një mundësi shumë e mirë për të përfituar një eksperiencë praktike, eksperiencë pune dhe përfitimi nga një gamë e gjerë njohurish apo aftësish për zhvillimin e tyre profesional. Angazhimi vullnetar rrit gjasat për një karrierë më të suksesshme, pasi u mundëson vullnetarëve të fitojnë dhe të përvetësojnë njohuri të reja, aftësi administrative, menaxheriale, të punuarit në grup dhe individualisht. Gjithsesi, motivimi dhe fillesat duhet të jenë për të mbështetur dhe besuar në kauzën që çdo vullnetar angazhohet.

Vullnetarizmi është, gjithashtu, një mekanizëm shumë i mirë për aktivizimin qytetar në dobi të komunitetit dhe shoqërisë, duke qenë se individët e përdorin kohën në mënyrë eficiente dhe produktive në emër të një të mire të përbashkët *(Qendra Rinore, 2015).*

Në këtë kontekst duhet që theksi i përfitimeve nga angazhimi vullnetar të jetë më shumë dimensional dhe i orientuar nga vullneti i lirë, nga dëshira për përmirësim dhe zhvillim shoqëror e individual, duke mos mbajtur theksin veçanërisht në përfitimet që vullnetarizmi sjell në punësimin e individëve, sepse përfitimet janë shumë më të gjera se kaq dhe shumë më shumë afatgjata.

Disa benefite nga shërbimi si vullnetarë janë: zhvillimi i aftësive personale dhe aftësive për jetën; përmirësimi i mundësive për karrierë, reflektimi rreth aftësive në tregun e punës, një urë lidhëse/ndërmjetëse ndërmjet studimeve dhe tregut të punës; nxit empatinë, gjithëpërfshirjen dhe solidaritetin ; krijon lidhje dhe socializim, forcon kapitalin social; përmirëson cilësinë e jetës dhe ndikon pozitivisht në lidhjen e ngushtë me komunitetin.

Çdo vullnetar përjeton dhe përfiton zhvillimin e aftësive në forma dhe mënyra të ndryshme, ndaj ndonjëherë nuk është e lehtë të përmbledhësh përfitimet, pasi ato janë të shumta, shpeshherë demonstrohen gjatë ushtrimit të vullnetarizmit dhe herë të tjera në terma afatmesëm apo afatgjatë.

2.3 Kuadri rregullator ndërkombëtar mbi vullnetarizmin

Në nivel ndërkombëtar vullnetarizmi është i rregulluar në forma dhe mekanizma të ndryshme. Këto rregullime ndihmojnë zhvillimin e këtij sektori dhe në Shqipëri, pasi janë të testuara si nga aspekti rregullator ligjor, ashtu dhe ai praktik në nivel të gjerë europian dhe global. Këto rregullime mund të jenë referim dhe për rregullimet e nevojshme të përmirësimit dhe nxitjes së vullnetarizmit në vendin tonë.

Karta Evropiane "Mbi të Drejtat dhe Detyrat e Vullnetarëve**"** e përkufizon vullnetarin si një person që me zgjedhje të lirë personale ndërmerr aktivitete në të mirë të shoqërisë. Këto aktivitete kryhen pa përfitime financiare, duke ndikuar

pozitivisht në zhvillimin personal. Vullnetari angazhohet në punë të papaguar, duke investuar kohë dhe energji për t'i shërbyer një të mire të përgjithshme apo misioni më të lartë.

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) ka hartuar "Manualin mbi matjen e kontributit vullnetar". Manuali për Matjen e Punës Vullnetare ka për qëllim të orientojë vendet në gjenerimin e të dhënave sistematike dhe të krahasueshme mbi vullnetarizmin përmes ndikimit në forcën e punës ose sondazheve të tjera. Qëllimi i tij është që të vihen në dispozicion të dhëna krahasuese ndërkombëtare për rëndësinë e kontributit vullnetar, të cilat rrallëherë identifikohen në statistikat ekonomike tradicionale (ILO, 2011).

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi në 2001 një rezolutë, duke u bërë thirrje qeverive për të "përcaktuar vlerën ekonomike të vullnetarizmit". (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2001). Në rezolutën e vitit 2005 mbi "Ndjekjen e Zbatimit të Vitit Ndërkombëtar të Vullnetarëve" Asambleja e Përgjithshme inkurajoi më tej që "Qeveritë, me mbështetjen shoqërisë civile, të ndërtojnë një bazë njohurish mbi këtë temë, për të ndarë të dhëna dhe për të zgjeruar kërkimin për çështje të tjera të lidhura me vullnetarët, përfshirë vendet në zhvillim" (ILO, 2011).

"Rezoluta mbi Vullnetarizmin" e miratuar nga Parlamenti Evropian më 1983 njeh dhe vlerëson natyrën e përgjithshme të veprimtarisë vullnetare. Kjo rezolutë thekson, ndër të tjera, zhvillimin e një infrastrukture adekuate për politika efektive të vullnetarizmit dhe i bën thirrje Komisionit Evropian t'i kushtojë vëmendje dhe kujdes sistematik vullnetarizmit. Rezoluta bën thirrje për një status për vullnetarizmin, për t'i mbuluar shpenzimet dhe sigurimin social për vullnetarët.

Deklarata 38 mbi aktivitetet e shërbimit vullnetar, e aneksuar në Traktatin e Amsterdamit, e njeh dhe e vlerëson kontributin e rëndësishëm të aktiviteteve dhe shërbimeve vullnetare për zhvillimin e solidaritetit social (Ceka, 2013).

Së fundmi, **Komunikata e vitit 1997 e Komisionit Evropian për Promovimin e Rolit të Organizatave dhe Fondacioneve Vullnetare në Evropë** thekson rolin e rëndësishëm të vullnetarizmit në krijimin e vendeve të punës (Ceka, 2013).

Duke pasur parasysh diversitetin dhe natyrën e vullnetarizmit, është pothuaj e pamundur që të sugjerohen modele universale për zhvillimin e vullnetarizmit përmes ligjeve dhe politikave. Nuk ekzistojnë ligje të përbashkëta të BE-së mbi vullnetarizmin, së pari për shkak të natyrës së ndryshme të vullnetarizmit dhe ndërlikueshmërisë së sektorit vullnetar në të gjitha shtetet anëtare të BE-së (EEAS, 2011). Vullnetarizmi është produkt i mjedisit ku ai zhvillohet dhe, për pasojë, politikat janë të ndryshme në shtete të ndryshme.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në mënyrë specifike ka njohur rëndësinë e legjislacionit që përkrah zhvillimin dhe rritjen e vullnetarizmit. Këto lloj politikash kanë inkurajuar qeveritë që të miratojnë masa legjislative dhe fiskale për një mjedis më mundësues për vullnetarizmin. Këto praktika, në të shumtën e rasteve kanë pasur një qasje më gjithëpërfshirëse, me pjesëmarrje të qeverisë,

shoqërisë civile, sektorit të biznesit dhe aktorëve të tjerë. Katër parime themelore janë vërejtur në këto lloj praktikash:

- Përcaktimi i qëllimeve themelore të një ligji ose politike mbi vullnetarizmin dhe i sfidave/pengesave të mundshme në arritjen e këtyre qëllimeve.
- Aplikimi i një procesi pjesëmarrës dhe të hapur të analizës, hartimit dhe zbatimit.
- Hartimi i ligjeve ose politikave për arritjen e qëllimeve të përcaktuara.
- Sigurimi që ligjet ose politikat e reja janë duke u zbatuar në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.

Që prej *Vitit Ndërkombëtar të Vullnetarizmit* më 2001 konstatohet që më shumë se 70 ligje ose politika janë miratuar nga shtete të ndryshme për vullnetarizmin (Çeku, 2013).

3 VULLNETARIZMI NË SHQIPËRI

3.1 Konteksti

Vullnetarizmi në Shqipëri është akoma një koncept i cili trajtohet në dimensione të ndryshme dhe ashtu si në shumë studime ndërkombëtare, koncepti i vullnetarizmit varion nga zhvillimet gjuhësore, historike e kulturore. Këto zhvillime ndikojnë akoma në mënyrë të ndërgjegjshme apo pandërgjegjshme si tek individët, ashtu dhe te përfaqësues të institucioneve të ndryshme në vend. Konceptin dhe situatën e vullnetarizmit e percepton ndryshe një person i moshës 60 vjeç, krahasuar me një person të ri 20 vjeçar; disa e konsiderojnë si humbje kohe dhe disa e konsiderojnë si mundësi për t'u zhvilluar.

Shpeshherë perceptohet si ndihmë dhe kontribut për të tjerët, veçanërisht target grupet në nevojë. Gjithashtu, për vite me radhë koncepti i vullnetarizmit në Shqipëri lidhej me periudhën e regjimit komunist (mbi moshën 35 vjeç), ku puna vullnetare ishte e detyruar për qytetarët. Për shkak të kësaj lidhje historike, shumica e qytetarëve, të cilët kanë jetuar periudhën komuniste, e shikojnë vullnetarizmin me një konotacion negativ, pasi ju rikujton një periudhë jo të dëshirueshme për ta. Fenomeni i vullnetarizmit ishte një praktikë e njohur në kontekstin komunist. Qytetarët ishin të përfshirë vazhdimisht në të ashtuquajturat iniciativa apo nisma vullnetare "kushtuar ndërtimit të vendit dhe njeriut të ri socialist", por këto iniciativa nuk ishin rezultat i vullnetit të lirë të njerëzve. Përkundrazi, njerëzit shpesh detyroheshin të kryenin "punën vullnetare", përpos dëshirës dhe vullnetit të tyre. Për këtë arsye, ky term ende vazhdon të rezonojë një qasje negative te brezat e periudhës post-komuniste *(Dhëmbo et al., 2015.).*

Gjithashtu, shpeshherë vullnetarizmi ngatërrohet me praktikën e punës apo me punën e detyruar. Vlen të theksohet fakti që vullnetarizmi është një punë e papaguar dhe nuk përbën periudhën e provës, praktikën e punës, punën e detyruar apo të imponuar në komunitet nga regjimi (Qendra Rinore, 2015).

Megjithatë, vitet e fundit vihet re një ndryshim në mendësi dhe përqasjen e qytetarëve në lidhje me konceptin e vullnetarizmit, e shprehur kjo më shumë te të rinjtë (Qendra Rinore, 2015).

Aktorët e shoqërisë civile janë ende duke punuar për të përmirësuar politikat vullnetare dhe për të forcuar mjedisin institucional, ligjor, programatik dhe shoqëror rreth vullnetarizmit. Gjithashtu, ata po përpiqen të krijojnë një mjedis më të mundshëm për angazhimin e vullnetarëve të moshave të ndryshme, grupe të ndryshme etnike dhe ato socio-ekonomike.

Nga gjithë literaturat ndërkombëtare, si dhe në vijim të të dhënave të mbledhura nga ky studim vihet theksi te fakti se vullnetarizmi është një koncept tjetër nga aktivizmi apo bamirësia. Gjithashtu, për shkak të zhvillimeve dhe dinamikave, vullnetarizmi nuk është më një koncept që duhet të influencohet dhe të lidhet me të kaluarën.

Ndonëse, angazhimi vullnetar ofron mundësi të panumërta për zhvillimin ndërpersonal dhe shoqëror, angazhimi i individëve shqiptarë në aktivitete vullnetare është në përgjithësi në një nivel të ulët. Një studim i realizuar nga *Kamberi dhe Çela et al. (2019)* konstaton se pjesëmarrja e të rinjve në aktivitete vullnetare në Shqipëri ishte në rreth 17% për vitin 2018. Sipas një sondazhi tjetër mbi vullnetarizmin, të realizuar nga *Cela et al. (2015)* konstaton se një në pesë të rinj shqiptarë raportojnë të jenë angazhuar në një aktivitet vullnetar në vitin 2014, duke sinjalizuar një rritje të lehtë nga sondazhi në 2011, ku ky numër ishte vetëm 16 për qind. Duhet thënë që nuk kemi të dhëna të nivelit dhe interesit rreth kontributit vullnetar të qytetarëve shqiptarë në tërësi.

Sipas një studimi nga *Partners Albania (2019)*, pjesa më e madhe e OSHC-ve kanë 0-10 vullnetarë (64%). Organizatat që kanë më shumë se 60 vullnetarë janë kryesisht organizata që drejtohen nga të rinjtë dhe kanë në mision të punës së tyre realizimin e fushatave masive sensibilizuese, advokojnë për të mbrojtur të drejtat e të rinjve, grave apo fëmijëve *(Partners Albania, 2019).*

Këto shifra janë ende larg statistikave në nivel rajonal apo edhe botëror. Një studim mbi shoqërinë civile në Evropën Qendrore dhe Lindore tregoi se shkalla e vullnetarizmit midis OShC-ve në Evropën Qendrore dhe Lindore është mjaft e ulët në vendet jo anëtare të BE-së, Mal të Zi (7.3%), Bosnje-Hercegovinë (7.9%), Kosovë (10.7 %), Serbi (11.4%), Shqipëri (7.9%) *(Meyer et al., 2016).*

Në nivel global kjo shifër shkon në rreth 970 milionë vullnetarë në të gjithë botën (UN Volunteers, 2007). Edhe pse rreth 23% të evropianëve të moshës mbi 15 vjeç janë të angazhuar në punë vullnetare, statistika tregon se ka dallime të mëdha në nivelin e paraqitjes së vullnetarëve në vendet anëtare të BE-së (EEAS, 2011). Rreth 1/3 e popullsisë në Gjermani marrin pjesë rregullisht në aktivitete vullnetare dhe rreth 23 milionë qytetarë ofrojnë punë vullnetare në Britaninë e Madhe. Në të njëjtin nivel janë po ashtu Belgjika, Zvicra, Franca, Polonia, Irlanda etj. Rreth një miliard njerëz angazhohen vullnetarisht çdo vit për të ndihmuar komunitetet e tyre ose për të bërë një ndryshim në kauzat që ata mbështesin. (UNV 2018a). Ndonëse janë bërë përpjekje modeste për të matur angazhimin e të rinjve në punë vullnetare në Shqipëri, ende nuk ka statistika të sakta mbi numrin e vullnetarëve (REC, 2015).

Aktivitetet dhe iniciativat më të zakonshme ku qytetarët shqiptarë angazhohen si vullnetarë janë 'pastrimi i hapësirave publike dhe të gjelbra'. Ndërkohë, raportohet një rritje e kontributit vullnetar në ofrimin e mësimeve falas në përdorimin e kompjuterit dhe teknologjisë. Në përgjithësi, angazhimi vullnetar ulet me rritjen e moshës dhe kjo ndoshta për shkak se moshat e reja kanë më tepër kohë, edhe pse kanë impenjime në shkollë. Pjesa më e madhe e të rinjve vullnetarë (50%) raportojnë se arsyeja kryesore pse bëjnë punë vullnetare është rritja e motivimit, e ndjekur

nga dëshira për t'ju përkushtuar të tjerëve, si dhe rritja profesionale e personale. Studimet nxjerrin në përfundim se të rinjtë shqiptarë angazhohen shumë pak në punë vullnetare dhe një ndër arsyet për këtë angazhim ka të bëje me faktin se një pjesë e madhe e të rinjve shpenzojnë një kohë të konsiderueshme (rreth 6.5 orë) në kompjuter, laptop apo celular, duke lënë pak mundësi dhe dëshirë të ulët për kontribut vullnetar. Njëkohësisht, të rinjtë shqiptarë angazhohen shumë pak në sporte apo aktivitete të tjera si leximi i librave dhe aktivitete vullnetare (Cela et al., 2015).

Një studim i fundit i realizuar nga *Rama dhe Xhaho (2020)* mbi të rinjtë dhe vullnetarizmin në rajonin a Ballkanit, nxori në pah se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve e kanë përjetuar vullnetarizmin si një përvojë pozitive dhe përmbushëse. Ky aktivitet perceptohet si një mundësi për të dhënë një kontribut për njerëzit dhe komunitetet në nevojë, pa ndonjë kompensim. Dy shpërblimet kryesore që perceptohet se përjeton njeriu nga kontributi vullnetar janë përmirësimi i aftësive personale dhe profesionale. Për sa i përket përftimeve nga vullnetarizmi, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (29%) besojnë se përvoja vullnetare i ndihmoi ata të eksplorojnë dhe të reflektojnë mbi veten e tyre, ndërsa 21% zbuluan se përvoja vullnetare i ndihmoi ata të bëhen më mendjehapur dhe tolerantë, çereku i të anketuarve (25%) raportojnë se përvoja vullnetare i ndihmoi ata kryesisht për të punuar në grup dhe 18% deklaruan se përvoja i ndihmoi të përmirësonin aftësitë e komunikimit. Nga këto të dhëna kuptojmë qartë se sa shumë ndikim ka vullnetarizmi në zhvillimin e aftësive për jetën apo aftësive të buta, që ju referohemi herë pas here, dhe se të rinjtë janë të ndërgjegjshëm për përfitimet që ata marrin. Më shumë se gjysma e të anketuarve tregojnë se OShC-të janë një burim i mirë i përvojave vullnetare, edhe pse një pjesë e konsiderueshme e të rinjve nuk e dinë se cilat të drejta burojnë nga puna vullnetare. Studimi tregoi se edhe pse ligji për aktivitetet vullnetare është aprovuar gati 5 vite më parë, shumica e të anketuarve nuk janë në dijeni të ndonjë kuadri ligjor. Ndërkohë, një shumicë e madhe e të anketuarve (94%) besonin se ka nevojë për të promovuar më shumë mundësi vullnetarizmi.

Mungesa e të dhënave dhe studimeve specifike në nivel kombëtar përbën një sfidë, pasi është e rëndësishme të kuptohen nevojat, mundësitë, sektorët, mënyrat e orientimit, motivimit dhe menaxhimit.

Bashkëpunimi ndërsektorial sjell vështirësi në promovimin, nxitjen dhe ofrimin e shërbimit vullnetar, fakt i cili ka sjellë konfuzion për vullnetarët, ashtu dhe për ofruesit e vullnetarizmit.

Në tërësi, vullnetarizmi që nuk njihet, nuk kuptohet dhe nuk vlerësohet për gjithë vlerat dhe përfitimet që sjell në të gjitha dimensionet dhe nivelet e tij.

3.2. Kuadri rregullator dhe institucional mbi vullnetarizmin

3.2.1 Kuadri ligjor kombëtar mbi vullnetarizmin

Në vitin 2016 Shqipëria ka miratuar Ligjin Nr.45/2016 "Për vullnetarizmin", i cili synon rregullimin ligjor të vullnetarizmit, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së individëve në jetën sociale, për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet, si dhe zhvillimin e vlerave të solidaritetit njerëzor. Ky ligj zbatohet për të gjitha subjektet që kryejnë, përfitojnë ose ofrojnë vullnetarizmin në Republikën e Shqipërisë. Vullnetarizmi në kuptimin e këtij ligji është investimi me vullnet të lirë i kohës, njohurive dhe aftësive për kryerjen e aktiviteteve ose shërbimeve nga vullnetari. Dispozitat e këtij Ligji rregullojnë dhe përcaktojnë gjithashtu kushtet, përmbajtjen dhe efektet e kontratës së vullnetarizmit, të drejtat dhe përgjegjësitë e vullnetarëve dhe ofruesit të vullnetarizmit.

Pesë vjet pas miratimit të Ligjit 45/2016 "Për Vullnetarizmin", OSHC-të dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij ndeshen ende me vështirësi në implementimin e tij. Problematika kryesore e evidentuar ka të bëjë me mosnjohjen e saktë, kuptueshmërinë dhe zbatimin në praktikë të ligjit. Ndonëse është pozitiv fakti që ka një ligj që rregullon vullnetarizmin, kuadri nënligjor nuk është ende i plotë dhe mundësues për shumë OSHC-të që kanë në fokus të punës së tyre vullnetarizmin. Në përputhje me "Ligjin e vullnetarizmit", në 2018 janë aprovuar edhe aktet nënligjore që rregullojnë vullnetarizmin. Urdhri Nr. 229/2018 "Mbi formatin dhe përmbajtjes e Kartës së Vullnetarit" dhe Urdhri 300/ 2018 "Mbi formatin dhe përmbajtjen e Regjistrit të Kontratës së Vullnetarizmit". Në 2018 Këshilli i Ministrave aprovoi edhe "Kodin e Etikës së Vullnetarëve". Ndonëse janë bërë hapa pozitivë për nxjerrjen e disa akteve nënligjore që rregullojnë punën vullnetare, ngelet problematik fakti që këto akte janë aprovuar pë.rmes një procesi me "dyer të mbyllura" dhe njohja e tyre për sektorin është bërë e mundur vetëm në fund të vitit 2019. Mungesa e transparencës vihet re edhe në mospublikimin online të dy nga tre aktet e miratuara, duke qenë se vetëm Kodi Etik është publikuar online. Mospublikimi online i dy akteve të tjera përbën sërish një sfidë për OSHC-të, të cilat nuk janë të informuara mbi formatin dhe përmbajtjen e tyre *(Qendra Burimore, 2019)*

Pjesa më e madhe e OSHC-ve nuk janë as në dijeni të akteve të tilla (Partners Albania, 2019). Këtë e kemi vene re dhe ne fokus grupet që kemi bërë dhe ato pak organizata që janë në dijeni hasen me vështirësi dhe paqartësi për mënyrën zbatimit të tyre. Këto organizata kanë paqartësi për mënyrën e përfshirjes së vullnetarëve në aktivitetet apo projekte e tyre, duke qenë më shumë të ekspozuara edhe ndaj riskut të gjobave, për shkak të mosndjekjes së rregullt të procedurave sipas parashikimeve ligjore *(Qendra Burimore, 2019).*

Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrjen vendore dhe propozimi i iniciativave qytetare në dobi të komuniteteve vendore gjejnë mbështetje në ligjin për vetë-qeverisjen vendore.[1] Qytetarët që dëshirojnë të përfshihen në iniciativa në dobi të

[1] Ligji 139/ 2015 , "Për Vetëqeverisjen vendore"

komuniteteve të tyre mund të angazhohen përmes kontributit vullnetar në strukturat komunitare (neni 68/69/70 i ligjit) në frymën e këtij ligji janë strukturat komunitare të lagjeve, të ngritura në bazë të iniciativës qytetare të organizuara mbi baza vullnetare. Edhe pse ky ligj nuk prek në mënyrë të drejtpërdrejtë vullnetarizmin, ai është një mbështetje dhe referim sesi vullnetarizmi mund të gërshetohet me mekanizma të ndryshëm dhe për të parë ndërveprimin e shumanshëm me rregullimet ligjore dhe institucionale.

3.2.2 Kuadri strategjik mbi vullnetarizmin

Strategjia Kombëtare e Qeverisë Shqiptare për Zhvillim dhe Integrim (2015–2021) thekson se vizioni i qeverisë është "krijimi i një mjedisi mundësues për një shoqëri civile të fortë dhe të konsoliduar, që kontribuon në zhvillimin e shoqërisë dhe të vendit". Për më tepër, Strategjia Kombëtare identifikon tre objektiva strategjike në fushën e shoqërisë civile, ndër të cilat : objektivi 3 përcakton nxitjen e organizatave të shoqërisë civile, në përputhje me prioritetet kombëtare dhe rekomandimet e BE-së, duke përfshirë vullnetarizmin dhe pjesëmarrjen qytetare.

Udhërrëfyesit për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023, i rishikuar, përcakton mbështetjen dhe promovimin e punës vullnetare në:

Prioritetin 5: Mbështetja e vullnetarizmit të OSHC-ve dhe qytetarisë aktive me fokus të veçantënë nivel lokal. Ky prioritet përcakton 5 hapa kryesorë për vullnetarizmin:

5.1 Krijimi i një koncepti kombëtar për vullnetarizmin dhe qytetarinë aktive, duke përfshirë aktet nënligjore, rregullimin afatmesëm gjithëpërfshirës për vullnetarë dhe për organizatat që pranojnë vullnetarë sipas praktikave të mira të BE-së.

5.2 Përmirësimi i Ligjit për Vullnetarizmin, bazuar në konceptin kombëtar të vullnetarizmit, duke përfshirë aktet nënligjore (p.sh., kodin për vullnetarët), rregullimin e plotë afatmesëm për vullnetarët dhe për organizatat që pranojnë vullnetarë sipas praktikave të mira të BE-së, p.sh., çështja e sigurimeve.

5.3 Futja e skemave të financimit nga shteti për mbështetjen e gjithanshme të zhvillimit dhe menaxhimit të programeve të vullnetarëve nga OSHC-të.

5.4 Krijimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave mbi shpeshtësinë dhe përhapjen e aktiviteteve vullnetare (mundësisht përmes akteve nënligjore specifike që do të përcaktonin kërkesat e raportimit për organizuesit e punës vullnetare), si dhe mbi vlerën ekonomike dhe sociale të punës vullnetare.

5.5 Mbështetja për përfshirjen e grupeve specifike si: të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet dhe të papunët në të gjitha aksionet vullnetare.

Dokumenti i rishikuar i Udhërrëfyesit paraqet një sërë veprimesh dhe masash konkrete në një larmi fushash të ndërlidhura që plotësojnë njëra-tjetrën, përfshirë politikën e favorshme tatimore dhe një kuadri më të favorshëm ligjor, fiskal dhe institucional për nxitjen e vullnetarizmit dhe për mundësimin e nxitjes së filantropisë.

Vendimi parashikon, gjithashtu, se Ligji për Vullnetarizmin (nr. 45/2016) do të ketë nevojë për t'u zhvilluar më tej, duke rregulluar kështu qartësisht të gjitha mundësitë, të drejtat dhe detyrimet që lidhen me punën vullnetare. Do të miratohen akte nënligjore, që rregullojnë marrëdhënien midis vullnetarëve dhe organizatave pritëse. Ligji do të duhet të mishërohet në një koncept kombëtar për vullnetarizmin dhe qytetarinë aktive, i cili do të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile, duke ndjekur praktika evropiane të mira dhe të realizueshme në praktikë.

3.2.3 Kuadri institucional mbi vullnetarizmin

Nga pikëpamja institucionale, në nivelin e qeverisjes qendrore nuk ka ende një infrastrukturë të qartë në lidhje me menaxhimin dhe promovimin e vullnetarizmit. Megjithatë, **Udhërrëfyesi për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023,** i rishikuar, parashikon një sërë institucionesh që kanë përgjegjësinë kryesore në mbarëvajtjen për mbështetjen e vullnetarizmit, ndër të cilat një rol të rëndësishëm ka:

- Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, e cila do të kërkojë një ekip për asistencë teknike me ekspertë ndërkombëtare dhe vendas në hartimin mbi baza vullnetare të këtij koncepti, i cili do të konsultohet gjerësisht me sektorin.
- Shërbimi Kombëtar i Punësimit (përmes infrastrukturës së tij në të gjithë vendin) do të luaj një rol kyç në regjistrimin e OSHC-ve (dhe institucioneve të tjera jofitimprurëse) që janë të gatshëm të ofrojnë punë vullnetare, lëshimi i një numri reference dhe këto institucione mund të regjistrojnë më pas individë dhe t'i pajisin ata me librezë personale regjistrimi dhe dokumentet përkatëse. Dy ose tri herë në vit këto organe do të duhet të paraqesin një bazë të dhënash te Shërbimi Kombëtar i Punësimit, duke përfshirë detaje mbi vullnetarë të regjistruar ose të angazhuar.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka një rol të rëndësishëm për të finalizuar punën tashmë të filluar në një Kod Sjelljeje për Vullnetarët në konsultim me OSHC-të për këtë çështje.
- KKSHC-ja do të luajë një rol të rëndësishëm në sigurimin e bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile në të gjitha fazat e mëvonshme të procesit.
- Institucione të tjera të rëndësishme të cilat kanë një rol të rëndësishëm në mbështetje të vullnetarizmit janë: Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Kryeministria; AMSHC-ja.

Në nivelin e qeverisjes vendore janë ngritur Drejtoritë e Rinisë, me mision të zhvillojnë, pasurojnë, edukojnë dhe argëtojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse të rinjtë. Këto zyra kanë në misionin e tyre ofrimin e informacionit për programet dhe shërbimet rinore në dispozicion, të ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e kulturës së të rinjve përmes promovimit të programeve social- kulturore, si dhe të ofrojnë mbështetje

për organizatat apo individët nëpërmjet projekteve që pasurojnë jetën kulturore, sociale, artistike dhe edukuese të të rinjve. Ndonëse nuk ka studime që vlerësojnë efektivitetin e këtyre drejtorive në politikat rinore, këto struktura ekzistuese mund të fuqizohen për t'u ofruar të rinjve mundësi për angazhimet vullnetare në komunitetet ku jetojnë. Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2018-2020 në Bashkinë Tiranë përcakton si një ndër prioritetet e tij kryesore zhvillimin e kulturës dhe vullnetarizmin - krijimin e Korpusit të Rinisë (Bashkia Tirane, 2020).

4 METODOLOGJIA

Ky studim ka për qëllim të ofrojë një tablo të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse të vullnetarizmit në Shqipëri, duke vlerësuar situatën aktuale, mjedisin mundësues, qëndrimet dhe përvojat e qytetarëve në lidhje me vullnetarizmin. Hulumtimi synon të përmbushë katër objektiva specifikë si më poshtë:

1. Të eksplorojë perceptimet e përgjithshme të qytetarëve për vullnetarizmin dhe njëkohësisht të vlerësojë eksperiencat e tyre, motivimin në lidhje me kontributin vullnetar.
2. Të eksplorojë rreth shkaqeve për mosangazhimin në vullnetarizëm, duke eksploruar dhe analizuar njëkohësisht mënyrat më efektive për nxitjen dhe përfshirjen e qytetarëve në aktivitete vullnetare.
3. Të identifikojë rolin dhe sfidat e hasura nga autoritetet publike përgjegjëse, institucionet private dhe sektori i OSHC-ve të angazhuar dhe përgjegjës për vullnetarizmin dhe politikat për promovimin dhe nxitjen e vullnetarizmit.
4. Të vlerësojë se sa mundësues është kuadri aktual ligjor, institucional dhe politik për vullnetarizmin në Shqipëri, me qëllim përpilimin e rekomandimeve të bazuara mbi evidencë mbi kapërcimin e këtyre sfidave në mënyrë sistematike.

Në këtë hulumtim është përdorur një kombinim i qasjes kërkimore sasiore me atë cilësore. Edhe pse secila qasje ka avantazhet dhe kufizimet përkatëse, kombinimi i të dhënave të gjeneruara përmes të dyja qasjeve thekson pikat e forta të secilës, duke u kthyer kështu në një burim të besueshëm informacioni për vlerësimin e vullnetarizmit. Komponenti sasior është përdorur për të përshkruar dhe vlerësuar në terma sasiorë perceptimin dhe përvojat e qytetarëve në lidhje me vullnetarizmin, duke përfshirë një analizë të njohurive mbi kuadrin rregullator, institucionet që mundësojnë vullnetarizmin, eksplorimin e përvojave vetjake në lidhje me vullnetarizmin apo arsyet e mospërfshirjes, duke analizuar në fund mundësitë, sfidat e përfshirjes në punë vullnetare në të ardhmen.

Nga ana tjetër, qasja cilësore përdoret për të kuptuar dhe hedhur dritë mbi shprehjen e një fenomeni. Ajo mundëson një thellësi më të madhe shpjeguese dhe një të kuptuar të ngjyruar të çështjes nën shqyrtim. Qasja cilësore është shfrytëzuar, gjithashtu, për të mbledhur informacion cilësor, i cili është i vështirë për t'u marrë përmes pyetjeve të strukturuara. Të dhënat cilësore të regjistruara në audio dhe të transkriptuara u analizuan duke përdorur metodën e analizës së përmbajtjes.

Analiza përfshiu, gjithashtu, një rishikim të kuadrit institucional dhe rregullator. U mblodhën dhe shqyrtuan gjithë dokumentet dhe raportet relevantë të prodhuar

ndër vite nga organizatat ndërkombëtare, organizatat lokale, organet qeveritare dhe studimet akademike të cilat i referohen punës vullnetare në Shqipëri. Ky rishikim u përdor edhe si një mjet paraprak identifikues i boshllëqeve në praktikë, të cilat në vijim u hulumtuan në mënyrë sistematike në terren.

Për realizimin e këtij studimi u hartuan 3 instrumente bazë për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave: Intervistat e thelluara me institucionet qendrore, të cilat kanë rol në hartimin e politikave, ngritjen e mekanizmave etj; fokus grupet, aktorë kyçë në ofrimin dhe nxitjen e vullnetarizmit si: institucione vendore, organizata të shoqërisë civile, media, institucionet arsimore dhe shëndetësore, (instrumentet cilësore); dhe pyetësor gjysmë i strukturuar për qytetarët mbi 15 vjeç (instrumenti sasior).

- ***Instrumenti sasior:***

Kampionimi: Popullata e synuar ishin 1100 qytetarë të Shqipërisë, duke filluar nga mosha 15 vjeç, deri në moshën mbi 65 vjeç. Shtrirja territoriale e anketimit ishte në 12 qarqet e Shqipërisë (Berat 27%, Dibër 2 %, Durrës 8%, Elbasan 8, Fier 4%, Gjirokastër 4%, Korçë 2%, Kukës 2%, Lezhë 5%, Shkodër 5%, Tiranë 30%, Vlorë 2%).

Pyetësorët u zhvilluan online nëpërmjet platformës *google form* si dhe i printuar për ata individë që nuk mundeshin të përdornin mjetet digjitale. Projekte Vullnetare Ndërkombëtare, OSHC-pjesë e konsortiumit dhe vullnetarë ndihmuan në një masë të madhe në shpërndarjen dhe plotësimin e pyetësorit online përmes publikimit në media sociale dhe kontakteve të drejtpërdrejta.

Të dhënat e mbledhura u përpunuan nga ana statistikore me paketën statistikore SPPSS. Analiza univariate dhe bivariate u krye për të përshkruar dhe shqyrtuar marrëdhëniet mes karakteristikave të anketuarve në nivel individual. Në këtë studim është përdorur testi *Hi-katror* për të gjetur lidhjen mes ndryshoreve bazë dhe atyre që janë përzgjedhur. Testi *Hi-katror* bazohet në një statistikë që mat divergjencën e të dhënave të vëzhguara nga vlerat e pritura nën hipotezën zero, se nuk ka lidhje mes variablave. Testi *Hi-katror* (chi-square test) është metoda për testimin e lidhjes mes variablave rresht dhe kolonë në një tabelë me dy hyrje.

Rekrutimi i të anketuarve ishte disi sfidues në fillim të mbledhjes së të dhënave, pasi shpërndarja online e pyetësorit jo gjithmonë mundësonte një shpërndarje të drejtë në aspektin e variablave të pavarur, sikurse është mosha, gjinia, shpërndarja gjeografike. Në këto kushte është administruar një pyetësor ballë për ballë, veçanërisht me personat mbi moshën mbi 60 vjeç, të cilët e kishin të pamundur të plotësonin pyetësorin online. Rreth 150 pyetësorë janë plotësuar ballë për ballë me qytetarët.

- Instrumentet cilësor:

Të dhënat cilësore u përdorën gjithashtu për të validuar të dhënat sasiore të anketës.

Intervista të thelluara: Informacion nga aktorë kyçë në nivel vendor dhe qendror, politikëbërës apo aktorë të shoqërisë civile, me synimin për të identifikuar

dhe eksploruar fenomenin më në thellësi. Intervista të thelluara me 17 përfaqësues nga institucionet qendrore, vendore dhe shoqëria civile.

Diskutimet në fokus grupe (DFG) janë të përshtatshme për nxjerrjen e besimeve, perceptimeve dhe kuptimeve në një kontekst të përbashkët. Qëllimi i fokus grupeve është të kuptojë dhe të analizojë praktikat, sfidat dhe mundësitë e ofruesve të vullnetarizmit në Shqipëri. Në total u organizuan 16 fokus grupe, ku morën pjesë rreth 115 përfaqësues si ofrues vullnetarizmi, përfshirë aktorë të ndryshëm të shoqërisë nga 12 qarqe të Shqipërisë, veçanërisht organizata të shoqërisë civile, mësues të shkollave të mesme, përfaqësues të medias, pedagogë nga universitete, institucionet shëndetësore, qendrat e kujdesit ditor, institucionet fetare, institucionet vendore etj.

Përmes përfshirjes së aktorëve të ndryshëm u synua të eksplorohen se cilat janë sektorët, tematikat, kohëzgjatja, trendet e shërbimeve vullnetare. Fokus grupet zgjatën rreth 1.5 – 2 orë dhe u përfshinë mesatarisht 6-8 persona secili.

5 RAPORTIMI I GJETJEVE TË STUDIMIT

Në këtë kapitull sillen të gjitha të dhënat sasiore të mbledhura nga qytetarët dhe ato cilësore mbledhura nga ofruesit e vullnetarizmit si dhe institucionet politikëbërëse në nivel qendror dhe lokal. Gjithashtu, ketu trajtohet edhe analiza e gjetjeve të studimit kombëtar.

TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

Karakteristikat demografike kryesore të kampionit përfundimtar të të anketuarve jepen më poshtë në lidhje me gjininë, përfaqësimin gjeografik, moshën, arsimin, statusin e punësimit.

GJINIA

Grafiku 1. Shpërndarja e pjesëmarrësve në studim sipas gjinisë.

Nga 1100 të anketuar, 74% ishin femra dhe 26% meshkuj.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE



Grafiku 2. Shpërndarja e pjesëmarrësve në studim sipas vendbanimit

Shpërndarja gjeografike ishte si më poshtë : Berat 27%, Dibër 2 %, Durrës 8%, Elbasan 8, Fier 4%, Gjirokastër 4%, Korçë 2%, Kukës 2%, Lezhë 5%, Shkodër 5%, Tiranë 30%,Vlorë 2%.

GRUPMOSHA



Grafiku 3. Shpërndarja e pjesëmarrësve në studim sipas grupmoshës

Për sa i përket shpërndarjes moshore, pjesa më e madhe: 33% ishin 18 dhe 29 vjeç, 30% i përkasin grupmoshës 30-45 vjeç, 22% ishin 15-17 vjeç, 12.5% ishin 46-65 vjeç dhe 3% mbi 65 vjeç.

EDUKIMI



Grafiku 4. Shpërndarja e pjesëmarrësve në studim sipas nivelit të edukimit

Shumica e të anketuarve (43%) kishin mbaruar arsimin e lartë. 31% kishin përfunduar arsimin e mesëm; ndërkohë që 22% ose kishin përfunduar, ose ishin duke ndjekur arsimin terciar pasuniversitar). Vetëm 3% e të anketuarve kishin përfunduar arsimin e detyrueshëm nëntëvjeçar dhe vetëm 1 % nuk kishin fare arsim ose kishin përfunduar vetëm atë fillor.

PUNËSIMI



Grafiku 5. Shpërndarja e pjesëmarrësve në studim sipas statusit të punësimit

Nga të anketuarit, 39% ishin studentë në kohën që u realizua ky sondazh, ndjekur nga të punësuarit në sektorin publik që përbëjnë 28% të kampionit. 13% e të anketuarve ishin të punësuar në sektorin privat dhe 6% në sektorin e OSHC-ve. Nga të anketuarit 6% ishin të papunë dhe vetëm 5% ishin të vetëpunësuar, ndërkohë që 3% ishin pensionistë.

5.1. Njohuri të përgjithshme dhe perceptimet rreth vullnetarizmit

5.1.1 Perceptimi dhe koncepti i vullnetarizmit

Vullnetarizmi perceptohet pjesëmarrje me vullnet të lirë në një veprimtari pa asnjë lloj përfitimi material dhe në dobi të një kauze, personi apo një grupi individësh. Vullnetarizmi perceptohet shpesh si një parim apo vlerë që buron nga pirja e brendshme e individit për të qenë i dobishëm në komunitetin ku ai jeton. Për një pjesë të konsiderueshme të pjesëmarrësve në fokus grupe, puna vullnetare konsiderohet një kontribut i papaguar që e pajis individin me vlera përtej përfitimit material dhe personal. Angazhimi vullnetar i individëve ka një impakt pozitiv në mirëqenien mendore, duke qenë se edhe përfitimi i tij shihet kryesisht në aspektin moral dhe shpirtëror (Fokus grup nr.6, përfaqësues nga institucionet arsimore nga bashkitë Kamëz, Elbasan, Rrogozhinë, Përrenjas datë 22.02.2021).

Megjithatë, pritja për ta përkufizuar vullnetarizmin si një aktivitet që kryhet përgjithësisht në raste të caktuara, si situata emergjente apo të fatkeqësi natyrore, është disi e cunguar, pasi vullnetarizmi perceptohet shpeshherë si një ***detyrim moral, shoqëror dhe personal në dobi të komunitetit*** dhe një dëshirë e pakushtëzuar që buron nga vetë individi dhe nevoja për të qenë i dobishëm në komunitet:

Të jesh vullnetar për mua do të thotë të jesh në ndihmë të komunitetit, t'i shërbesh komunitetit pa pritur asgjë në shkëmbim, përveç se atyre përfitimeve shpirtërore, jo përfitime material. (*Fokus grup nr.6,* përfaqësues nga *institucionet arsimore nga bashkitë Kamëz, Elbasan, Rrogozhinë, Përrenjas datë- 22.02.2021).*

Është mjaft e rëndësishme dalja në pah e vlerave të vullnetarizmit, kur këto vlera evidentohen nga qytetarët, ashtu dhe ofruesit e vullnetarizmi, të cilët janë dëshmitarë të drejtpërdrejtë të impaktit që ai jep te çdo individ, në forma të ndryshme të vullnetarizmit, ashtu dhe në kohë krize apo jo. Sot flasim për vullnetarizëm me vullnet të lirë, koncept që nuk lidhet më të shkuarën dhe që sjell në pah vlerat humanitare dhe të solidaritetit. Mënyra se si ky koncept ka ndryshuar në mendësinë e qytetarëve dhe institucioneve na fakton më tepër se si koncepti evoluon në varësi të zhvillimeve social -kulturore, por vlerat qëndrojnë të njëjta.

Sot vullnetarizmi merr një kuptim tjetër, pasi buron nga shpirti, nga nevoja, edukata etj. Vullnetarizmi është shpirt, ai nuk ka kohë dhe nuk duhet të jetë prezent vetëm në rastet e fatkeqësive natyrore, kombëtare apo mbarëkombëtare, por duhet të jetë një parim. (Fokus grup nr.5, përfaqësues nga bashkitë Tropojë, Elbasan, Kukës OSHC-të, media, datë 18.03.2021).

Vullnetarizmi perceptohet si një kontribut në dobi të qytetarëve dhe komunitetit që na rrethon. Në themel të vullnetarizmit ekziston gjithmonë nevoja e pakushtëzuar për të ndihmuar të tjerët, për tu bërë qytetarë të dobishëm, për të qenë empatik dhe human pa u evidentuar domosdoshmërish publikisht. Një pjesë e të pyeturve

mendojnë se vullnetarizmi duhet nxitur pasi është një praktikë e domosdoshme që bën njerëzit më të mirë, dhe se vullnetarët përfitojnë dhe vetë kaq shumë vlera.

*Vullnetarizmit ekziston dhe humanizmi gjithashtu, nuk ka nevojë të mbahet deklaratë… nuk ka nevojë të bëhet publik dhe as mediatik. (Fokus grup nr.8, p*ërfaqësues nga *institucionet arsimore nga bashkitë Vorë, Sarandë, Shijak, Tiranë datë 24.02.2021).*

Zhvillimet sociale kanë marrë dimensione të gjera, ku vullnetarizmi konsiderohet si një qasje që ka rol thelbësor apo si një bashkudhëtar në zhvillimet sociale.

*Vullnetarizëm do të quaja nismën e përbashkët në funksion të së mirës përkundrejt një komuniteti. Do ta quaja vullnetarizmin si një rrugëtim, si një binar ku çdo hap që hidhet dhe ajo që na bashkon nuk është gjë tjetër veçse një e mirë e përbashkët dhe thua që ia vlejti kjo që mora përsipër. Vullnetarizmin e shikoj si një dritë jeshile në këtë kryqëzimin e madh të ideve sociale. (Fokus grup nr.8, p*ërfaqësues nga *institucionet arsimore nga bashkitë Vorë, Sarandë, Përmet, Shijak, Tiranë datë 24.02.2021).*

Pjesëmarrësit në fokus grupe shprehen se mosha mesatare e personave që përfshihen në aktivitete vullnetare janë në një moshë relativisht të re, rreth 15-29 vjeç, dhe kryesisht janë nxënësit e shkollave profesionale apo gjimnazeve të përgjithshme, por edhe studentët, ata që angazhohen më së shumti.

*Sigurisht, mosha nuk është kriter për vullnetarizëm mendoj unë, pasi një person vullnetarizmin duhet ta ketë në gjak dhe jo në moshë. Mund të themi një person madhor, por nuk mund ta kufizojmë me rinin*ë. (Fokus grup nr.12, përfaqësues nga bashkitë Shkodër dhe Lezhë, datë 10.03.2021).

*Ndonëse të rinjtë përbëjnë një ndër segmentet kryesore të personave që përfshihen në nisma qytetare vullnetare, fasha moshore e vullnetarëve ka një spektrum më të madh. Në përgjithësi, vullnetarizmi perceptohet si një aktivitet që angazhon kryesisht të rinjtë. (Fokus grup nr.2, p*ërfaqësues nga OSHC-të, datë 11.03.2021).

Megjithatë, është e rëndësishme që të rritet niveli i informimit, ndërgjegjësimit si dhe modeleve nga vende të ndryshme se vullnetarizmi nuk ka moshë, vullnetar mund të jetë kushdo. E nëse do t'i referohemi Ligjit të Vullnetarizmit në Shqipëri vullnetar mund të jetë çdo individ mbi 15 vjeç. Sigurisht që të rinjtë janë një potencial shumë i madh, pasi përveç vullnetit të lirë, shprehjes së qytetarisë, lidhja me tregun e punës janë faktorë të rëndësishëm motivues për ta. Megjithatë, vihet re dhe në grafikët në vijim se interesat për vullnetarizëm janë të moshave të ndryshme.

Koncepti i vullnetarizmit ka ndryshuar dhe evoluar me kalimin e kohës. Koncepti i vullnetarit konsiderohet shpeshherë si një nocion i vjetërsuar dhe "demode", në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës, por jo për nga ana përmbajtësore. Për këtë arsye, një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve në fokus grupe preferojnë që t'i përkufizojnë vullnetarët me termin "aktivistë" (Fokus grup nr.3, përfaqësues nga OSHC-të, datë 16.03.2021). Një arsye tjetër pse përdoret termi aktivist dhe jo vullnetar është për të evituar detyrimet që institucioni ka ndaj vullnetarëve që janë subjekt i Ligjit mbi Vullnetarizmin. Gjithashtu, disa përfaqësues të organizatave lokale përdorin termin aktivist, sepse vullnetarizmi shpeshherë shihet i lidhur dhe diktuar nga periudha komuniste, i cili perceptohet negativisht si një punë që individi shfrytëzohet

e duke mos pasur mundësi për rritje profesionale apo personale. Ata nuk duan që ky perceptim negativ të influencojë përqasjen dhe motivimin e vullnetarëve.

Vullnetarizmi ka të bëjë me koncepte afatgjate, që na vijnë edhe nga e kaluara, por jemi larg vullnetarizmit të para '90-tës të periudhës së prindërve tanë, ku ishte një vullnetarizëm i detyruar, i kushtëzuar nga shteti. (*Fokus grup nr.13, p*ërfaqësues nga OSHC-të Durrës, Lezhë, Tiranë, datë *10.03.2021).*

Të dhënat e anketës së realizuar me qytetarët tregojnë për një domosdoshmëri të praktikave dhe ndërgjegjësimit mbi vullnetarizmin, duke qenë se vullnetarizmi sjell përfitime të dyfishtë si për shoqërinë, ashtu edhe për individin.

Gjatë fokus grupeve me mësues, por dhe intervistave me institucionet e edukimit, kemi vënë re se koncepti i vullnetarizmit lidhet gjithashtu shumë ngushtë me aktivitete që organizohen në shkollat e mesme apo ato 9-vjeçare, në kuadër të orëve komunitare për të marë kreditet e caktuara apo notën përkatëse. Bazuar në vlerat dhe parimet e vullnetarizmit, aktivitetet e organizuara në shkollë në kuadër të orëve mësimore nuk mund të konsiderohen aktivitete vullnetare.

5.1.2 A është i nevojshëm kontributi vullnetar në Shqipëri?

Pjesa me e madhe e të pyeturve (77%) besojnë se kontributi vullnetar në Shqipëri është shumë i nevojshëm. Ndërkohë, 22 % mendojnë se është i nevojshëm dhe një pjesë pothuajse e papërfillshme 1% mendojnë se nuk është aspak i nevojshëm. Këto janë të dhëna që akoma më shumë na bëjnë të marrim me më shumë përgjegjësi nxitjen e vullnetarizmit në vend, sepse për sa kohë qytetarët e vlerësojnë të nevojshëm, ata janë të ndërgjegjshëm ndaj nevojave në shoqëri dhe me disa politika nxitëse dhe praktike shumë prej tyre mund të jenë të gatshëm të jenë vullnetarë potencialë në të ardhmen. Përqasja pozitive e sektorit privat na hap një perspektivë më të gjerë për të kuptuar dhe analizuar nevojat në proporcion me mundësitë dhe si ky sektor mund të jetë një potencial i mirë dhe cilësor në fushën e vullnetarizmit.



Grafiku 6. Nevoja për kontribut vullnetar, sipas grupmoshës së pjesëmarrësve në studim

Grupmosha 30-45 vjeç shprehet për një dakordësi më të lartë në krahasim me grupmoshat e tjera në lidhje me përfitimet e kontributit vullnetar. Kjo na tregon se cilat janë moshat në të cilat politikat dhe nismat e nxitjes së vullnetarizmit duhet të kenë fokus për t'i përfshirë dhe me cilat mosha duhet punuar më shumë në lidhje me ndërgjegjësimin dhe motivimin.



Grafiku 7. Nevoja për kontribut vullnetar, sipas gjinisë së pjesëmarrësve në studim

Gjinia femërore është më e predispozuar të mendojë pozitivisht në lidhje me nevojën për kontribut vullnetar (80%), kundrejt (70%) meshkuj.



Grafiku 8. Nevoja për kontribut vullnetar, sipas nivelit të edukimit të pjesëmarrësve në studim

Personat me edukim më të lartë arsimor kanë tendencën për ta konsideruar nevojën për kontribut vullnetar shumë të nevojshëm (83%) e personave me arsim pasuniversitar, përkundrejt 50% të atyre me arsim fillor. Një e dhënë e tillë tregon se sa më i lartë të jetë niveli i edukimit, aq më e lartë edhe prirja post-materialiste e individëve. Megjithatë, duke qenë se individët me arsim më të lartë kanë predispozitë për të pasur një jetë social-ekonomike më të mirë në krahasim me personat me arsim relativisht të ulët, mund të jetë një faktor shtytës në tendencat pro-vullnetarizëm.



Grafiku 9. Nevoja për kontribut vullnetar, sipas profesionit të pjesëmarrësve në studim

Të dhënat e grafikut më sipër tregojnë se përfaqësuesit nga sektori i OSHC-ve janë më të prirur të vlerësojnë si shumë të domosdoshëm kontributin vullnetar, ndjekur nga përfaqësuesit nga sektori privat dhe të papunët. Interesant është fakti që rreth ¼ (25%) e personave nga sektori publik dhe ¼ (19%) e personave të vetëpunësuar nuk e shohin të nevojshëm kontributin vullnetar. Kjo e dhënë tregon që është e nevojshme të punohet akoma më shumë me sektorin publik dhe personat e vetëpunësuar, për t'u krijuar atyre bindjen se vullnetarizmi është i domosdoshëm në shoqërinë shqiptare. Nëse sektorë të tjerë do të jenë më shumë të ndërgjegjësuar rreth impaktit që sjell, sektori i vullnetarizmit do të ishte shumë më i qëndrueshëm dhe gjithashtu do të sillte bashkëpunime më të mira ndërmjet sektorëve. Sipas studimit të UNV, 2011, vullnetarizmi nuk është shtylla kurrizore vetëm e sektorit të shoqërisë civile, por dhe e institucioneve të edukimit, shëndetësisë, sektorit privat etj.

Gjithashtu, nga të dhënat e mbledhura nga fokus grupet, të gjithë këto sektorë janë shumë të gatshëm të jenë potencial aktiv për të "përfituar" nga vullnetarizmi dhe do të donin shumë të kenë disa politika për të përthithur vullnetarë. Nga ana tjetër, ka institucione arsimore dhe bashki, të cilat e shohin përfshirjen e vullnetarëve si një ngarkesë shtesë, pasi nuk kanë burime të mjaftueshëm apo të dedikuara njerëzor që të fokusohen në organizimin e aktiviteteve vullnetare apo në menaxhimin e tyre.

"Në bashkinë tonë nevoja për vullnetarizëm është shumë e madhe, këtë na e tregoi si tërmeti, ashtu dhe pandemia se çfarë ndikimi pozitiv na dhanë ne vullnetarët. Por kemi një problem madhor, koordinimi i tyre, ne nuk kemi kapacitete të organizojmë vullnetarët, t'i mbajmë të motivuar, të informuar. Është shumë e nevojshme që të jenë organizatat e shoqërisë civile ato që të na japin një dorë të mirë (Fokus grup me bashkitë Durrës, Gjirokastër, Sarandë, datë 11.03.2021).

5.1.3 Përfitimet nga kontributi vullnetar



Grafiku 10. Perceptimi mbi kontributin vullnetar i pjesëmarrësve në studim

Të anketuarit (qytetarët) janë pyetur në një shkallë nga 1- 5 (1-aspak dakord-5 plotësisht dakord) deri në çfarë mase pajtoheni me secilin nga qëndrimet në lidhje me kontributin vullnetar dhe pjesa më e madhe e të pyeturve perceptojnë se vullnetarizmi sjell përfitime për vullnetarët dhe komunitetin (94%); vullnetarizmi nënkupton angazhimin qytetar në dobi të komunitetit (94%); vullnetarizëm do të thotë angazhim me vullnet të lirë (94%). Për një pjesë të konsiderueshme të të pyeturve vullnetarizëm do të thotë të ndihmosh të tjerët (90%); vullnetarizmi nxit ndjenjën e solidaritetit në komunitet (86%). Dhe pse qytetarët e pyetur kanë qenë të moshave të ndryshme, vihet re qartë një qëndrim pozitiv rreth konceptit të vullnetarizmit, si dhe përfitimet që ai sjell për shoqërinë dhe individin.

Një pjesë e pjesëmarrësve në fokus grupe shprehen se përfitimet e vullnetarizmit janë përtej anës monetare dhe materiale. Megjithatë, ndonëse nuk ka një pagesë monetare, vullnetarët përfitojnë më shumë njohuri dhe përvoja jetësore të dobishme. Këto janë tregues shumë të mirë për zhvillimin e hapave më konkret në të ardhmen, pasi vëmë re një këndvështrim të hapur nga ana institucionale, veçanërisht ofruesve të vullnetarizmit. Pra, vullnetarizmi perceptohet si një aktivitet ku individi jep, më shumë sesa merr:

Këtu në Shqipëri ne duan diçka në këmbim të asaj që bëjmë dhe jo gjithmonë duam ta bëjmë falas diçka, jo gjithmonë duam të kontribuojmë për diçka. Por e mira është se kur kontribuon falas, në një farë mënyre ti përfiton, nuk e merr monetar, *por përfiton shpirtërisht (Fokus grup nr.6,* përfaqësues nga *institucionet arsimore dhe shëndetësorë nga bashkitë Kamëz, Elbasan, Rrogozhinë, Përrenjas, datë 22.02.2021).*



Grafiku 11. Përfitimet e kontributit vullnetar sipas grupmoshës

Siç vihet re nga grafiku i mësipërm, grupmosha më e shpeshtë të pyeturve të cilët bien dakord për përfitimet pozitive të vullnetarizmit është 30-45 vjeç dhe 46-65 vjeç (93%).



Grafiku 12. Përfitimet e kontributit vullnetar sipas gjinisë

Femrat janë disi më të predispozuara se meshkujt për të menduar pozitivit në lidhje me përfitimet e vullnetarizmit, (91%) përkundrejt (87%) të meshkujve.



Grafiku 13. Përfitimet e kontributit vullnetar sipas nivelit të edukimit të pjesëmarrësve në studim

Të dhënat e anketës tregojnë një gjetje interesante në lidhje me nivelin e edukimit dhe përfitimet e kontributit vullnetar. Pra, sa më i lartë të jetë niveli i edukimit, aq më pozitive është tendenca për të besuar në përfitimet pozitive të punës vullnetare. Të pyeturit me nivel fillor janë më skeptikë për përfitimet e vullnetarizmit, duke qenë se rreth 17% e tyre nuk bien dakord me qëndrimin se vullnetarizmi sjell efekte pozitive, ndërkohë rreth 95% e personave me nivel pasuniversitar dhe 93 % e atyre me nivel të lartë arsimi besojnë se vullnetarizmi sjell efekte pozitive.



Grafiku 14. Përfitimet e kontributit vullnetar sipas profesionit të pjesëmarrësve në studim

Në përgjithësi ka një tendencë pozitive të lartë nga të gjithë sektorët në lidhje me përfitimet nga vullnetarizmit. Megjithatë, sipas grafikut mësipërm përfaqësuesit nga OSHC-të (100%) dhe sektori privat zënë një përqindje më të lartë në krahasim me përfaqësuesit nga sektorët e tjerë dhe kjo lidhet dhe me eksperiencat e drejtpërdrejta që sektori civil ka në këtë aspekt, duke qenë dëshmitar i impaktit te vullnetarët, ashtu dhe te komuniteti dhe shoqëria.



Grafiku 15 . Qëndrimet ndaj kontributit vullnetar i pjesëmarrësve në studim



Grafiku 16. Ndikimi i vullnetarizmit tek individi midis pjesëmarrësve në studim

Të intervistuarit janë pyetur se si ndikon vullnetarizmi tek individi/vullnetar në një shkallë në 1 aspak dakord- 5 plotësisht dakord. Pjesa më e madhe e të pyeturve 92% bien dakord se vullnetarizmi ndikon në rritjen e socializimit, krijimin e kontakteve me njerëz të rinj; rritjen e vetëbesimit; përmirësimin e aftësive të të komunikuarit; përfitimin e eksperiencave dhe aftësive praktike (91%). Një pjesë tjetër e konsiderueshme (88%) besojnë se vullnetarizmi nxit të menduarin kritik; përmirëson shëndetin psikologjik, mendor; ndikon në rritjen personale, njohjen më të mirë të vetvetes dhe vetëpërmbushje (89%). Nga të gjitha alternativat e parashtruara, rreth 17% janë skeptikë nëse vullnetarizmi ndikon në integrimin më të shpejtë në tregun e punës apo rritjen e mundësive për punësim. Ndonëse integrimi në treguan e punës konsiderohet si një ndër benefitet pozitive të vullnetarizmit, fakti që puna vullnetare në Shqipëri nuk vlerësohet si një eksperiencë pune apo nuk njihet zyrtarisht nga institucionet i bën individët skeptikë në lidhje me këtë përfitim.

Për sa u përket të dhënave të mbledhura nga fokus grupet me aktorët, ofrues të vullnetarizmit, shkojnë në të njëjtën linjë ashtu si dhe mendimet e qytetarëve. Përfaqësues të shoqërisë civile argumentojnë se përfitimi i vullnetarëve nga vullnetarizmi nuk duhet të fillojë apo të jetë nxitja bazë për përfitimet në tregun e punës, padyshim ai është një përfitim i drejtpërdrejtë dhe i pashmangshëm, por theksi duhet t'ju vihet dhe përfitimeve të tjera, të cilat janë shumë të rëndësishme, ashtu dhe afatgjata, si p.sh., aftësitë për jetën, aftësitë për të punuar në grup, menaxhimi i emocioneve, menaxhimi i konflikteve etj.



Grafiku 17. Ndikimi i vullnetarizmit në shoqëri midis pjesëmarrësve në studim

Të anketuarit u pyetën të jepnin këndvështrimin e tyre në lidhje me ndikimin e vullnetarizmit në shoqëri, duke vlerësuar nga 1= aspak dakord në 5= plotësisht dakord alternativat. Pjesa më e madhe e të anketuarve 91% besojnë se vullnetarizmi përmirëson jetën në komunitet; duke sjellë ndryshime pozitive në çdo institucion (89%); nxitur solidaritetin dhe kohezionin social (89%); fuqizuar grupet në nevojë (88%). Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e të pyeturve (rreth ¼ nuk bien dakord që vullnetarizmi ndikon në rritjen ekonomike në vend. Të dhëna të tilla tregojnë që është e nevojshme që institucionet duhet të advokojnë më shumë për të nxitur studime, me qëllim nxjerrjen e evidencave në lidhje me kontributin vullnetar në shoqëri, qoftë atë ekonomik apo social. Shumë studime ndërkombëtare argumentojnë se matja e efektit ekonomik do të nxiste politika më të mira kombëtare, si dhe inkurajonte qeverinë të trajtojë me prioritet nxitjen e vullnetarizmit.

Institucionet kompetente në Shqipëri për politikat dhe praktikat e vullnetarizmit, përfshirë dhe Ministrinë e Financave, nuk kanë të dhëna dhe as informacione se çfarë impakti jep vullnetarizmi në shoqëri, qoftë në aspektin social, qoftë në atë ekonomik.

5.1.4 Njohuritë mbi mundësitë për të ofruar kontribut vullnetar

Nga të gjithë të dhënat e mbledhura në përgjithësi rezulton se qytetarët nuk kanë mjaftueshëm njohuri në lidhje me institucionet apo mundësitë që mund të ekzistojnë për të dhënë kontributin e tyre vullnetar. Janë rreth 59% e të anketuarve që pohojnë se kanë informacion se ku mund të drejtohen në rast se dëshirojnë të japin kontributin e tyre vullnetar, ndërkohë që 41% pohojnë të kundërtën. Grupmosha e cila ka njohurinë më të mirë në lidhje me institucionet ku mund të drejtohen për vullnetarizëm është grupmosha 30-45 vjeç (70%). Problematik është fakti që të rinjtë e moshës 18-29 vjeç (44%) janë pothuajse në një nivel me pensionistët (46%) për sa i përket informacionit në lidhje me këtë pyetje. Ko tregon nevojën emergjente për të sensibilizuar dhe rritur nivelin e informacionit te të rinjtë në lidhje me orientimin për kontributin vullnetar, por dhe te mosha e tretë, pasi të dyja janë potenciale shumë

të mira për zhvillimin shoqëror. Është e rëndësishme të konsiderohet nxitja dhe aktivizimi i moshës së tretë në aktivitete vullnetare për shkak të shembullit që ata sjellin, përqasjes dhe investimit të çmuar që japin me njohuri dhe eksperiencë.



Grafiku 18. Informacioni ku mund të drejtoheni nëse doni të jepni kontribut vullnetar, sipas grupmoshës së pjesëmarrësve në studim



Grafiku 19. Informacioni ku mund të drejtoheni nëse doni të jepni kontribut vullnetar, sipas gjinisë së pjesëmarrësve në studim

Të dhënat e studimit tregojnë që si meshkujt (43%), ashtu dhe femrat (41%), nuk dinë ku të orientohen në lidhje me kontributin vullnetar që mund të japin.



Grafiku 20 . Informacioni ku mund të drejtoheni nëse doni të jepni kontribut vullnetar, sipas nivelit të edukimit të pjesëmarrësve në studim

Sërish, siç vihet re nga grafiku nr. 20, sa më i lartë të jetë niveli i edukimit, aq më të larta janë edhe njohuritë për orientimin me praktikat vullnetare. Rreth 71% të atyre me arsim pasuniversitar dinë se ku të orientohen në lidhje me ofrimin e kontributit vullnetar. Ndërkohë, pjesa dërrmuese e atyre me arsim 8/9 vjeçar (4/5 ose 82%) dhe (¼ ose 75%) e atyre me arsim fillor nuk kanë informacion në lidhje me orientimin për vullnetarizmin.



Grafiku 21. Informacioni ku mund të drejtoheni nëse doni të jepni kontribut vullnetar, sipas profesionit të pjesëmarrësve në studim

Grafiku më sipër tregon që personat me orientim më të mirë në lidhje me vullnetarizmin janë ata nga OSHC-të (87%), ndërkohë studentët (50%); të papunët (44%) dhe pensionistët (58%), janë më pak të ndërgjegjësuar. Një e dhënë e tillë sërish sugjeron nevojën për më shumë ndërgjegjësim të grupmoshave të reja, siç janë studentët në lidhje me praktikat vullnetare.

Të gjithë ata që dinë se ku të marrin informacione apo të orientohen për kontribut vullnetar kanë dhënë një listë me institucione që ata mendojnë se janë të hapura dhe të gatshme si ofrues potencialë vullnetarizmi. Institucionet më të përmendura nga pjesëmarrësit që kanë zgjedhur vetëm një alternativë janë: organizata të shoqërisë civile, bashkinë/njësinë administrative dhe qendrat rinore. Ndërkohë që nga pjesëmarrësit të cilët kanë zgjedhur 2 apo 3 alternativa, vihet re kombinimi: organizata të shoqërisë civile, bashkinë/njësinë administrative, median sociale dhe kontaktet shoqërore apo familjare dhe më pak përgjigje ku përfshiheshin edhe qendrat rinore.

Tabela 1. Ku mund të drejtoheni për të dhënë kontributin tuaj vullnetar, ku e gjeni këtë informacion

NDRYSHORI	NUMRI	PËRQINDJA
Alternativat:		
1 alternativë	684	61.9
2 alternativa	258	23.4
3 alternativa	162	14.7

Tabela 2. Sektorët që ofrojnë mundësi vullnetarizmi në Shqipëri

NDRYSHORI	NUMRI	PËRQINDJA
Alternativat:		
1 alternativë	634	57.4
2 alternativa	267	24.2
3 alternativa	203	18.4

Gjithashtu, institucionet më të përmendura nga subjektet e studimit që kanë zgjedhur vetëm një alternativë janë: organizata të shoqërisë civile, institucionet arsimore, institucionet publike në nivel vendor, qendrat rinore/sociale/komunitare/ multidisiplinare dhe sektori i shëndetësisë. Nga ana tjetër, pjesëmarrësit të cilët kanë zgjedhur 2 ose 3 alternativa theksohet kombinimi: organizata të shoqërisë civile, qendrat rinore/sociale/komunitare/multidisiplinare, institucionet arsimore dhe institucionet publike në nivel qendror dhe vendor. Pra, organizatat e shoqërisë cilivile prevalojnë si ofruesit më potencialë si ofrues vullnetarizmi dhe që individët do të drejtohen aty apo presin prej këtij sektori për t'i ftuar dhe angazhuar.

5.1.5 Njohuritë rreth Ligjit të Vullnetarizmit dhe Librezës së vullnetarit

Pjesa më e madhe e të anketuarve nuk janë në dijeni të Librezës së vullnetarit (87%) dhe një pjesë shumë e vogël 13% janë në dijeni. Rreth 2/3 e të anketuarve nuk kanë informacion për Ligjin mbi Vullnetarizmit dhe më pak se 1/3 kanë informacion, i cili është i pamjaftueshëm, ndërsa 4% nuk kanë aspak informacion.

Dhe në këtë aspekt, del nevojë shumë e madhe që të rritet niveli i informacionit te qytetarët. Gjithashtu, rreth 80 % e të përfshirëve në fokus grupe (ofruesit e vullnetarizmit), nuk kanë informacion aspak rreth ligjit dhe librezës. Janë vetëm 20 % e tyre që dinë se ekziston një ligj, por nuk janë në dijeni të specifikave ligjore apo përmbajtjes tërësorë të ligjit, nuk e kanë lexuar asnjëherë apo nuk dinë aspak sa i diskutueshëm është ky ligj. Nga ky 20 % që kanë informacione, veçanërisht janë përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët kanë qenë pjesë e diskutimeve dhe konsultimeve rreth ligjit. Mungesë e theksuar informacioni është evidentuar dhe gjatë intervistave me institucionet qendrore politikëbërëse, të cilat janë përgjegjëse për implementimin e ligjit.

5.2 Eksperiencat, trendet dhe preferencat për kontribut vullnetar

5.2.1 Eksperiencat vullnetare

Pyetjes në rast se keni apo jo eksperienca vullnetare, pjesa më e madhe e të anketuarve (69%) pohojnë se kanë përvojë vullnetare. Këtu duhet të marrim parasysh se plotësimi i këtij pyetësori është bërë veçanërisht nga individë/qytetarë që kanë akses ndaj informacionit, mundësive dhe teknologjisë. Në vijim është një pasqyrim i eksperiencave të vullnetarizmit të ndara sipas grupmoshës, edukimit dhe gjinisë me qëllim identifikimin e specifikave, për të na ndihmuar dhe në vijim në ndërmarrjen e iniciativave të nevojshme.



Grafiku 22. Eksperiencat vullnetare sipas grupmoshës së pjesëmarrësve në studim

Rreth një e katërta e personave të grupmoshës 30-45 vjeç (75%), 70 % e grupmoshës 46-65/18-29/15-17 vjeç pohojnë se kanë pasur një eksperiencë vullnetare. Në këtë rast konfirmojmë se vullnetarizmi jo domosdoshmërish është i lidhur më të rinjtë, jo domosdoshmërish me tregun e punës, pasi mosha 30-45 vjeç është një moshë që deri diku është e stabilizuar në tregun e punës, nuk do që të bëjë vullnetarizëm me patjetër për të pasur një certifikatë apo për të gjetur një vend pune. Kjo e dhënë mund të mbështetese dhe literaturën e shumë studimeve dhe përqasjeve ndërkombëtare, të cilat fillesat e vullnetarizmit i kanë për qëllim të kohezionit social.



Grafiku 23. Eksperiencat vullnetare sipas nivelit të edukimit të pjesëmarrësve në studim

Grafiku i mësipërm tregon se personat me nivel arsimor më të lartë, p.sh., pasuniversitar (79%) dhe të lartë (70%) janë më të predispozuar për punë vullnetare, përkundrejt atyre me arsim më të ulët, p.sh., arsim fillor (50%) apo 8/9 vjeçar (47%).

Sa të kënaqur jeni me përvojat vullnetare?

Të pyetur se sa të kënaqur janë vullnetarët nga përvojat vullnetarë që kanë pasur apo që kanë aktualisht, pjesa më e madhe e të pyeturve 89% pohojnë se janë të kënaqur nga kjo eksperiencë, rreth 7% pohojnë se janë të pakënaqur dhe një pjesë shumë e vogël 2% raportojnë se janë të zhgënjyer. Grafiku i mëposhtëm sugjeron se grupmoshat që kanë shprehur më shumë nivele të larta kënaqësie në lidhje me përvojat vullnetare janë individët e moshës 18-29 vjeç dhe 30-45 vjeç.



Grafiku 24. Përvojat vullnetare sipas grupmoshës së pjesëmarrësve në studim



Grafiku 25. Përvojat vullnetare sipas gjinisë së pjesëmarrësve në studim

Të dyja gjinitë shprehin pothuajse nivele të njëjta të përjetimit të kënaqësisë se përvojave vullnetare.



Grafiku 26. Përvojat vullnetare sipas nivelit të edukimit të pjesëmarrësve në studim

Të dhënat e grafikut tregojnë se me rritjen e nivelit të edukimit rritet edhe predispozita për të përjetuar më pozitivisht një përvojë vullnetare. Personat me arsim pasuniversitar shprehen se janë shumë të kënaqur (47%), ose të kënaqur (48%) në lidhje me përvojën vullnetare. Ndërkohë më të pakënaqurit duket se janë ata me arsim të mesëm (10%) dhe më të zhgënjyerit janë ata me arsim fillor (17%).

Matja e nivelit se sa të kënaqur janë vullnetarët nga përvojat e tyre është një tregues direkt i cilësisë së aktiviteteve dhe hapësirave që ofrohen për vullnetarizëm, duke marrë gjithashtu në konsideratë se pjesa më e madhe e përvojave të vullnetarizmit

ka qenë në organizata të shoqërisë civile. Nga ana tjetër, kuptojmë se pavarësisht sfidave që organizatat përballen në terrenin shqiptar, mungesës së një organizimi dhe praktikave direkte të vullnetarizmit, ato përpiqen që këto përvoja të jenë pozitive për çdo vullnetar.

5.2.2 Tendenca për kontribut vullnetar në 12 muajt e ardhshëm

Pjesa dërrmuese e të pyeturve shprehen pozitivisht për të realizuar punë vullnetare në 12 muajt e ardhshëm (68%); pak më shumë se një e katërta (27%) nuk janë të sigurt dhe shumë pak (4.6%) pohojnë të kundërtën.



Grafiku 28. Kontributi vullnetar në 12 muajt e ardhshëm sipas grupmoshës së pjesëmarrësve në studim

Grupmosha më e predispozuar për të realizuar një kontribut vullnetar në 12 muajt e ardhshëm është grupmosha 18-29 vjeç (3/4) ose 77%; duke vijuar me grupmoshën 30-45 vjeç (69%) dhe 15-17 vjeç (65%). Në këtë rast kemi tendencën se të rinjtë kanë interes më të lartë për interesa vullnetare, ndaj ofruesit e vullnetarizmit dhe institucionet politikëbërëse duhet të dizenjojnë dhe hartojnë politika dhe aktivitete që shkojnë në përputhje me këtë moshë, duke mbajtur gjithmonë në konsideratë vlerësimin e nevojave të komunitetit dhe shoqërisë në tërësi. Nga ana tjetër, reflektohen të dhëna se kemi një numër të konsiderueshëm të atyre që nuk janë të sigurt për të qenë apo jo vullnetar në muajt ne vijim. Rritja e nivelit të informacioni rreth mundësive dhe përfitimeve të vullnetarizmit, ndarja e praktikave pozitive nga individët dhe institucionet mund të jenë nxitës shumë efektivë në rastet kur individët nuk janë të sigurt.



Grafiku 29. Kontributi vullnetar në 12 muajt e ardhshëm sipas profesionit të pjesëmarrësve në studim

Personat të cilët janë më të predispozuar të kryejnë një eksperiencë vullnetare në 12 muajt e ardhshëm i përkasin sektorit të OSHC-ve (1/4), të vetëpunësuarit (74%); sektori privat (73%) dhe studentët me 72%. Siç edhe mund të hamendësohet, personat e papunë janë më të pavendosur, në lidhje me këtë pyetje dhe (40%) dhe pensionistët (27%) japin një përgjigje negative.

Target grupet dhe fushat për të cilat ju do të dëshironit të jepnit kontributin tuaj vullnetar

Disa nga target grupet më të përzgjedhura për të cilat do të dëshironin të jepnit kontributin vullnetar, nga pjesëmarrësit në studim ishin banorët e komunitetin/ lagjes, fëmijët dhe të rinjtë, minoritetet, persona në vështirësi ekonomike dhe të moshuarit. Kjo e dhënë vihet re dhe në fokus grupet, ku mësuesit kanë vënë re tendencën nxënësve apo të rinjve për të qenë vullnetarë në çështje të bamirësisë, katastrofave, familjeve në nevojë dhe personave me nevoja speciale.

Nga ana tjetër, lidhur me fushat më të përzgjedhura ku pjesëmarrësit në studim kanë preferencë për vullnetarizëm janë: fuqizimi i të rinjve, të drejtat e njeriut, promovimi i vullnetarizmit, bashkëpunimi rajonal, aktivitetet sportive, edukimi, gjithëpërfshirja dhe mbështetja e grupeve në nevojë, bamirësia dhe raste emergjencash.

Siç mund të vihet re nga tabela e mëposhtme, rreth gjysma e të anketuarve dëshirojnë ta japin kontributin e tyre vullnetar në lagjen /komunitetin e tyre, rreth ¼ në shkollë, 11.8 % në qendra rinore apo sociale, 6% në shtëpitë e të moshuarve; 4.5% në universitetet. Ndërkohë, pjesa e atyre që dëshirojnë ta japin kontributin vullnetar në spitale apo qendra shëndetësore; institucione shtetërore lokale apo qendrore është pothuajse e papërfillshme, pasi nuk shkon dot deri në 1%.

Interesant është fakti që organizatat e shoqërisë civile janë në një përqindje jo shumë të lartë për sa i përket tendencave se ku individët duan të jenë vullnetarë (1.7%). Kjo mund të shihet në dy këndvështrime. Së pari, në përgjithësi organizatat e shoqërisë civile japin kontributin e tyre në të gjitha target grupet e përmendura, apo kanë integruar aktivitete me institucionet përkatëse që punojnë me target grupet specifike, si p.sh., fëmijët, të rinjtë, të moshuarit etj. Së dyti, parë në këndvështrimin se pjesa më e madhe e individëve kanë qenë vullnetarë pranë organizatave të shoqërisë civile, mund të reflektojë potencialin dhe hapësirat që ky sektor ofron dhe shpeshherë individët nuk kanë pasur shumë informacion apo alternativa për të qenë vullnetarë aty ku ata vërtet kanë dëshirë. Kjo qasje sjell në vëmendje nevojën dhe rolin që duhet të marrë secili nga këto institucione që të krijojnë mundësi dhe infrastrukturë për praktikimin e vullnetarizmit, në këtë rast institucionet vendore të cilat mund të menaxhojnë nxitjen e aktiviteteve komunitare/në lagje, shkollat, qendrat rinore, si dhe universitetet.

Preferencat për kontribut vullnetar



Grafiku 30: Ku do të donit të jepni kontributin tuaj vullnetar?

Preferencat që prevalojnë janë të ndara sipas variablit të moshës dhe gjinisë, duke sjellë një panoramë më të qartë dhe të detajuar rreth interesave dhe trendeve. Këto të dhëna sjellin në vetvete analizën që çdo aktor, institucion apo individ kupton se si mund të integrojë nevojat e përfitimit nga vullnetarizmi me tendencat dhe preferencat e vullnetarëve. Dhe pse nga të dhënat më lart u vu re qartë se ata që kanë eksperienca vullnetare i kanë ato në organizata të shoqërisë civile. Pra, aktualisht OSHC-të janë potenciale si ofrues vullnetarizmi, por ndërkohë interesi për zhvillim komunitar është shumë i lartë, ndaj është e rëndësishme të konsiderohet dhe monitorohet se si tendencat e vullnetarëve duhet të ndihmojnë dhe orientojnë institucionet kompetente për të marrë masa dhe krijuar hapësira, praktika dhe mundësi të drejtpërdrejta për zhvillimin e vullnetarizmit në komunitet. E njëjta analizë

pasqyrohet dhe për vullnetarizmin në shkolla, një mjedis i cili do të përfitonte shumë nga vullnetarizmi. Nga fokus grupet e realizuara është evidentuar si nga mësuesit, por dhe përfaqësues të OSHC-ve se shkollat kanë qenë dhe janë shumë të hapura dhe të interesuara për të mirëpritur vullnetarë si nga banorët e komunitetit, ashtu dhe ata që vijnë të organizuar nëpërmjet OSHC-ve. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka konfirmuar në intervistë se është e predispozuar dhe e hapur të mbështesë nismat vullnetare në shkolla, duke e vlerësuar si një vlerë të qëndrueshme në dobi të sistemit arsimor dhe veçanërisht nxënësve.

KONTRIBUTI VULLNETAR NË LAGJE/KOMUNITET SIPAS GJINISË



Grafiku 30. Kontributi vullnetar në lagje/komunitet sipas gjinisë së pjesëmarrësve në studim

Meshkujt janë më të predispozuar ta japin kontributin e tyre në lagje apo komunitet (61%), përkundrejt femrave me 58%.

Preferencat rreth periudhës kohore për angazhim vullnetar

Pjesa dërrmuese e të pyeturve dëshirojnë të jenë vullnetar për një periudhe relativisht të shkurtër kohore. Rreth 31% dëshirojnë të angazhohen vullnetarisht për një periudhë deri në 1 muaj ose nga 1-3 muaj. Duket se tendenca e vullnetarizmit afatshkurtër prevalon, e lidhur kjo me pasiguritë që individë ka për planet afatgjata, por dhe kultura e shoqërisë tonë për të bërë plane dhe marrë përgjegjësi afatgjata.

PERIUDHA KOHORE GJATË SË CILËS JU DO TË PREFERONIT TË ANGAZHOHESHIT VULLNETARISHT ?



KONTRIBUTI VULLNETAR NË LAGJE/KOMUNITET SIPAS GJINISË



Grafiku 31. Periudha kohore e kontributit vullnetar sipas gjinisë së pjesëmarrësve në studim

Të dhënat e ndara sipas gjinisë në lidhje me preferencën kohore për kontributin vullnetar tregojnë se meshkujt preferojnë periudha më të shkurtra kohore për të qenë vullnetarë, 40% preferojnë deri ne 1 muaj, në krahasim me femrat, ku rreth 26% preferojnë më shumë se 6 muaj.

Gjithashtu, të dhënat e mëposhtme tregojnë se personat me nivel më të ulët arsimor preferojnë të japin kontribut vullnetar për periudha kohore relativisht më të vogla në krahasim me personat me nivel arsimor më të lartë. Për shembull, rreth 75 % e personave me arsim fillor dhe 70% e atyre me arsim 8-9 vjeçar preferojnë të japin kontribut vullnetar për një periudhë më pak se 1 muaj, ndërsa ata me arsim të lartë rreth tre të katërtat preferojnë të japin kontribut vullnetar për periudha relativisht më të gjata kohore p.sh., mbi 6 muaj.

PERIUDHA E KONTRIBUTIT VULLNETAR SIPAS EDUKIMIT



Grafiku 32. Periudha kohore e kontributit vullnetar sipas nivelit të edukimit të pjesëmarrësve në studim

PERIUDHA E KONTRIBUTIT VULLNETAR SIPAS PUNËSIMIT



Grafiku 33: Periudha kohore e kontributit vullnetar sipas punësimit të pjesëmarrësve në studim

Në përgjithësi nuk ka ndonjë diferencë të madhe për preferencën kohore për të dhënë kontribut vullnetar sipas punësimit, përveçse pensionistëve, që preferojnë të japin kontribut vullnetar për periudha më të shkurtra kohore (rreth 70% preferojnë të japin kontribut vullnetar deri në 1 muaj). Ndërkohë, pjesa dërmuese e të pyeturve shprehen se preferojnë të japin kontribut vullnetar për një periudhë 1-3 muaj ose mbi 6 muaj.

5.2.3 Vullnetarizmi digjital - trend dhe/apo domosdoshmëri?

Periudha e pandemisë krijoi hapësira për promovimin e vullnetarizmit digjital. Zhvillimi i punës online është bërë tashmë një realitet për shumë organizata joqeveritare, institucione publike dhe private, individë etj. Megjithatë, jo të gjitha grupet mund ta aksesojnë vullnetarizmin online, pasi jo të gjithë kanë mundësit financiare për përballimin e kostove.

Megjithatë, kjo formë vullnetarizimi duket se është sa nevojë, aq dhe një trend në këto kohë. Vullnetarizmi digjital është praktikuar dhe ka pasur shumë hapësira dhe më parë pandemisë, veçanërisht në vendet e zhvilluara, por jo vetëm. Pandemia bëri më shumë evidente ato praktika që ekzistonin, si dhe në mënyrë shumë të shpejtë dhe shumëdimensionale po gjejnë shtrirje gjithnjë e më shumë.

Të dhënat e studimit tregojnë se pjesa më e madhe e të anketuarve 72.7% e konsiderojnë domosdoshmëri vullnetarizmi digjital, përkundrejt atyre që shprehen se nuk e dinë 22%.

Tabela 9. Vullnetarizmi digjital është i nevojshëm/domosdoshëm në kohët që po jetojmë

NDRYSHORI	NUMRI	PËRQINDJA
Kontributi vullnetar:		
Po	803	72.7
Jo	58	5.3
Nuk e di	243	22.0

Për sa i përket vullnetarizmit digjital, rreth më pak se gjysma e të pyeturve (46%) pohojnë se e konsiderojnë si një alternativë të re për të ardhmen. Rreth ¼ ose 27% nuk e konsiderojnë si një alternativë, 18% nuk e dinë dhe 7.5% nuk e njohin se çfarë është vullnetarizmi digjital. Tendenca më e madhe për ta konsideruar vullnetarizmin digjital si një opsion është te gjinia femërore (48%) përkundrejt 41% të meshkujve.

VULLNETARIZMI DIGJITAL SIPAS GJINISË



Grafiku 34. Vullnetarizmi digjital sipas gjinisë së pjesëmarrësve në studim

VULLNETARIZMI DIGJITAL SIPAS EDUKIMIT



Grafiku 35. Vullnetarizmi digjital sipas nivelit të edukimit të pjesëmarrësve në studim

Personat me arsim më të lartë janë më pro idesë së vullnetarizmit digjital, krahasuar me personat me nivel më të ulët arsimor.

5.3. Sfidat e vullnetarizmit në Shqipëri

Vullnetarizmi në Shqipëri përballet me një sërë sfidash institucionale, ligjore, praktike, strukturore, individuale etj. Vlen të theksohet se ekziston një mungesë e mekanizmave institucionalë funksionalë për ta mbështetur vullnetarizmin në Shqipëri. Mungesa e qartë e strukturave në nivel vendor apo qendror për angazhimin e vullnetarëve përbën një pengesë për vetë vullnetarët që dëshirojnë të kryejnë punë vullnetare apo edhe për ato institucione dhe OSHC që duan të angazhojnë vullnetarët në situata të caktuara.

Ky studim, por dhe studime të tjera të fokusuara rreth vullnetarizmit dhe të rinjve, sjellin evidenca se niveli i angazhimit vullnetar në tërësi është i ulët. Këto të dhëna kanë një sërë arsyesh pse ndodh dhe cilat janë **sfidat që përballen si vullnetarët, ashtu dhe ofruesit e vullnetarizmit.**



Grafiku 36. Mungesa e eksperiencave vullnetare midis pjesëmarrësve në studim

Për personat që nuk kanë pasur eksperienca vullnetare, disa nga arsyet më të shpeshta për mungesën e kësaj përvoje janë: mungesa e rregulloreve mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e vullnetarëve (67%); mosnjohja dhe mosvlerësimi i kontributit vullnetar në Shqipëri (47%); mungesa njohurive (45%); mosorientimi apo kërkesa (42%); pakënaqësia me organizimin (41%) dhe mungesa e kohës (36%).

Ndërsa të dhënat nga fokus grupet me ofruesit e vullnetarizmit rendisin gjithashtu si arsyen kryesore mungesën e informacionit, mungesa e mekanizmave specifikë që vullnetarët të orientohen dhe motivohen. Gjithashtu, mungesa e vullnetarizmit të strukturuar, mungesa e mekanizmave konkrete të aktorëve kyçë si ofrues vullnetarizmi, ashtu dhe politikëbërës, mungesa e koordinimit ndërsektorial qëndrojnë si arsye shumë të forta që pengojnë individët të jenë vullnetar.

Pjesëmarrësit në fokus grupe shprehen se disa ndër sfidat kryesore që ato përballen janë: skepticizmi ndaj konceptit të vullnetarizmit, mungesa e kapaciteteve

të organizatave për t'i mbajtur vullnetarët dhe për të krijuar sisteme të qëndrueshme të vullnetarizmit, në aspektin e promovimit dhe rritjes profesionale të individëve.

Përveç pengesave në procesin e rekrutimit, pjesëmarrësit në fokus grupe shprehen se një vështirësi afatgjate që ata ndeshin në punën e tyre ka të bëjë me **qëndrueshmërinë e vullnetarëve**, pasi shpeshherë nuk gjejnë dot mënyrat apo iniciativat e duhura për t'i mbajtur vullnetarët të angazhuar në periudhë më afatgjatë. Arsyeja për këtë sfidë mbetet sërish mungesa e burimeve financiare nga OSHC-të, të cilat në pjesën më të madhe të rasteve punojnë në bazë projektesh.

Edhe ne hasim sfida të tilla si: të rinjtë vijnë marrin ekspertizë dhe katapultohen në organizata të tjera ose organizata ndërkombëtare dhe është përherë ai viti 0'. Çdo ditë ne fillojmë me të rinjtë nga zero, pasi ata që kanë një lloj eksperience ose nuk kanë dëshirë më të vazhdojnë të angazhohen me shoqërinë civile për shkak të problemeve financiare ose duan të ikin jashtë shtetit, se situata nuk është e mirë ose thjeshtë humbasin interesin. Të paktën nga të rinjtë që kemi angazhuar nga fundviti i 2014 deri më sot, një pjesë relativisht e vogël vazhdon të jetë e angazhuar ose punësuar me bazë projektesh ose vazhdojnë të dedikojnë në një formë vullnetare kohën e tyre të lirë në aktivitete të ndryshme. (Fokus rup nr.3, përfaqësues nga OSHC-të, datë 16.03.2021).

Mungesa e informacionit dhe ndërgjegjësimi i ulët mbi mundësitë e vullnetarizmit apo institucionet që mundësojnë praktikat vullnetarë janë faktorë të tjerë që pengojnë angazhimin e qytetarëve në aktivitete vullnetare. Studimi tregon se janë 49 % e të anketuarve, të cilët nuk kanë informacione rreth mundësive të vullnetarizmit, ndërkohë organizatat e shoqërisë civile argumentojnë se mungesa e informacionit është më e madhe në rast së do t'i referohemi moshave të ndryshme, grupeve të margjinalizuara, personave që vijnë nga background-e me mundësi më të pakta ku aksesi ndaj informacioni është më i thelluar.

*Ndonjëherë sfidat lidhen edhe me vet vullnetarët. Për shembull, gjatë viteve të mia të punës kam hapur vazhdimisht thirrje për vullnetarë dhe intershipe, por ajo që ndodh është mungesa e informacionit. Të rinjtë nuk është se kanë informacione të detajuar apo të mjaftueshëm se çfarë është vullnetarizmi, benefitet, si të bëjnë vullnetarizëm. Pra, sfidë në vetvete është që të rinjtë të njihen me konceptin e vullnetarizmit, të dinë se çfarë përfitojnë apo se çfarë mban ajo përbrenda (*Fokus grup nr.4, përfaqësues nga OSHC-të, datë 16.03.2021).

Kjo është një sfidë thelbësore, e cila ka nevojë të adresohet nga aktorët kyçë, veçanërisht media, e cila duhet të informohet, ta kuptojë dhe më pas të adresojë më shumë çështje të vullnetarizmit.

Kapacitetet e ulëta për rekrutim, orientim, motivim dhe menaxhim të vullnetarëve: Shumë sfida që sektori i vullnetarizmit has janë të gërshetuara dhe influencojnë njëra -tjetrën. Qëndrueshmëria e organizatave, përqasja e donatorëve dhe politikat kanë ndikuar në mënyrë shumë direket në mosrritjen e kapacitete të ofruesve të vullnetarizmi (veçanërisht OSHC-ve). Rreth 92 % e ofruesve të vullnetarizmit

përfshirë në këtë studim identifikojnë mungesën e kapaciteteve njerëzore, profesionale dhe financiare si një sfidë shumë të konsiderueshme. Ato raportojnë se kanë shumë nevojë për ngritje kapacitetesh, për standardizim dhe përcaktim të procedurave apo rregullave të sigurimit gjatë vullnetarizmit në raste emergjencash civile. Nga ana tjetër, mobilizimi qytetar dhe vullnetar gjatë situatave emergjente është një ndër instrumentet më efektive në dobi të komunitetit dhe në ndihmë të grupeve në nevojë. Së fundmi, përballja me tërmetin e 25 nëntorit 2019 dhe po ashtu situata emergjente e krijuar prej masave të ndërmarra për parandalimin e virusit Covid-19, tregoi që kontributi i vullnetarëve ishte tejet i rëndësishëm në kapërcimin e këtyre sfidave. Kjo është një përvojë pozitive e angazhimit qytetar vullnetar në situata emergjente, por nga ana tjetër, OSHC-të konstatuan një sërë problemesh gjatë mobilizimit, ndër të cilat kryesore ishte identifikimi i kauzave që kishin nevojë për mbështetje dhe koordinimi me aktorë të tjerë për ofrimin e ndihmës/shërbimit të nevojshëm. Organizatat u përballën me vështirësi të sigurimit të jetës për vullnetarët, sigurimi teknik, pasi ka mungesë kapacitetesh nga të gjitha nivelet për orientimin, përgatitjen dhe menaxhimin e vullnetarëve gjatë emergjencave. Institucionet në nivel vendor nuk kishin mekanizma të qartë koordinuese për t'u përgjigjur kërkesave të vullnetare në ndihmë të komuniteteve (Bino et al., 2020).

Gjithashtu, sjellin si sfidë mënyrën se si t'i mbajnë vullnetarët të motivuar, pra, nevoja për një menaxhim të mirë hap pas hapi. Vullnetarizmi nuk ka qenë fokus i shumë institucioneve publike apo dhe donatorëve, gjë e cila rreth 87 % të organizatave e ka influencuar që vullnetarizmin të mos e kenë fokus programatik. Kapacitetet e pamjaftueshme financiare kanë bërë që shumë organizata të ndjekin kriteret e donatorëve në linjë specifike, duke lënë pa shumë fokus vullnetarizmin. Ndërkohë, mekanizmat mbështetës financiarë të shtetit që mund të ishin një nxitje shumë e mirë për sektorin e shoqërisë civile në nxitjen dhe ushtrimin e vullnetarizmit nuk kanë funksionuar. Sipas A.Agollit (kjo sfidë mund të tejkalohet duke buxhetuar vullnetarizmin në buxhetin e shtetit, p.sh., buxheti nga AMSHC apo buxheti i bashkive për OSHC-të (Intervistë, Arjola Agolli, Partner Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile)

Faktorët personalë si impenjimet me shkollën, punësimi apo angazhimi me aktivitete të tjera konsiderohen si barriera për angazhimin e të rinjve në aktivitete vullnetare. Kjo lidhet me kulturën e menaxhimit të kohës dhe prioriteteve që ne vendosim si individë. Nga ana tjetër, nevoja shumë e madhe për të pasur një punë të paguar, shpeshherë me orare të zgjatura, janë një faktor nxitës që pengojnë individët për t'u angazhuar vullnetarisht.

Një faktor tjetër pengues për qëndrueshmërinë e vullnetareve bëhet edhe **impenjimi, angazhimi i tyre në studimeve përgjatë** kohës që janë studentë. Gjithashtu, stili pasiv i jetesës dhe shpenzimi i kohës së lirë në media sociale konsiderohen faktorë pengues:

Gjatë gjimnazit të rinjtë angazhohen në aktivitete të ndryshme, por pasi largohen në universitet, angazhimi i tyre është shumë i vogël ose pothuajse fare. (Fokus grup nr.3, përfaqësues nga OSHC-të, datë 16.03.2021).

Në kohët e sotme të gjithë janë të prirur ndaj celularit, e kanë më mirë të rrinë në internet sesa të marrin pjesë në diçka tjetër që të mbush shpirtërisht. (*Fokus grup nr.6, p*ërfaqësues nga *institucionet arsimore nga bashkitë Kamëz, Elbasan, Rrogozhinë, Përrenjas datë- 22.02.2021).*

Ndenja e apatisë te qytetarët dhe mungesa e qytetarisë aktive përmendet si një ndër faktorët kyçë për angazhimin e ulët vullnetar.

Vullnetarët nuk kanë ndjenjën e përkatësisë, qoftë për komunitetin, qoftë për të dhënë një kontribut dhe shohim një lloj pasiviteti nga të rinjtë shqiptarë. (Fokus grup nr.4, përfaqësues nga OSHC-të, datë 16.03.2021).

Mungesa e vullnetarëve me një profil të specializuar. Përfaqësuesit nga fokus grupet shprehen se një ndër sfidat që ato hasin është rekrutimi i vullnetarëve me njohuri të specializuara në një fushë të caktuar. Vullnetar nuk mund të jetë kushdo, ndaj e kapacitete të ofruesve të vullnetarizmit në orientimin dhe menaxhimin e vullkanorëve del përsëri një sfidë e lidhur më ofrimin e cilësisë së këtij kontributi.

Te qendra jonë target grupet janë të ndryshme, por ajo që unë mendoj, që kërkon vullnetarë përveç moshës së tretë, janë fëmijët me aftësi të kufizuar. Ka vullnetarë që nuk e njohin aspak, por ka të tjerë që kanë njëlloj specializimi për profilin*, p.sh., ata që vijnë nga shkencat sociale.* (Fokus grup nr.11, përfaqësues nga qendrat komunitare të bashkisë Tiranë ("Q. Multidisiplinare", "Q. Komunitare Sëbashku", "Gonxhe Bojaxhi", "Strehëza") datë- 6. 04.03.2021).

Barrierat strukturore

Nga ana tjetër janë shpeshherë **barrierat infrastrukturore** si faktorë pengues për zhvillimin e praktikave vullnetare. Edhe pse një i ri mund të ketë dëshirë dhe kohë për t'u angazhuar si vullnetar, mungesa e transportit publik dhe mundësitë e ulëta për ta siguruar nga ana e organizatave mbeten ende sfiduese.

Edhe ne si organizatë që jemi të vendosur tek zona e Bregut të Lumit, jo shumë larg metropolit, kryesisht problematika më e madhe e vullnetarëve është ardhja te qendra jonë. (Fokus grup nr.3, përfaqësues nga OSHC-të, datë 16.03.2021).

Përfaqësues nga qendrat komunitare shprehen se shpeshherë ambientet tepër të vogla të qendrave komunitare për të akomoduar një pjesë të madhe të studentëve janë ndër barrierat kryesore që ato hasin, edhe sidomos në periudhën e pandemisë, ku duhet të respektohen edhe masat e distancimit social.

Një ndër sfidat kryesore që hasin organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri është organizimi i praktikave dhe nismave vullnetare, për shkak të **mungesës së një entiteti qendror** që organizon dhe orienton në programet e vullnetarizmit.

Infrastruktura jo e duhur ligjore, strukturore dhe burokracia e institucioneve bëhet shpeshherë pengesë për organizatat joqeveritare, të cilat konstatojnë

se ekziston në përgjithësi një klimë jofavorizuese dhe burokratike në lidhje me procedurat që duhet të ndiqen apo edhe me mungesë informacioni.

Gjithashtu, për shkak të dinamikave ndër vite, legjislacionit të cunguar si një pengesë e 5 viteve të fundit, shumë organizata rrinë në heshtje, nuk ekspozohen apo nuk u japin shumë fokus aktiviteteve vullnetare, duke u munduar të shmangin penalitete që sjell detyrimi ligjor për regjistrimin e vullnetarëve.

Një sfidë për ne është fakti që aktet nënligjore njihen nga organizatat, por nuk praktikohen nga zyrat përkatëse dhe veçanërisht Zyra e Punësimit. Në emër të organizatës ne kemi kërkuar për formular të veçantë për të rinjtë që bëjnë vullnetarizëm pranë organizatës dhe na thanë që nuk i disponojmë. Gjithashtu, na është thënë që ka dalë një urdhëresë e brendshme nga Ministria e Financave, por nuk është bërë ende aktive. (Fokus grup nr.4, përfaqësues nga OSHC-të, datë 16.03.2021).

Institucionet përgjegjëse për monitorimin e punës vullnetare, siç është Shërbimi Kombëtar i Punësimit nuk i ka kapacitetet e duhura njerëzore dhe teknike për të monitoruar vullnetarizmin në terren. Nga ana tjetër, ***koordinim ad hoc dhe jo i qëndrueshëm*** i praktikave vullnetare është element tjetër pengues.

Qëndrueshmëria financiare e OSHC-ve është një pengesë tjetër kryesore për qëndrueshmërinë dhe nxitjen e praktikave vullnetare. Ndonëse OSHC-të mund të kenë vullnetin për të ndërmarrë iniciativa pozitive në kuadër të nxitjes së praktikave vullnetare, mungesa e burimeve financiare i dekurajon OSHC-të të lobojnë për promovimin dhe implementimin e këtyre iniciativave. Financimi i organizatave është me bazë projekti dhe mungesa e burimeve të qëndrueshme bëhet pengesë edhe për realizimin e objektivave strategjikë në kuadër të promovimit të iniciativave vullnetare. Institucionet e qeverisjes vendore perceptohen shpeshherë si burime të qëndrueshme dhe efikase për thithjen e fondeve nga donatorët në përpjekje të iniciativave vullnetare. Për shkak të kësaj barriere, përfaqësuesit nga OSHC-të shprehen se kanë tepër të vështirë të sigurojnë qëndrueshmërinë e vullnetarëve, duke qene se nuk janë në gjendje të paguajnë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Praktika vullnetare mund të konsiderohet si një eksperiencë e vlefshme dhe pozitive që inkurajon integrimin e të rinjve në tregun e punës dhe në karrierë. Vullnetarët përfitojnë shprehi personale dhe profesionale, që mund të jenë tepër të rëndësishme për t'u orientuar në tregun e punës. Megjithatë, ekziston në përgjithësi një dyzim nëse puna vullnetare mund të konsiderohet si një instrument ndërmjetësues për praktikat e punës.

*Ne vëmë re me keqardhje që shumë të rinj që mbarojnë shkollën kanë probleme të mëdha për t'u punësuar, sepse nuk kanë praktikë, kjo është një gjë e mirë sepse mund të përdorin praktikën diku, qoftë të plotësojnë CV, por duke qenë se kjo nuk është ende e qartë për ne, nuk dimë t'i themi vullnetarit si ta përdorë dhe jemi pak të dyzuar. (*Fokus grup nr.2, përfaqësues nga OSHC-të, datë 11.03.2021).**Kuadri (jo)mundësues për zhvillimin dhe promovimin e vullnetarizmit**

Një sfidë shumë madhe në nxitjen dhe praktikimin e vullnetarizmit duket se ka sjellë Ligji i Vullnetarizmit, aprovuar në vitin 2016. Megjithëse është bërë një progres në këtë fushë, një numër i madh sfidash dhe vështirësish vazhdojnë të pengojnë zhvillimin e plotë të vullnetarizmit. Sipas raportit të progresit të BE-së për Shqipërinë 2019, nuk ka progres në konsultimin publik në miratimin e akteve nënligjore dhe zbatimin e ligjeve për vullnetarizmin (EC, 2019). Pengesat lidhen me mungesën e kuptueshmërisë, mekanizmave për zbatimin në praktikë, regjistrimin e vullnetarëve, sigurimin shëndetësor etj. Për sa i përket deklarimit të vullnetarëve, 13% e organizatave të pyetura deklarojnë se i kanë regjistruar vullnetarët në Zyrat Kombëtare të Punësimit dhe Autoritet e Taksave. Megjithatë, asnjë nga OSHC-të e pyetura nuk kanë regjistruar vullnetarë në SHKP sipas përcaktimeve të ligjit mbi vullnetarizmin, për shkak se një regjistër i tillë nuk është ende funksional.

Organizatat shfaqin një sërë pasigurish në lidhje me paqartësitë në përfshirjen e vullnetarëve në projekte apo aktivitetet e tyre. Disa nga çështjet kryesore të ngritura prej tyre kanë të bëjnë me paqartësitë e ligjit, vështirësi në implementimin praktik të ligjit, sigurimi i vullnetarëve që lidhet kryesisht me paqartësitë në lidhje me kostot që ata duhet të paguajnë apo përllogaritjet e këtyre kostove, procedurat e kontraktimit të vullnetarëve, regjistrimin e vullnetarëve, konfuzioni i kompetencave të institucioneve ligjzbatuese në lidhje me vullnetarët dhe vullnetarizmin.

Implementimi i ligjit nuk gjeti terrenin e duhur dhe kjo edhe për shkak se shoqëria civile duhet të ushtronte presion më të lartë ndaj politikëbërësve për implementimin e të gjitha masave të cituara në ligj. Ndonëse ligji mund të duket i qartë në pamje të parë, zbatimi i tij ngelet problematik, pasi nuk orienton aspak zbatuesit e vullnetarizmit (Intervistë nr.4 me përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Rinisë, datë 27.03.2021). Ligji i Vullnetarizmit duket i sforcuar, pasi në vend që të nxisë vullnetarizmin, duket sikur e dekurajon.

Një tjetër problematikë që konstatohet nga pjesa dërrmuese e pjesëmarrësve në fokus grupe është **dokumentimi i kontributit vullnetar**, një eksperiencë që vlerësohet dhe njihet nga të gjitha institucionet**.** Në mungesë të vulave për të verifikuar vlefshmërinë e certifikatave, OSHC-të kanë lëshuar letra reference për të vërtetuar angazhimin vullnetar. Letrat e referencave konsiderohen si alternativat e vetme për të ofruar garancitë e nevojshme për vullnetarizmin.

Pika 36 e Ligjit, ku flitet për vlerësimin e punës së vullnetarit, është paksa shqetësuese jo vetëm me certifikatat, por edhe me njohjen e orëve vullnetare të punës. Duhet patjetër të zbatohen të gjitha rregullat, sikundër bëhet me bashkëmoshatarët e tyre në Bashkimin Europian. Kjo është një pikë që duhet riparë. Jam dakord që puna vullnetare nuk ka çmim që ta vlerësojë*, por realisht vullnetari duhet të vlerësohet me njohjen e orëve të punës.* (Fokus grup nr.2, përfaqësues nga OSHC-të, datë 11.03.2021).

Nga ana tjetër ka pasur shumë diskutime nëse certifikimi, njohja e punës vullnetare apo libreza e vullnetarit janë aq të rëndësishme? Nga disa perspektiva të tjera vullnetarizmi nuk duhet të nxitet nga këto stimuj, duhet të vijë me vullnetin e lirë. Kjo është nxitja për të rinjtë që janë akoma duke kërkuar dhe gjetur veten në

tregun e punës, por kjo është aspak e rëndësishme për ata që janë në marrëdhënie pune dhe vullnetarizmin e bëjnë vetëm për vetëplotësim apo për zhvillim shoqëror.

Një pjesë e përfaqësueseve nga OSHC-të shprehen se **pagesa e siguracioneve** të vullnetarëve është një kosto tepër e lartë për t'u përballuar nga ata vetë dhe, për rrjedhojë, nuk i kanë ndjekur procedurat e regjistrimit të vullnetarëve (Fokus grup nr.3, përfaqësues nga OSHC-të, datë 16.03.2021).

Raporti i vitit të 2019 "Matrica e Monitorimit mbi mjedisin mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile". Raporti për Shqipërinë Maj 2018-Maj 2019 konstaton se një pjesë e organizatave që kanë pasur në strukturë vullnetarë dhe programe vullnetarizmi kanë deklaruar se kanë mbyllur programet e vullnetarizmit për shkak të paqartësive dhe frikës së sanksioneve nga institucionet publike.

Pjesëmarrësit në fokus grupe shprehin shqetësimin se, ndonëse puna vullnetare njihet dhe vlerësohet brenda sektorit të OSHC, institucionet shtetërore nuk e njohin këtë praktikë. Duke qenë se praktika vullnetare nuk dokumentohet formalisht në Zyrat e Punësimit, ajo nuk njihet si **praktikë pune në Librezën e Punës** dhe, për rrjedhojë, nuk njihen dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Një instrument për njohjen e kontributit vullnetar mund të ishte "Pasaporta e vullnetarit", e cila do të shërbente si një mjet efikas për vërtetimin e eksperiencave vullnetare si nga ana e institucionet shtetërore, edhe atyre publike *(*Fokus grup nr.2, përfaqësues nga OSHC-të, datë 11.03.2021).

Sigurimi shëndetësor është një çështje shumë e debatueshme dhe një pengesë madhore për sektorin e shoqërisë civile, por dhe për institucionet e tjera. gjithashtu në rast se do të jenë aktivë në rekrutimin e vullnetarëve. Shumë pyetje dhe diskutime të lidhura se kush duhet të paguajë siguracionet, a mund ta përballojnë OSHC-të, duhet vetë vullnetarët të paguajnë siguracionet, mund të ndahen këto kosto ndërmjet shtetit dhe ofruesve të vullnetarizmit? Secili sektor sjell këndvështrime të ndryshme, veçanërisht duke kërkuar institucionet qendrore që nëpërmjet mekanizmit të ligjit të qartësojnë situatën dhe të mundësojnë një mjedis të përshtatshëm dhe mundësues, duke shpresuar se konsultimet e përbashkëta ndërsektoriale, përmirësimet ligjore dhe institucionale do të adresojnë dhe tejkalojnë shumë sfida që momentalisht që ta konsiderueshme.

Ndoshta modeli i deritanishëm ideal i vullnetarëve është modeli që ka ndjekur World Vision Albania: *WVA ka një kontratë me vullnetarin, kontratë e cila përtej gjithë specifikimeve, të drejtave dhe detyrimeve, përfshin dhe pagesën e sigurimeve nga aksidenti për vullnetarët. Ligji me shumë të drejtë kërkon ta mbrojë vullnetarin në aspekte të dëmtimit të shëndetit të tij, por organizatat e shoqërisë civile me gjithë vullnetin e mirë në kushtet e operimit përmes projekteve, granteve, etj. këto lloj kostosh specifike për të paguar sigurimet në aksident janë të papranueshme dhe të pambuluara nga kostot e projekteve. Jam dakort me ligjin në sigurimin e vullnetarve në aksident, është standard shumë minimal, megjithatë duhet të ketë mekanizma dhe analizë të detajuar rreth shumës se sa duhet të jetë, dhe ligji duhet të jetë me fleksibël sidomos në rastet e vullnetarizmit të individëve tashmë të punësuar të cilët tashmë i derdhin kondributet shoqërore në vendin e tyre të punës." (Intervistë, S.F, World Vision Albania)*

Sipas Fushekatit ligji është i orientuar drejt monitorimit të rriskut, ka për detyrë të përmbushë nevojat minimale, nuk është hartuar për të shtyrë në progres, por siguron minimumin. Ligji mbron të drejtat minimale te vullnetarit dhe organizatave. Ligji duhet të jetë si një hinkë që nxit institucionet dhe organzatat të jenë mendjehapura.

Nga ana tjetër, Ligji i detyron institucionet të mbajnë një regjistër, të hapin librezat e sigurimeve shëndetësore/ shoqërore dhe duket sikur është ndërtuar posaçërisht për të rinjtë dhe jo për të gjitha grupet e tjera. Nxitja e konceptit të vullnetarizmit nuk duhet nxitur përmes procedurave burokratike dhe mbajtjes së një dokumentacioni, i cili nuk i shërben qëllimit. Ligji duhet të mbrojë të drejtat minimale të vullnetarit dhe organizatave.

Një sfidë shumë e madhe që u përball gjithkush në nivel global është **pandemia COVID-19,** e cila në mënyrë të pashmangshme preku dhe këtë sektor.

Rreth gjysma e të anketuarve (49%) pohojnë se pandemia COVID-19 ka pasur një rol negativ në sektorin e vullnetarizmit. Për këtë arsye, të anketuarit shprehen se gjatë pandemisë është rritur vullnetarizmi digjital (27%). Rreth 20% besojnë se pandemia ka pasur rol pozitiv.



Grafiku 38. Roli që ka pasur pandemia COVID-19 në sektorin e vullnetarizmit

5.4. Disa praktika dhe eksperienca pozitive të ofruesve të vullnetarizmit

Praktikat si në institucionet qendrore, vendore apo dhe te të gjithë ofruesit e vullnetarizmit janë mbledhur nëpërmjet fokus grupeve dhe intervistave të thelluara. Studimi nxjerr të dhëna se mungojnë praktika të mirëfillta dhe të mirorganizuara të rekrutimit, orientimit, menaxhimit dhe vlerësimit të vullnetarëve si nga institucionet qendrore, vendore, ashtu dhe ofruesit e vullnetarizmit, përfshirë këtu OSHC, qendra ditore, komunitare etj. Sigurisht, rast pas rasti ka disa institucione dhe OSHC që kanë praktikat e veta që rezultojnë pozitive, veçanërisht këto praktika vijnë nga organizata të mëdha në vend si World Vision Shqipëri apo organizata të cilat punojnë me vullnetarë wuropianë, ndërkombëtare apo me Korpusin e Paqes. Shumë prej tyre kanë adaptuar apo ndjekin procedurat dhe protokollet e këtyre programeve, të cilat mund të jenë shume efektive dhe lehtësisht të përdorshme dhe për organizatat lokale, të cilat nuk kanë procedura dhe praktika të standardizuara.

5.4.1 Vullnetarizmi në institucionet vendore dhe qendrore

Pjesëmarrësit në fokus grupe shprehen se organizimin i praktikave vullnetare në institucionet publike, p.sh., si në rastin e njësive të vetëqeverisjes vendore mund të jetë një iniciative pozitive që duhet të inkurajohet. Problemi kryesor mbetet polarizimi politik i institucioneve, çka bën që njerëzit të jenë skeptikë për t'u përfshirë si vullnetarë në atë institucion. Pra, ndonëse ekziston dëshira për t'u përfshirë si vullnetar në institucionet e qeverisjes vendore, frika e etiketimit se po i shërben një partie të caktuar i dekurajon qytetarët të ndërmarrin iniciativa të tilla.

Nga ana tjetër, institucionet e qeverisjes vendore perceptohen se kanë një ndërgjegjësim të dobët në njohjen e kulturës së vullnetarizmit. Ky ndërgjegjësim është akoma më i dobët te institucionet në zona të largëta rurale. Gjithashtu, ka mungesë praktikash konkrete, mungesë kapacitetesh e burimesh njerëzore dhe mungesë buxhetimi. Rrugëzgjidhja në këto raste do të ishte përfshirja e OSHC-ve vendore, të cilat do të merreshin me çështjet organizative dhe logjistike të vullnetarëve (Fokus grup nr.1, përfaqësues nga bashkitë, datë 11.03.2021).

Një pjesë e konsiderueshme e përfaqësueseve nga bashkitë shprehen se institucionet vendore mund të përpilojnë listat /database-t e vullnetarëve, të cilat i përditësojnë vazhdimisht, një praktikë kjo e ndjekur nga shumë pak bashki, por që dukej një praktikë që dhe bashkitë e tjera apo institucionet e edukimit mund ta përqafojnë lehtësisht.Për shembull, Bashkia Tiranë dhe Durrës gjatë tërmetit dhe pandemisë kanë krijuar një listë/database. Kjo listë i është dërguar edhe policisë për të justifikuar qëllimin e daljes apo grumbullimin e këtyre personave. Grupi i vullnetarëve në varësi të situatave koordinohet nga një person i ngarkuar nga kryetari i Bashkisë. Njëkohësisht, edhe kryetarët e njësive administrative ofrojnë ndihmë,

duke orientuar me adresat e familjeve që kanë më shumë nevojë. Megjithatë, nuk ka një plan afatgjatë të organizmit të vullnetarëve sipas një agjende të përcaktuar. Organizimi i tyre bëhet shpeshherë *ad hoc*, sipas nevojave që paraqet bashkia apo komuniteti në periudha të caktuara. Në rastet kur paraqitet nevoja, bëhet thirrje te lista e kontakteve dhe vlerësohet se cili nga vullnetarët është i gatshëm për të dhënë kontributin e tij vullnetar në aspekte të ndryshme si transport, shpërndarje pakosh etj. Ndonëse këto janë disa praktika të lokalizuara në periudha të caktuara, mungesa e një strukture të qëndrueshme bëhet pengesë për një organizim të planifikuar dhe afatgjatë të vullnetarëve (Fokus grup nr.12, përfaqësues të bashkive, datë 10.03.2021).

Bashkitë nuk kanë një strukturë të dedikuar në bashki për vullnetarizmin, por praktikat vullnetare realizohen në kuadër të ndonjë iniciative apo projekti. Rrjeti i vullnetarëve në bashki menaxhohet në disa raste nga Drejtoria e Rinisë, por nuk është një praktikë e institucionalizuar sipas ligjit të vullnetarizmit. (Intervistë nr. 3 me përfaqësues nga bashkia Tiranë, datë 17.03.202021). Një strukturë e rëndësishme që mund të lehtësonte procesin e koordinimit dhe menaxhimit të vullnetarëve është Këshilli Rinor Vendor, si një strukturë e krijuar rishtazi. Në bazë të Ligjit të Rinisë, bashkitë janë të detyruara të krijojnë Këshillat Rinore Vendorë dhe në këtë rast edhe vullnetarizmi diskutohet në agjendën e Këshillit. Megjithatë, efektshmëria e këtyre strukturave ngelet për t'u konsoliduar më tej. Nga ana tjetër, Drejtoritë e Mirëqenies Sociale apo këndet e BE-së kanë qenë disa nga alternativat e diskutuara më së shumti gjatë fokus grupeve me përfaqësues të bashkive.

Studimi sjell të dhëna pozitive rreth tendencës dhe vullnetit të bashkive për të nxitur vullnetarizmin dhe pranimin e hapur se vullnetarizmi është një forcë shumë e madhe zhvilluese, por që këto institucione kanë nevojë për më shumë kapacitete, mirëorganizim dhe fokus. Fakti që janë të haur dhe të gatshëm është një indikator shumë i rëndësishëm për të ndërmarrë hapa konkretë.

Vullnet pozitiv është reflektuar dhe nga institucionet në nivel qendror dhe pse këto institucione kanë bazë ligjin përkatës dhe aktet nënligjore. Mungojnë praktika konkrete, nisma konkrete, strategji apo plane veprimi. "Ngritja e grupeve të punës me përfaqësues të institucioneve qendrore dhe aktorëve të tjerë përgjegjës për zhvillimin e vullnetarizmit; ngritja e një network-u ndërmjet institucioneve dhe hartimi i një strategjie konkrete janë kyçi, duke filluar me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, bashkitë, organizata, shkolla dhe universitete, media etj." (Intervistë nr 15, D. Avdyli, përfaqësues i Universitetit dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, datë 11 prill 2021).

5.4.2 Vullnetarizmi në organizata të shoqërisë civile

Studimi tregon se organizatat e shoqërisë civile janë hapësira ku vullnetarët dinë ku të orientohen në rast se duan të kontribuojnë vullnetarisht apo aty ku ata dëgjojnë mundësi të hapura për vullnetarë. Institucionet vendore dhe ato të arsimit shohin

gjithashtu OSHC-të si potenciali më i mirë që mund të ofrojnë mundësi vullnetarizmi për qytetarët në kushtet ku jemi. Mënyrat e angazhimit të vullnetarëve nga OSHC-të janë nga më të ndryshmet, por dy janë format më të shpeshta të angazhimit të tyre: 1) me bazë projektesh dhe 2) forma spontane afatshkurtra të organizimit.

Mënyra e koordinimit të aktivistëve ka dy forma: së pari në bazë të aktiviteteve, p.sh., stafi ynë ka një listë të aktiviteteve të cilat ne i kemi të aprovuara, si partnerë ose kryesorë, dhe këto projekte prezantohen te të rinjtë tanë dhe ata bëjnë një aplikim në lidhje me aktivitetin që janë të interesuar. Pastaj janë edhe aktivitete ndërgjegjësuese një ditore të ideuara nga të rinjtë për të rinjtë*, ku ne i ndihmojmë vetëm me lehtësim, duke u shpjeguar sesi organizohet një aktivitet i tillë. (*Fokus grup nr.3, përfaqësues nga OSHC-të, datë 16.03.2021).

Të intervistuarit në fokus grupe shprehen se ka mënyra dhe iniciativa të ndryshme, të cilat OSHC-të mund të përdorin në **rekrutimin e vullnetarëve**. Mënyra më efikase është së pari, vlerësimi i nevojave të vullnetarëve dhe si kjo nevojë mund t'u shërbejë edhe interesave të organizatës ose tregut. Një praktikë e konsideruar pozitive dhe e ndjekur nga një OSHC-të ka qenë rekrutimi i vullnetarëve përmes të **ofruarit të praktikave të punës** dhe krijimit të mundësive për vullnetarizëm apo punësimin e personave që tregojnë një angazhim më serioz. Megjithatë, këtu duhet të kemi kujdes që të mos ngatërrohet vullnetarizmi me praktikat e punës.

Në 2013 në ngritëm Klubet Studentore dhe për të tërhequr vullnetarë ne ndoqëm praktikën e të ofruarit të praktikave të punës dhe deri në 2019 ne kemi regjistruar 2500 anëtarë, të cilët ishin *të* përfshirë në procese të ndryshme. Pra, duhen gjendur forma nga më të ndryshmet të përfshirjes *së* të rinjve*, duke parë pak çfarë interesi kanë ata, si është situate aktuale etj. Momentalisht tek organizata ne kemi 37 ekspertë, të cilët janë angazhuar në aktivitete ndërgjegjësuese kryesisht online, me baza vullnetare. Këto janë persona të fushave të ndryshme dhe në asnjë moment ata nuk e përmendnin nevojën për t'u paguar, pasi pjesëmarrja në aktivitet është promovim për këto persona. Por nga ana tjetër, kemi edhe atë pjesën e vogël të cilët duan të shërbejnë si qytetarë. Pra, e rëndësishme është të kuptojmë interesat e secilit target grup, p.sh te* të rinjtë kemi praktikat e punës, rritje kapacitetesh*, te një target grup tjetër do të gjesh një mënyre tjetër si p.sh., dhënia e mundësisë për të shpërndarë ekspertizën e tyre. (*Fokus grup nr.2, përfaqësues nga OSHC-të, datë 11.03.2021).

Një tjetër praktikë e përdorur për rekrutimin e vullnetarëve nga një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve në fokus grupe është edhe lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore, me qëllim realizimin e praktikave mësimore në organizata. Ndonëse praktika mësimore nuk lidhet drejtpërsëdrejti me aktivitetin vullnetar, pjesëmarrësit i konsiderojnë shpeshherë pjesë e punës vullnetare:

Procedura më e zakontë që ndiqet me universitetet është dërgimi i një liste të studentëve që janë të interesuar të kryejnë praktikat mësimore. Në vijim, OSHC-të përzgjedhin në bazë të disa kritereve vullnetarët që përshtaten me profilin e organizatës. Vullnetarët paraqesin një mjet identifikimi pranë organizatës dhe më tej, organizata paguan detyrimet e sigurimeve shëndetësore. Një pjesë e

përfaqësueseve nga OSHC-të vendore në fokus grupe shprehen se përdorin **modelin tip të kontratave të vullnetarëve** dhe kodin e etikës për të organizuar vullnetarët. (*Fokus grup 2 me OSHC: 11/03/2021).*

Nga ana tjetër, OSHC-të pohojnë se për individët që janë të interesuar dhe vijnë spontanisht pranë organizatës, ndiqen procedura më *ad hoc* në varësi të situatës dhe nevojave të organizatës. Vihet re se dhe në OSHC-të nuk ka procedura të standardizuara për rekrutimin, orientimin dhe menaxhimin e vullnetarëve. Procedura janë më strikte në rastin kur vullnetarët punojnë me target grupe sensitive, siç janë për shembull fëmijët. Këto procedura janë të ngritura për të mbrojtur çdo target grup.

*Në rastet kur kemi pasur thirrje të hapura, kemi pasur procedur*ë të gjatë aplikimi dhe një intervistë. *Aty kemi qenë paksa strikt, pasi në projekte të tjera nuk jemi kaq shumë formal, por meqenëse ka qenë punë direkte me fëmijët, ka qenë instituti ku fëmijët edukohen dhe jetojnë, kjo të krijon ndjesinë që duhet të jemi pak më të kujdesshëm me vullnetarët që fusim në këtë program, në këtë pjesë tregohemi veçanërisht të kujdesshëm me kodin e etikës, ruajtjen e konfidencialitetit dhe jemi shumë të prerë. (Fokus grup nr.13, p*ërfaqësues nga OSHC-të Durrës, Lezhë, Tiranë, datë *10.03.2021).*

Një pjesë e vogël e organizatave kanë një rregullore të brendshme, të cilën ua bëjnë me dije personave të interesuar për të dhënë kontribut vullnetar. Disa organizata të tjera kanë krijuar një format të cilin e kanë quajtur marrëveshje me anëtarin ose përfituesin e shërbimit. Duke qenë se forma ka të gjitha të dhënat gjenerale të përfituesve/vullnetarëve , të gjitha këto të dhëna hidhen në një database. Pjesa më e madhe e të pyeturve pohojnë se vullnetarët janë kryesisht në bazë aktivitetesh dhe jo vullnetarë të përhershëm me kohë të plotë ose të pjesshëm. Kjo është një prej arsyeve për të justifikuar detyrimet që rrjedhin nga Ligji i Vullnetarizmit në lidhje me pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (Fokus grup nr.13,përfaqësues nga OSHC-ve, datë 10.03.2021).

Një praktikë e mirë e rekrutimit, orientimit dhe menaxhimit të vullnetarëve përdor organizata World Vision Albania. Sipas S. Fushekatit rekrutimi i vullnetarëve në WVA bëhet në 2 mënyra: i rastësishëm (ata që shprehin interes vetë për të qenë vullnetarë) dhe i përcaktuar (kur organizata ka synim se kush janë profilet e vullnetrave që përputhen me nevojat e programit të saj). Në të dyja rastet procedurat e angazhimit, trajnimit dhe kordinimit të vullnetarëve është njëlloj. WVA ka përpiluar Poltikën e Vullnetarve: Politika përfshin shumë elemente të ndarë në kapituj: Çfarë është vullnetarizmi, roli, detyrat dhe përgjegjësitë e vullnetarit dhe të ofruesit të vullnetarizmit, procesi i rekrutimit, benefitet, kodi sjelljes, dakortësimi me potikat thelbësore të organizatës, çështje të tjera financiare dhe ligjore." (Intervistë Nr 12, S. Fushekati, Drejtuese Skuadre Njerëz & Kultura (BNj) | World Vision Albania, datë 23.03.2021)

Znj. Fushekati argumenton se çdo dokument/poltikë e standartizuar në organizatë, qoftë dhe një faqe ndikon vetëm në rritjen e standarit dhe cilësisë së punës, të ndihmon të vlerësosh dhe përmirësohesh vit pas viti.Praktika të ngjashme zbatohen dhe nga organizata të ciat kanë eksperienca me vullnetarët europianë

dhe ndërkombëtarë.Praktika të tilla janë thelbësore të ndiqen nga sektori, janë praktika që garantojnë koordinim dhe qëndrueshmëri të imaktit të vullnetarizmit si në nivel shoqëror por dhe në atë individual, duke mos neglizhuar ndikimin poztiv që japin në organizatë.

Një element mjaft i rëndësishëm në menaxhimin dhe cilësinë e praktikimit të vullnetarizmit, është trajnimi apo rritja e kapaciteve të vetë organizatave. Është shumë e rëndësishme që personat/koordinatorët që merren me vullnetarizmin dhe me koordinimin e vullnetarëve, duhet të jenë persona të trajnuar. Në përgjithësi ekziston ideja që çdokush mund të merret me vullnetarët, mund të koordinojë dhe mund të motivojë. Megjithatë një trajnues pa përvojë mund të bëhet ndonjëherë shkak për mos vijimin e eksperiencës së vullnetarizmit. OSHC-të ndjekin një sërë praktikash dhe pika e parë është trajnimi i koordinatorëve të vullnetarëve (Fokus grup nr.13, përfaqësues nga OSHC-të, datë 10.03.2021).

5.4.3 Vullnetarizmi në Qendrat Komunitare

Duke qenë se qendrat komunitare ofrojnë shërbime ndaj komunitetit dhe kryesisht ndaj grupeve më vulnerabël, janë shumë të predispozuara për të përfshirë vullnetarë në aktivitetet e tyre. Disa nga qendrat komunitare angazhojnë njëkohësisht vullnetarë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe angazhimi i tyre bëhet në bazë të nevojës dhe një plani pune institucional. Këto qendra angazhohen në partneritet me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat merren me vullnetarizmin. Në periudha të ndryshme, si p.sh., gjatë kampeve verore vullnetarët mund të jenë pjesë e qendrave 24 orë. Këto vullnetarë realizojnë shërbime, por janë edhe pjesë e gjithë proceseve që ndodhin gjatë një dite në qendra. (Fokus grup nr.11, përfaqësues nga qendrat komunitare të bashkisë Tiranë (“Qendra Multidisiplinare”, “Qendra Komunitare Sëbashku”, “Gonxhe Bojaxhi”, “Strehëza”) datë 6. 04.03.2021). Në lidhje me protokollin që ndiqet për vullnetarët që angazhohen në qendra, hapi i parë është plotësimi i formularit të të dhënave mbi vullnetarët.[2] Ky formular bashkë me kontratën dhe rregulloren është dokumenti i parë që vullnetarët plotësojnë dhe bien dakord që të bëhen pjesë e qendrës, duke respektuar etikën dhe detyrimet në angazhimin që do të ofrojnë. Në kontratë janë vendosur edhe klauzola për pjesën e etikës profesionale të punës, e cila është e njëjtë si për vullnetarët e huaj, ashtu edhe për ata shqiptarë.

Në përgjithësi, qendrat e kujdesit ditor dhe ato sociale mbajnë të dhënat e vullnetarëve për të orientuar më mirë nevojat e tyre drejt aktiviteteve të caktuara, si dhe për ta pasur edhe një vijimësi të punës me vullnetarët. Vullnetarët priten nga përgjegjësia e sektorit social edhe pastaj lidhen drejtpërdrejt me specialistin e fushës ku dëshirojnë të fokusohen më tepër dhe të japin shërbimin e tyre. Vullnetarët prezantohen dhe orientohen me të gjitha aktivitetet e qendrës. Në vijimësi, hartohet

[2] Ky formular tip është kërkesë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social

një plan pune, ku qartësohet angazhimi i vullnetarit, detyrat që ka përgjegjësi dhe angazhimi kohor. Në disa raste, të gjitha kushtet e mësipërme janë të qartësuara edhe te marrëveshjet e bashkëpunimit që qendrat kanë firmosur me OSHC-të që sjellin vullnetarë.

Megjithatë, jo çdo person që shpreh interesin për të qenë vullnetar mund të shërbejë në qendër.

Disa kritere përjashtuese janë që personat të mos kenë probleme të shëndetit mendor, të mos jenë persona që krijojnë probleme. Pra, përmes një procedure intervistimi merren të dhënat bazë dhe vlerësohet interesi i tyre, bëhet një filtrim fillestar i kritereve.

Përfaqësues nga qendrat komunitare shprehen se në disa raste nuk kanë pasur protokolle për pranimin e vullnetarëve që janë të diagnostikuar me problemet të shëndetit mendor. Kjo ka qenë edhe një mënyrë që të stimulojnë gjithëpërfshirjen. Por patjetër ka qenë sfidë për qendrën sepse gjithë kohën e të qëndruarit në qendër është caktuar një individ, i cili ka qenë në monitorim të vazhdueshëm të tyre, kjo për të shmangur çdo lloj incidentit, për aq kohë sa grupi për të cilin japim shërbim janë fëmijët.

Në kontratën që këto qendra nënshkruajnë me vullnetarët nuk parashikohet pagesa e sigurimeve shoqërore/shëndetësore, pasi sigurimet paguhen vetëm për intershipet që ofron bashkia. Padyshim që këto pagesa konsiderohen kosto të papërballueshme për institucionin me një buxhet të limituar.

Qendrat shprehen se një mangësi që ato hasin është mungesa e trajnimeve profesionale për menaxhimin e vullnetarëve apo në lidhje me trajnime për formate të strukturuara dhe formatizuar për sa i përket vullnetarizmit. Përfaqësuesit e tyre e konsiderojnë si nevojë dhe me interes të lartë rritjen e kapaciteteve, shkëmbimet e eksperiencave, nxitjen e praktikave pozitive në mënyrë që të jenë si ofrues, ashtu dhe përfitues nga kontributi vullnetar.

5.4.4 Disa praktika pozitive

Praktika pozitive për organizimin e vullnetarizmit nga OSHC-të

Organizatat e shoqërisë civile kanë një sërë praktikash pozitive dhe me impakt të gjerë të vullnetarizmit. Gjatë periudhës së tërmetit studentët apo qytetarë të shumtë u angazhuan në mënyrë vullnetare për ndarjen e pakove ushqimore, suportin psikologjik që mund t’u ofronin të mbijetuarve apo familjarëve që kishin pësuar stres post-traumatik për shkak të traumës dhe humbjes së të afërmeve të tyre. Shumë qytetarë nga Shqipëria apo edhe vendet e tjera të rajonit kontribuan përmes donacioneve apo aktiviteteve vullnetare.

Sipas një studimi të kryer nga Bino et al., (2020), një numër i konsiderueshëm i organizatave të shoqërisë civile në nivel kombëtar dhe lokal, u organizuan dhe mobilizuan burimet e tyre për të ofruar mbështetje në periudhën e emergjencës. Ato

ofruan, gjithashtu, mbështetje të drejtpërdrejtë me mbledhje fondesh nga anëtarët e tyre dhe nga donacionet. Këto organizata shërbyen si pika ndërlidhëse informimi mes familjeve të prekura dhe atyre që ofronin ushqime dhe materiale të tjera të nevojshme. Është interesant fakti që reagimi i këtij sektori ishte i menjëhershëm, duke qenë se pjesa më e madhe e organizatave arritën të mblidhnin donacione me ushqime dhe duke u angazhuan kryesisht në fushën humanitare, duke siguruar edhe ndihmë financiare për rindërtimin apo ndihma psikologjike që u ofruan me anë të vullnetarëve.

Këtu duhet të theksohet fakti i reagimit pozitiv si ndaj vullnetarëve, ashtu dhe ofruesve të vullnetarizmit, pa shkuar në sfidat dhe mangësitë që ky organizim pati për sa i përket koordinimit dhe sigurimit të vullnetarëve, konsideruar përgatitjen për emergjencat civile.

Organizatat e shoqërisë civile kanë dhe një sërë praktikash të tjera shumë pozitive, të cilat herë pas here promovohen, por herë të tjera lihen dhe në heshtje, duke konsideruar se vullnetarizmi nuk ka nevojë të reklamohet, pas ai duhet të burojë nga zemra për secilin individ apo grup individësh.

Megjithatë, janë mbi 90 % e individëve dhe mbi 95 % e gjithë aktorëve kyçë të cilët bien dakord se vullnetarizmi duhet të promovohet më shumë, konsideruar këtu informimi rreth mundësive, ashtu dhe praktikave të mira, sepse mund të jenë një nxitje dhe motivim si për vullnetarët, ashtu dhe ofruesit e vullnetarizmit. Promovimi i praktikave të mira dhe impaktit të vullnetarizmit padyshim mund të nxisë dhe institucionet politikëbërëse dhe vendimmarrëse për të ndërmarrë politika dhe hapa që ndikojnë në përmirësimin e infrastrukturës së vullnetarizmit.

Praktika pozitive për nxitjen e vullnetarizmit nga bashkitë

Të dhënat nga fokus grupet treguan se angazhimi i qytetarëve dhe kryesisht i grupeve të të rinjve në përballimin e fatkeqësive natyrore, siç është rasti i tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë, është tepër i rëndësishëm në përballimin e këtyre situatave, si dhe jep impakt shumë të madh te target grupi, ashtu dhe tek individi.

Bashkia Durrës ka pasur një praktikë shumë pozitive gjatë tërmetit në 2019, ashtu dhe gjatë pandemisë: *Stafi i bashkisë ngriti një grup vullnetarësh me nxënës/studentët e universitetit, gjithashtu, kemi pasur një mbështetje të madhe nga organizatat e Durrësit dhe Tiranës, të cilat informuan dhe sollën grupet e tyre vullnetare që të ndihmonin bashkinë Durrës. Ndihma e tyre konsistoi në ndarjen e ndihmave në çdo njësi administrative që kishte nevoja imediate. Ne kemi pasur student në bashki të angazhuar, të cilët bënin pritjen dhe marrjen e të gjithë kërkesave/ankesave të qytetarëve, kërkesat për verifikim, pastaj më vonë bonusi i qirasë dhe gjithë kjo punë ka pasur nevojë për vullnetarë, sepse nuk përballohej dot nga stafi i bashkisë. Të gjithë kontaktet e vullnetarëve janë mbajtur në një grup në whats up dhe database fillestar. Nuk kemi mundur të realizojmë aktivitete të mirëfillta të vullnetarizmit, se situata është e tillë, por kemi ndihmuar që ata të marrin trajnime nga organizata të ndryshme nga të cilat unë jam kontaktuar dhe i bëj publikime. Gjithashtu, sa herë kemi aktivitete sporadike. (*Fokus grup nr.1, përfaqësues nga bashkitë Fier, Gramsh dhe Durrës, datë 11.03.2021).

Një shembull i mirë i vullnetarizmit që bashkia Kukës dha ishte gjatë karantinës: *ku i gjithë stafi është organizuar në shpërndarjen e pakove dhe ushqimeve te familjet në nevojë. Gjithashtu,* të rinjtë dhe mosha e mesme kanë pasur në patronazh të moshuarit*, ku shpesh shkonim për t'i pyetur ose bërë pazar për ata. (Fokus grup nr.5,* përfaqësues nga *bashkitë Tropojë, Elbasan, Kukës OSHC-të, media, datë 18.03.2021).*

Bashkia Shkodër *ka një praktikë pozitive, pasi ka përpiluar një database, e cila ndodhet e afishuar edhe në faqen shkodrarinore.gov.al. Aktualisht, jemi në fund të hartimit të formularit për t'u bërë pjesë e grupit të vullnetarë të qytetit, që në rastin e emergjencave civile etj., të kemi një database të gatshëm dhe të kërkojmë disponibilitet prej atyre.*

Emergjencat kanë bërë që ne të vlerësojmë shumë struktura që më përpara nuk i kemi vlerësuar. Ne në Shkodër kemi qendrat komunitare për familjen, është një rrjet qendrash dhe çdo lagje ka qendrën e vet komunitare për familjen dhe brenda janë specialistët p.sh: punonjësi social, psikologu, që veprojnë aty dhe ka edhe organizata që shkojnë dhe implementojnë projektet e tyre. Por këto na kanë ndihmuar të marrim emrat e familjeve që janë në nevojë dhe punonjësi që është aty e ka menaxhuar lagjen shumë mirë (Fokus grup nr.12, përfaqësues nga bashkitë Shkodër dhe Lezhë, datë 10.03.2021).

Bashkia Lezhë*: Për sa i përket Lezhës, ne kemi eksperienca vullnetarizmi, jo të organizuara me dokumentacione, por vullnetarët në situata të ndryshme (tërmeti, pandemia, përmbytjet) gjithmonë u janë gjendur institucioneve. Këto vullnetarë u janë gjendur familjeve në nevojë për t'ju dhënë ndihmën në momentin kritik, por edhe në vazhdimësi. Me rastin e tërmetit u bë një thirrje nga bashkia dhe vullnetarë të moshave të ndryshme, 18-60 vjeç, iu bashkuan thirrjes për vullnetarizëm dhe u ngrit një grup koordinimi për t'i thirrur këta vullnetarë sipas nevojave. Ky grup funksionoi edhe gjatë karantinës, aq më tepër që gjatë asaj periudhe kishim edhe kufizimin e lëvizjes dhe u organizuan në grupe sipas njësive administrative për t'ju ardhur në ndihmë personave ose familjeve në nevojë, për t'i suportuar me ushqime ose nevoja të tjera për përballimin e situatës. Edhe në shumë raste të tjera në bashkinë Lezhë janë bërë aktivitete vullnetare në promovimin e turizmit, aktivitete për promovimin e mjedisit, këtu kryesisht kanë qenë të rinj, por edhe grupmosha të ndryshme.* (Fokus grup nr.12, përfaqësues nga bashkitë Shkodër dhe Lezhë, datë 10.03.2021).

*Edhe kryetarët e Njësive Administrative, të cilët kanë listat e familjarëve dhe këtyre familjarëve u është vënë në dispozicion edhe numri i telefonit të personit përgjegjës ku ai mund të kërkojë një shërbim të caktuar, si për shembull blerjen e ilaçeve, blerjen e ushqimeve, edhe pse grupi nuk është me intensitetin e ditëve të para, por është funksional. (*Fokus grup nr.12, përfaqësues nga bashkitë Shkodër dhe Lezhë, datë 10.03.2021).

Njësitë e qeverisjes vendore janë një potencial i madh në nxitjen dhe ushtrimin e vullnetarizmit, ato kanë rol politikëbërës, koordinues dhe ushtrues të vullnetarizmit. Fokus grupet shërbyen jo vetëm për të mbledhur të dhënat e këtij studimi, por qartësisht u reflektua nevoja e kontakteve mes bashkive, si dhe ndarjet e eksperiencave. Ndarja e disa praktikave pozitive ka nxitur përqafues të bashkive të eksplorojnë më shumë rreth praktikave të tjera, por mbi të gjitha ka motivuar gjithsecilin. Këtu del në pah nevoja e institucioneve të bashkëpunojnë më ngushtë së bashku, të ndajnë praktikat dhe sfidat.

Praktika pozitive për nxitjen e vullnetarizmit nga institucionet arsimore

Gjatë realizimit të fokus grupeve në institucionet arsimore janë evidentuar një sërë praktikash të mira të vullnetarizmit. Në disa raste vullnetarizmi ngatërrohet me orët komunitare si nga ana e mësuesve, ashtu dhe nxënësve, por në këtë rast janë sjellë praktika të mirëfillta të vullnetarizmit

Ne tek institucioni ynë organizojmë më shumë veprimtari humanitare sesa vullnetare, por unë shoh që vetë nxënësit shfaqin interes për të shërbyer si vullnetarë në ndihmë të komunitetit, sidomos në kuadër të 3 Dhjetorit - Dita e Personave me Aftësi Ndryshe. Ne çdo vit shkojmë te qendra "Horizont" në qytetin e Fierit dhe organizojmë veprimtari të ndryshme, aktivitete të ndryshme dhe shikojnë që nxënësit interesohen vetë nëse mund të angazhohen edhe si vullnetarë. (Fokus grup nr.6, përfaqësues nga institucionet arsimore nga bashkitë Kamëz, Fier, Elbasan, Rrogozhinë, Përrenjas datë- 22.02.2021).

Në Sarandë janë marrë nisma nga më të larmishmet, që nga hapësirat sociale, te shtëpia e fëmijëve, të moshuarit etj. Shpeshherë nxënësit kanë marrë iniciativa vullnetare, që nga dhuratat për ata fëmijë qoftë në të mira materiale simbolike modeste, por që e kanë marrë përsipër dhe e kanë parë që është një gjë interesante, e këndshme dhe bashkëpunuese. Të gjitha këto, si të thuash, na çojnë në këtë hullinë e madhe, ku njeriu ndjehet solidar, altruist, bashkëpunues. (Fokus grup nr.8, përfaqësues nga institucionet arsimore nga bashkitë Vorë, Sarandë, Shijak, Tiranë, datë 24.02.2021).

Në fakt, vullnetarizmi është i kultivuar në shkollën tonë, duke qenë se, në situata të ndryshme që kanë ndodhur në Shqipëri, i kanë bërë nxënësit të jenë pak më të ndjeshëm për sa i përket kësaj teme. Ndërkohë, një grup nxënësish janë bërë pjesë e një projekti, ku dy shoqata po na ndihmojnë dhe nxënësit janë ata që po punojnë në mënyrë vullnetare për të rregulluar një nga ambientet e shkollës, për ta bërë më funksional për të rinjtë: për të kaluar kohën apo shpenzuar momentet e tyre të lira. Ndërkohë, edhe për sa i përket vullnetarizmit në qytet, ndihmonin më përpara, se tani pandemia nuk na ka favorizuar shumë për sa i përket pastrimit apo rregullimit të ambienteve të ndryshme në zonat e ndryshme të qytetit. Ajo që po bëjmë edhe me këtë grupin tani është krijimi i hapësirave argëtuese, d.m.th., që shkolla të mos shikohet vetëm si ai vendi ku ata vijnë thjeshtë për të mësuar, për të ndjekur një proces akademik, por për të parë edhe anën argëtuese. Nuk e di... në çfarëdolloj aspekti, qoftë social, por edhe në aspektin komunikativ mund të ketë për shembull nevoje për të ndihmuar nxënës të tjetër që janë në nevojë apo ambiente që kanë nevojë për t'u rregulluar në shkollë. Një mësues duhet ta nxisë këtë frymë, të paktën unë personalisht jam përpjekur ta bëj brenda klasës, duke nxitur vullnetarizmin social, d.m.th., një nxënës i dobët të merret përsipër për ta ndihmuar nga një nxënës i mirë, duke e mbajtur në bangë apo duke e ndihmuar për detyrat. Ose duke parë nxënësit që bullizohen, të nxisin masën që t'i mbështesim dhe mos t'i lënë personat agresivë, por t'i vënë në qendër të vëmendjes. Këto mund të jenë gjëra të vogla dhe ndoshta vullnetarizmi kërkon më shumë së kaq. (Fokus grup nr.10, përfaqësues nga institucionet arsimore nga bashkitë Konispol, datë 26.02.2021).

Edhe pse në realitetin e Shqipërisë vullnetarizmi është shtyllë e shoqërisë civile, institucionet e arsimit, të të gjitha niveleve, nëpërmjet praktikave pozitive mund të inkurajojnë shumë vullnetarë, komuniteti, ashtu dhe të rinjtë. Është e rëndësishme që këto institucione të zhvillojnë dhe promovojnë sa më shumë këto praktika, të nxisin dhe të motivojnë këdo, të jenë të hapura dhe bashkëpunuese me qytetarët dhe institucionet. Gjithashtu, studimi ka nxjerrë të dhëna të konsiderueshme rreth trendeve dhe interesit të qytetarëve për të qenë vullnetarë në shkolla. Të qenit të hapur ndaj praktikave të mira dhe të reja do të shkonte në përputhje shumë të ngushtë me nevojat e institucionit dhe interesave të qytetarëve. Informimi, motivimi dhe rritja e kapacitete të mësuesve janë kyçi për të pasur shkollat si palë dhe të kenë rol proaktivë në nxitjen dhe ushtrimin e vullnetarizmit. Përqasja pozitive institucionale dhe të qenit mendjehapur dhe bashkëpunues janë të një rëndësie thelbësore.

Praktika pozitive për nxitjen e vullnetarizmit nga qendrat komunitare sociale

Qendra e ofrimit të shërbime komunitare e sociale sjellin një sërë praktikash shumë pozitive dhe me impakt, veçanërisht në Tiranë, Berat dhe Vlorë. Këto qendra jo vetëm e kuptojnë vlerën e vullnetarizmit, përpiqen të kenë disa procedura dhe standarde në menaxhim, por dhe përfshijnë vullnetarë si nga komuniteti, ashtu dhe prej bashkëpunimit shumë të ngushtë që kanë ndërtuar me organizatat e shoqërisë civile. Dhe ose këto qendra janë nën varësi të bashkive, përqasja e tyre ngelet më e hapur ndaj vullnetarizmit për shkak të natyrës së shërbimeve që ato ofrojnë dhe lidhjes shumë të ngushtë që kanë me komunitetin.

Te qendra jonë komunitare ka pasur gjatë gjithë kohës vullnetarë. Duke qenë se ne në qendrën tonë ofrojmë shërbimin e fizioterapisë, student të fizioterapisë nga Spanja kanë ardhur në Shqipëri dhe i janë atashuar një organizate të caktuar. Ata kanë më shumë se një vit që ofrojnë shërbimin dhe ndihmojnë edhe fizioterapisten, por edhe përfituesit për ta marrë shërbimin më mirë. Megjithatë, shumica e tyre kanë qenë shumë të angazhuar, sidomos gjatë periudhës së tërmetit, ku ne kemi pasur shumë persona që u strehuan në qendrën tonë dhe realisht kishim shumë nevojë për ndihmë, pasi kapacitetet e stafit nuk i mbulonin dot nevojat dhe ajo ka qenë një periudhë ku vullnetarët kanë qenë gjatë gjithë kohës në qendër dhe kanë ndihmuar. Ndërkohë, shpeshherë kanë ardhur edhe në kohën e pandemisë. (Fokus grup nr.11, përfaqësues nga qendrat komunitare të bashkisë Tiranë ("Qendra Multidisiplinare", "Qendra Komunitare Sëbashku", "Gonxhe Bojaxhi", "Strehëza") datë 6. 04.03.2021).

Kemi pasur një numër të konsiderueshëm vullnetarësh këto 4 vitet e fundit. Edhe vendndodhja e bën këtë qendrën tonë të kemi goxha aktivizim vullnetar. Prezenca e vullnetarëve nuk ka qenë vetëm gjatë kampeve verore, por edhe ditë të caktuara, ku vullnetarët e huaj dhe shqiptarë na bashkoheshin dhe organizonin lojëra psiko-sociale ose gatuanim me fëmijët, organizojnë aktivitete më të moshuarit etj. Impakti që ata japin në target grupet dhe në komunitete është shumë i çmuar. Megjithatë, ka vështirësi, pasi vullnetarët përgjithësisht vijnë nga një realitet që janë ende në bangat e shkollës, ndryshe nga ne që jemi profesionistë, ata duan kohë që të ndërtojnë marrëdhëniet me fëmijët, por

duke i ndjekur e duke u qëndruar afër, përshtatja bëhet më e lehtë. Megjithatë, duam të vlerësojmë shumë një zonjë, e cila ka dhënë kontributin e saj për 3 vjet në punën tonë të përditshme me fëmijët. Vlerësojmë shumë kontributin që ka dhënë në mbështetjen dhe përgatitjen e fëmijëve që kanë pasur projekte shkollore, detyra, duke qenë pjesë e stafit. (Fokus grup nr.11, përfaqësues nga qendrat komunitare të bashkisë Tiranë ("Qendra Multidisiplinare", "Qendra Komunitare Sëbashku", "Gonxhe Bojaxhi", "Strehëza") datë 6. 04.03.2021).

Kjo është një praktikë shumë pozitive e vullnetarëve që vijnë nga programet evropiane, të koordinuara nga organizata kombëtare apo lokale në vend. Kjo formë e vullnetarizmit sjell impakt shumë të madh si në komunitete, por ashtu dhe te vullnetarët shqiptarë, të cilët hezitojnë apo janë skeptikë ndaj ndikimeve shumëdimensionale të vullnetarizmit. Këto praktika evropiane janë modele konkrete të frymëzimit për qytetarët tanë dhe, nga ana tjetër, përcjellin vlerat e solidaritetit, vlerat e vullnetarizmit evropian për impakt social, qytetarisë aktive etj.

5.5 Si mund të motivohen vullnetarët dhe ofruesit e vullnetarizmit?

Disa nga faktorët shtytës që rrisin qëndrueshmërinë e praktikave vullnetare dhe shërbejnë si faktorë nxitës kanë të bëjnë me ofrimin e iniciativave dhe instrumenteve që rrisin motivimin te vullnetarët. Disa nga iniciativat kryesore që përmenden në fokus grupe kanë të bëjnë me mundësinë e punësimit pas punës vullnetare, përfshirjes në aktivitete ndërkombëtare apo ndarja dhe promovimi i praktikave më të mira vullnetare te të rinjtë.

Vullnetarizmi i qëndrueshëm nxitet kur të rinjtë dhe qytetarët kanë benefite të ndryshme, të të gjitha llojeve, duke filluar nga shkëmbimi i eksperiencave me grupe rinore që rezultojnë të suksesshme në fushën e vullnetarizmi, deri në përfitime të trajnimeve e njohje me pikë vlerësuese për çdo aplikim që të rinjtë mund të bëjnë për një vend pune në të ardhmen. Vullnetarizmi nxitet duke krijuar hapësira ku vullnetari gjen vetveten.

Një tjetër iniciativë që mund të ndihmojë në nxitjen e vullnetarizmit është mirorientimi i vullnetarëve drejt aktiviteteve që janë të pëlqyeshme për ata. Vetëm në këtë mënyrë vullnetarët do të ndihen të motivuar për t'u përfshirë në aktivitete që vërtete iu japin kënaqësi:

Kjo është gjëja që praktikisht duhet të adresohet mirë, pasi duhet që të rinjtë të vijnë me vullnetin e plotë që duhet të bëjmë gjithçka, por ideja është t'i orientojmë, duke i vlerësuar aftësitë e tyre për të bërë diçka që u pëlqen. Në fund të fundit, nëse i fusim në diçka që nuk u pëlqen, koncepti i vullnetarit duket sikur bëhet i detyrueshëm. (Fokus grup nr.12, përfaqësues nga bashkitë Shkodër dhe Lezhë, datë 10.03.2021).

Gjithashtu, rezulton shumë e rëndësishme se vullnetarët motivohen duke i mbajtur ata aktivë herë pas here, duke shmangur shkëputjet e gjata. Ndonjëherë

kjo shkëputje është e pashmangshme për shkak të sfidave që sektori has lidhur me qëndrueshmërinë dhe kapacitetet financiare, burimet njerëzore dhe programatike.

Ka shumë raste që vullnetari mund të jetë i interesuar vetëm për çështje psiko–sociale, ndërkohë ne i japim punë të tjera që nuk kanë lidhje me fushën e tij/saj të interesit dhe presim që të ketë jetëgjatësi në këtë gjë. Pra, mendoj që duhet parë nga të dyja këndvështrimet dhe në gjykimin tim, nëse ne u gjejmë mënyra atraktive të rinjve, kjo do të ndikojë në jetëgjatësinë dhe angazhimin e tyre paksa më afatgjatë. Por unë e shoh nga të dyja anët si nga ofruesi, të pasurit një strukturë, por edhe nga ana e të rinjve që pak a shumë ka filluar edhe t'u humbasë besimi, sepse në shumë vende mund të përdoret thjeshtë në një projekt të caktuar dhe më pas nuk ka asgjë. (Fokus grup nr.13, përfaqësues nga OSHC-të Durrës, Lezhë, Tiranë, datë 10.03.2021).

Krijimi një praktike dinamike dhe të shumëllojshme përmendet si një alternativë për të rritur motivimin e vullnetarëve. Praktikat evropian dhe ndërkombëtare kanë vënë re dhe praktikojnë tërësisht nxitjen e individëve të gjenerojnë ide dhe ndërmarrin iniciativat e tyre. Kjo praktikë është konsideruar shumë efektive nga rreth 85 % e ofruesve të vullnetarizmit, sepse i mban vullnetarët aktivë, ndihen të motivuar, ndihen të vlerësuar, zhvillojnë shumë aftësi të marrjes së iniciativave, përgjegjësisë, koordinimit etj. Nga ana tjetër, ofruesit e vullnetarizmit raportojnë se të nxiturit dhe krijimit të hapësirave për vetë iniciativat nga vullnetarët është, gjithashtu, një aftësi dhe mendësi që duhet zhvilluar dhe nga sektori, pasi shumica e kanë të vështirë t'i besojnë një vullnetari.

Informimi i vullnetarëve për përfitimet personale dhe profesionale nga puna vullnetare krijon gjasat që ata të jenë më të ndërgjegjshëm për përfitimet që vijnë nga puna vullnetare.

*Sa herë ne thërrasim vullnetarë, përpiqemi t'i bindim në tri gjëra: e para, që vullnetarizmi nuk është punë e paguar në para, por të rikthehet ty në përfitime të formave të tjera, në njohuri, e dyta, në eksperiencë dhe e treta në kontakte dhe njohje. Sepse në një organizatë të shoqërisë civile të punosh si vullnetar do të thotë të takosh një biznesmen, të takosh një drejtor shkolle, të takosh një zyrtar bashkie etj., duke qenë se ti e takon atë dhe organizata të referon me fjalë të mira, është më e thjeshtë të gjesh një vend pune. (*Fokus grup nr.13, përfaqësues nga OSHC-të Durrës, Lezhë, Tiranë, datë 10.03.2021).

Përdorimi i stimujve të ndryshëm nga organizata si trajnime, certifikata, çmime etj.

Ne në organizatën tonë zbatojmë disa mënyra për të stimuluar vullnetarët, p.sh., bëjmë shumë shkëmbime eksperiencash me grupet vullnetare të organizatave të tjera, ofrojmë trajnime, i mbështesim dhe japim bursa për sipërmarrje sociale. Ka disa mënyra stimuluese, por nuk kanë mjaftuar dhe mendoj do të ishte e rëndësishme që vullnetarizmi të njihej zyrtarisht dhe përvoja të jetë e vlefshme për CV, kështu, vullnetarët do të ishin më të motivuar, pra, do të kontribuonin vullnetarisht dhe eksperienca do t'ju njihej. (Fokus grup nr.3, përfaqësues nga OSHC-të, datë 16.03.2021).

Motivimi i vullnetarëve është një çështje shumë e rëndësishme dhe kërkon një trajtim apo studim të veçantë, për të parë dhe matur se si dhe sa ndikon secili stimul

te vullnetarët, duke marrë në konsideratë moshat, statusin social dhe ekonomik të çdo vullnetari.

Në tërësi, nga ky studim evidentohet se certifikata, libreza evullnetarit, njohja si eksperiencë pune apo kredite për studime, promovimi i aftësive të secilit vullnetar etj., janë një motivim shumë i mirë për të rinjtë. Nga ana tjerër, personat e punësuar motivohen duke gjetur një ambient pozitiv, relaksues, duke u ndjerë të dobishëm në atë që bëjnë, pasi për një pjesë të madhe të personave që janë të stabilizuar në tregun e punës e shohin vullnetarizmin në dy këndvështrime kryesore: për të dhënë ndihmën e tyre dhe për t'u larguar nga rutina e përditshme që ju sjell puna/ profesioni.

Ndërsa moshat afër pensionit apo në pension e konsiderojnë vullnetarizmin si një investim në kauza të rëndësishme, por dhe vetëpërmbushje, veçanërisht për të marrë dhe ndier mirësinë e një procesi të tillë.

Në këtë situatë, në të cilën organizatat e shoqërisë civile janë ofruesit më potencialë në rolin e ofruesve të vullnetarizmit, pritet që ato të kenë përgjegjësinë për të gjetur dhe zbatuar mekanizmat për motivimin e vullnetarëve, është rëndësishme të analizohet dhe kuptohet nevoja si dhe motivimi i tyre. Ky studim sjell një perspektivë të përgjegjshme, pasi dhe motivimi i ofruesve të vullnetarizmit ka nevojë për një tjetër fokus të veçantë.

Të pyetur se si mund të motivohet më shumë sektori i shoqërisë civile për të ofruar vullnetarizëm më të qëndrueshëm, cilësor dhe të mirëstrukturuar, pjesëmarrësit në fokus grupe shprehen se e shohin të nevojshme rritjen e përqindjes së buxhetit të shtetit për çështjet e vullnetarizmit dhe përpos kësaj, duhet të ketë më shumë mbështetje nga strukturat qeveritare për shoqërinë civile *(Fokus grup 2 me OSHC: 11.03.2021).*

Gjithashtu, organizatat do të motivoheshin nëse kuadri ligjor, institucional dhe ai rregullator do të konsideronte organizatat si palë të rëndësishme, do t'i njihte ato si partnerë, dhe jo vetëm si një sektor që sjell progres shoqëror, por vetëm nëpërmjet fondeve apo donacioneve. Një faktor tjetër motivues ka të bëjë edhe me njohjen e praktikave vullnetare nga ana e institucioneve shtetërore. Për këtë është e rëndësishme të ngrihet një mekanizëm nga ana e institucioneve përkatëse për njohjen e vullnetarizmit si eksperiencë pune në zyrat e punës.

Ekziston në përgjithësi një mungesë bashkëpunimi midis OSHC-ve dhe kjo klimë jopozitive vihet re edhe në adresimin e sfidave të përbashkëta. Për shembull, gjatë periudhës së mbylljes për shkak të pandemisë, organizata ose të punësuar në organizata nuk u përfshinë në skemat e shpërblimit.

Vullnetarizmin mund ta nxisim nëpërmjet krijimit **të imazhit adekuat e të duhur** të shoqërisë civile.

5.6 Perspektiva dhe nxitja e vullnetarizmit

Studimi sjell të dhëna të qarta se ka shumë nevojë që vullnetarizmi të nxitet, të praktikohet, mbështetet dhe të ofrohet infrastruktura e përshtatshme si për vullnetarët, ashtu dhe për ofruesit e vullnetarizmit. Pjesa dërmuese e të pyeturve dakordësohen me idenë që vullnetarizmi në Shqipëri duhet të nxitet, fuqizohet dhe promovohet (93%), përkundrejt 6.1 % që nuk e dinë.

Gjithashtu, pothuajse të gjithë (100 %) individët në rolin e përfaqësueseve të aktorëve kyçë si ofrues vullnetarizmi dakordësohen me faktin që vullnetarizmi duket dhe ka nevojë të nxitet, strukturohet dhe fuqizohet, për të qenë një forcë shtytëse për zhvillim shoqëror. Por debati më i madh dhe pyetja më a madhe që ka lindur nga ky studim dhe ka hapur shumë vend për diskutime, konsultime dhe ndoshta studime të tjera në të ardhmen është se kush dhe si duhet ta nxisë vullnetarizmin në Shqipëri?

Institucionet vendore duken se kanë dëshirën, por nuk kanë potencialet, dhe e shohin të pamundur të luajnë rol kyç. Ato e konsiderojnë shoqërinë civile si një aktor kyç dhe potencial. Ndërkohë, institucionet qendrore e kanë të paqartë se kush ka rol kyç, veçanërisht i referohen forcës që ligji duhet të ketë, por dhe ato mendojnë se shoqëria civile është kyçi. Ndërkohë, përfaqësues të shoqërisë civile bien dakord se kanë disa praktika dhe modele të mira, kanë eksperiencat, por kanë nevojë për mbështetje, bashkëpunim, njohja, sepse ato përballen me shumë sfida, qoftë programatike, qoftë financiare, të cilat shpeshherë e bëjnë këtë sektor të paqëndrueshëm.

Megjithatë, të dhënat e mbledhura duket se bashkëpunimi ndërsektorial, konsultimet dhe bashkëpunimi me të gjithë aktorët kyçë: shoqëri civile, institucione qendrore, vendore, media, komunitete private, biznesi privat etj., do të sjellë një realitet më të qëndrueshëm dhe cilësor në ofrimin dhe ushtrimin e vullnetarizmit.

Në vijim, tabela më poshtë na sjell disa të dhëna se çfarë qytetarët mendojnë:

Tabela 8. Institucionet që kanë rol në nxitjen e vullnetarizmit

NDRYSHORI	NUMRI	PËRQINDJA
Kontributi vullnetar:		
Individi	308	27.9
Organizatat e shoqërisë civile	250	22.6
Institucionet qendrore	170	15.4
Pushteti vendor	248	22.5
Media	128	11.6

Një sërë institucionesh perceptohen se mund të luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e vullnetarizmit, ndër të cilat rolin kryesor duhet ta luajnë organizatat e shoqërisë civile.

Në nivel qendror, institucion kryesor mbetet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë**.** Inspektorati i Punës shërben si një mekanizëm mbikëqyrës apo institucion ligjzbatues për të monitoruar aspekte të vullnetarizmit. Në zbatim të ligjit, Agjencia Kombëtare e Punësimit duhet të mbajë databazën e vullnetarëve dhe njëkohësisht të ofruesve të vullnetarizmit, si edhe duhet të pajisë me libreza vullnetari të gjithë vullnetarët. Megjithatë, këto institucione paraqesin vështirësi për shkak të mosplotësimit të kuadrit nënligjor mbi vullnetarizmin. (Intervistë nr.2 me përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Punësimit, datë 09 mars 2021). Ministria e Arsimit dhe Rinisë, Shërbimi Kombëtar i Rinisë ka përgjegjësi shumë të rëndësishme në promovimin, nxitjen dhe praktikimin e vullnetarizmit në Shqipëri. Ministria planifikon të realizojë edhe një monitorim të zbatimit të objektivave. (Objektivi 6: Kultura dhe vullnetarizmi në kuadër të Strategjisë për Rininë. (Intervistë nr.4 me përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Rinisë, date 27.03.2021).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm, pasi perceptohen si ofruesit e shërbimeve në nivel vendor dhe pushteti më afër qytetarëve. Pushteti vendor perceptohet shpesh si një instrument lehtësues/ koordinues, për shkak të veprimit të drejtpërdrejtë me qytetarët, OSHC-të apo shkollat në njësitë e vendore. Qeverisja lokale garanton qëndrueshmëri të aktiviteteve.

*Mendoj që pushteti vendor, së paku në kontekstin ku është Shqipëria, është themelor për nxitjen e vullnetarizmit. Së pari, me ndarjen e re administrative të gjitha njësitë vendore e kanë mundësinë të shohin panoramën e situatës se ku duhet të operohet, jo vetëm në qytete, por edhe në zonat rurale dhe këto njësi i kanë mundësitë, nëse jo për të ndihmuar, por për të pasur një database të njohjes së situatës dhe gjithë organizata, individët bizneset e tjera të mund ta adresojnë ndihmën aty ku është, sepse një ndihmë e dhënë në momentin dhe vendin e duhur është shumë rezultative dhe e ndihmon avancimin***.*** **(**Fokus grup nr.5, përfaqësues nga bashkitë Tropojë, Elbasan, Kukës OSHC-të, media, datë 18.03.2021).

Institucionet arsimore perceptohen se kanë një rol tepër të rëndësishëm në nxitjen e vullnetarizmit përmes edukimit të brezave të rinj. Edukimi në sistemet arsimore duhet të orientohet për nxitjen e ndërgjegjësimit të nxënësve për benefitet e vullnetarizmit, impaktin në komunitet dhe në shkollë. Shkollat qendër komunitare kanë një infrastrukturë të ngritur, që mund të lehtësojë dhe akomodojë nevojat që vijnë nga OSHC-të apo grupe të ndryshme interesi në lidhje me praktikat vullnetare. Njëkohësisht, bashkëpunimi me prindërit shërben si faktor kryesor në nxitjen e vullnetarizmit në shkolla. Nxitja e vullnetarizmit në shkollat mund të jetë tepër e dobishme për nxënësit që paraqesin vështirësi në nxënie apo kanë probleme psiko-emocionale, nxënësit me aftësi ndryshe. Disa nga strukturat që sugjerohen për t'u përfshirë dhe angazhuar në nismat vullnetare në shkolla janë dhe klubet e nxënësve, qeveria e nxënësve, shërbimi komunitar, shkolla qendër komunitare. Përpos

infrastrukturës nxitëse për vullnetarizëm, kurrikulat mësimore mund të shërbejnë si instrumente që inkurajojnë dhe ndërgjegjësojnë nxënësit drejt vullnetarizmit. Në shkolla, mësuesit duhet të inkurajojnë dhe stimulojnë nxënësit të bëhen pjesë e klubeve social-vullnetare, pra, të stimulojnë angazhimin nga vetë nxënësit, pa qenë e nevojshme për t'u mbështetur te vullnetarët jashtë shkollës. Mësuesit kanë rolin kryesor për të stimuluar dhe kultivuar vullnetarizmin te nxënësit, si një aktivitet human dhe i dobishëm për komunitetin. Gjithashtu, në shkolla, funksionojnë edhe **Qeveritë e Nxënësve.** Edhe ato janë një burim i mirë informacioni apo nxitje e vullnetarizmit apo aktivitete me të rinjtë (Fokus grup nr.4, përfaqësues nga OSHC-të, datë 16.03.2021).

*Unë mendoj që një nga institucionet kryesore për nxitjen e vullnetarizmit është shkolla, pasi aty adoleshentët formojnë karakterin e tyre dhe kanë entuziazmin për të filluar punë dhe për të vazhduar jetën e tyre me punë, sepse është një moshë ku ose zgjedh të punosh, ose jo. Kjo do të hedhë rrënjë e do të bëhet një traditë, kulturë në shkollat në Shqipëri. Ndoshta këto institucionet që merren me hartimin e kurrikulave apo ndoshta hartimi i diçkaje në këtë drejtim do ta ndryshojë qasjen. (*Fokus grup nr.11, përfaqësues nga qendrat komunitare të bashkisë Tiranë ("Qendra Multidisiplinare", Qendra Komunitare Sëbashku", "Gonxhe Bojaxhi", "Strehëza"), datë 6. 04.03.2021.

Një aktor shumë i rëndësishëm në nxitjen e vullnetarizmit konsiderohet edhe **familja**, e cila në bashkëpunim me mësuesit dhe komunitetin e nxënësve mund të inkurajojë vullnetarizmin.

Përderisa ne themi që shkolla ka kaluar si qendër komunitare, doja të thoja nuk janë vetëm fëmijët ata që duhet të kryejnë fushatat sensibilizuese dhe mësuesit, por të përfshihen edhe vetë prindërit në aktivitete të përbashkëta vullnetare dhe duke forcuar atë trekëndëshin prind-shkollë-fëmijë. (Fokus grup nr.11, përfaqësues nga qendrat komunitare të bashkisë Tiranë ("Qendra Multidisiplinare", "Qendra Komunitare Sëbashku", "Gonxhe Bojaxhi", "Strehëza"), datë 6. 04.03.2021).

Organizatat e shoqërisë civile konsiderohen si mekanizmat kryesorë që duhet të angazhohen në organizmin dhe nxitjen e praktikave vullnetare. OSHC-të të cilat punojnë dhe e kanë pjesë të punës së tyre të përditshme punën me të rinjtë dhe vullnetarizmin luajnë një rol të qenësishëm për të nxitur vullnetarizmin e qëndrueshëm.

Ndërkohë, edhe pse **njësitë e qeverisjes vendore** mund të luajnë një rol të rëndësishëm në organizimin e vullnetarëve përmes asistimit të OSHC-ve, roli i tyre mbetet përgjithësisht dytësor, duke qenë se janë të orientuara kryesisht në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Këndi i BE-së mund të bëjë koordinimin e çështjeve të vullnetarizmit, por mund të zbatohen shumë mirë nga Drejtoria e Shërbimit Social, pasi janë ata drejtoria që me të vërtetë ka nevojë. Vullnetarizmi nuk është për të promovuar vlerat, por është për t'i ardhur në ndihmë komunitetit në nevojë dhe ndoshta do të ishte shumë mirë që të ishte atashuar Drejtoria e Shërbimit Social.

Një drejtori tjetër që mund të ndikonte dhe mund të japë kontribut në nxitjen dhe aktivizimin e të rinjve vullnetarë është edhe **Qendra e Aktiviteteve për Fëmijë**, sepse atje realisht organizohen aktivite të ndryshme, ku përfshihen të rinj dhe fëmijë të grupmoshave të ndryshme dhe janë një burim i mirë për të nxitur dhe zhvilluar vullnetarizmin.

Drejtoritë Rajonale Arsimore (DRA) janë të rëndësishme për nxitjen e vullnetarizmit, pasi ato koordinojnë punën me shkollat para universitare/universitare. Këto institucione janë më në kontakt me grupe më të gjera dhe mund ta lehtësojnë punën me institucionet publike apo bashkëpunimin me OSHC-të. (Fokus grup Nr.1, përfaqësues nga bashkitë Fier, Gramsh dhe Durrës, datë 11.03.2021).

Një burim shumë i mirë janë edhe **Këshillat Rinore**, që një vit pas miratimit të Ligjit të Rinisë normalisht duhet të ishin ngritur në çdo bashki. Këto këshilla janë një burim i mirë për të nxitur vullnetarizmin, sepse tashmë në çdo bashki duhet të ngrihen Bordet Rinore dhe, duke qenë se do të jenë një strukturë këshilluese e përbërë nga të rinjtë, është një mënyrë shumë e mirë për të nxitur vullnetarizmin dhe për të përfshirë edhe bashkitë në aktivitete të tilla.

Drejtoria e **Rinisë dhe Projekteve**, së bashku me **Njësinë e me Drejtorinë e Integrimit Evropian** konsiderohen si dy nga drejtoritë kryesore për nxitjen e vullnetarizmit, duke qenë se ato mund të bashkëpunojnë me OSHC-të. Në bashkëpunim me këtë sektor këto drejtori janë instrumentale në promovimin e mekanizmave të duhur për zhvillimin e iniciativave vullnetare.

Organizatat ndërkombëtare dhe donatorët

Një rol kyç në nxitjen e praktikave vullnetare mund të luajnë edhe donatorët apo institucionet ndërkombëtare, të cilat mund të promovojnë vullnetarizmin përmes programimit dhe financimit të thirrjeve që inkurajojnë këto praktika, të nxjerrin thirrje të dedikuara për vullnetarizmin.

AMShC ka pjesë të politikave të saj të përhershme nxitjen dhe ofrimin e shërbimeve vullnetare. Për çdo thirrje publike, vullnetarizmi është element kyç i paracaktuar si prioritet. Rreth 10- 15 % e projekteve të financuara janë fokusuar rreth vullnetarizmit, qasjes së tij në shërbime të ndryshme dhe aktivizimit të të rinjve në nisma vullnetare në të mirë dhe interes të komunitetit etj.

Bashkëpunimi OSHC dhe qeverisje lokale

Duke analizuar situatën aktuale të territorit tonë që ai projekt duhet të ketë qëndrueshmëri, ta propozojmë në nivelet e qeverisjes lokale, të pyesim cilat janë objektivat e bashkisë, cilat janë objektivat e organizatës dhe si mund t'i bëjmë bashkë dhe të arrijmë në një përfundim. Nëse organizatat bëhen pjesë e boshtit të një institucioni publik lokal, unë mendoj që ka edhe influencën e drejtpërdrejt për të ndryshuar edhe agjendën politike, kjo është e para. (Fokus grup nr.12, përfaqësues nga bashkitë Shkodër dhe Lezhë, datë 10.03.2021)

Nxitja e bashkëpunimeve

Një pjesë e madhe e përfaqësueseve në fokus grupe janë të mendimit se mënyra më e mirë për të nxitur qëndrueshmërinë është bashkëpunimi i OSHC-ve me bashkitë apo edhe angazhimi i universiteteve dhe shkollave në tërësi.

Platformë kombëtare online: Një tjetër mënyrë efektive dhe inovative e nxitjes dhe koordinimit efektiv të vullnetarizmit pothuajse nga të gjitha institucionet dhe individët që morën pjesë në studim (100 %) e konsiderojnë ndërtimin dhe mirëfunksionimin e një platforme kombëtare, e krahasueshme dhe praktike për të gjithë. Disa pikëpamje në lidhje me organizimin dhe strukturimin e platformës jepen si më poshtë:

Unë mendoj që do të ishte diçka e mirë ndërtimi i platformave të tilla si kundër është VullnetarizmipikëAL dhe nuk ka nevojë të shpikim, pasi mund të përdorim disa asete që kemi. Është një mundësi e mirë për të ndarë informacionin, por duhet të jetë interaktive, të ketë një pyetësor të hapur, një formë aplikimi të hapur, të jetë i ndarë në të gjitha llojet e mediave. Mund të ishte një ide shumë e mirë, e cila mund të bënte një koordinim krejt të natyrshëm, pa sforcime, pa imponime apo edhe keqkuptime. Pra, një platformë që të jetë e prekshme nga të gjithë aktorët e shoqërisë në përgjithësi, si nga ana e institucioneve dhe shoqërisë civile dhe sigurisht të jetë interaktive me komunitetin që duan të japin kontributin e tyre. Gjithashtu, mendoj që kjo platformë duhet të jetë në nivel kombëtar, por gjërat duhet të fillojnë nga poshtë -lartë, pra, duhet të fillohet nga niveli lokal, nga bashkëpunimet me institucionet brenda bashkive, të njihet zyrtarisht nga bashkitë dhe institucionet në varësi të bashkive, por edhe institucione që varen nga ministritë. Iniciativa duhet të jetë nga poshtë - lartë nga organizatat, duhet të konkludohet në një ftesë që duhet t'u bëhet institucioneve dhe pastaj t'i prezantohet komunitetit. (Fokus grup nr.3, përfaqësues nga OSHC-të, datë 16.03.2021).

Studimi ka evidentuar një sërë pikëpyetjesh në rast se platforma do të jetë e qëndrueshme dhe ka sjellë një sërë pyetjesh: kush dhe si duhet ta menaxhojë këtë platformë kombëtare, ku të dhënat e vullnetarëve dhe ofruesve të vullnetarizmit duhet të zbatohen në kohë reale.

Institucionet vendore dhe ato qendrore kanë "merakun" e qëndrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile për të ta mbajtur aktive dhe funksionale, por nga ana tjetër janë të ndërgjegjshme se institucione të tjera në këtë moment nuk mund ta menaxhojnë dot. Rrjedhimisht, diskutimet ngelin akoma në fazë diskutimesh dhe një realitet që duhet testuar, por prevalon rëndësia e bashkëpunimit mes gjithë sektorëve, mbështetje së ndërsjellë dhe përditësimi në kohë për çdo iniciativë dhe institucion, si një mënyrë e jetëgjatësisë dhe mirëfunksionimit të një platforme kombëtare.

Promovimi i modeleve pozitive dhe vullnetarizmit në tërësi ka të bëjë me nxitjen e disa figurave si pika referimi, që konsiderohen ndryshe si agjentë të zhvillimit lokal, që kryesisht janë të rinj aktivë, por edhe një moshë më e madhe. Këto pika referimi ose agjentë zhvillimi mund të shërbejnë si një urë lidhëse midis komunitetit nga një anë dhe institucioneve ose organizatave nga ana tjetër. (*Fokus grup nr.3, p*ërfaqësues nga OSHC-të, datë 16.03.2021).

Për sa i përket se cilat janë mënyrat më të mira për të promovuar vullnetarizmin në Shqipëri, pjesëmarrësit në studim më së shumti përzgjodhën: platformat online dhe faqe interneti, rrjetet sociale (facebook, twitter, linked-in), takimet informuese ballë për ballë, media lokale apo kombëtare dhe bordet/këshillat e studentëve apo grupe të tjera informale.

6 PËRFUNDIME

Vullnetarizmi vlerësohet një ndër praktikat më efikase për ndërtimin e komuniteteve më të qëndrueshme, kohezive dhe sjell benefite të panumërta në dobi të zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor. Vullnetarizmi perceptohet shpesh si një parim apo vlerë që buron nga prirja e brendshme e individit për të qenë i dobishëm në komunitetin ku ai jeton. Për një pjesë të konsiderueshme të pjesëmarrësve, puna vullnetare konsiderohet një kontribut i papaguar, që e pajis individin me vlera përtej përfitimit material dhe personal. Puna vullnetare nxit ndjenjën e solidaritetit në komunitet dhe i bën njerëzit më aktivë dhe të dobishëm.

Angazhimi vullnetar i individëve ka një impakt pozitiv në mirëqenien mendore, duke qenë se edhe përfitimi i tij shihet kryesisht në aspektin moral dhe shpirtëror. Vullnetarizmi perceptohet shpeshherë si një detyrim moral, shoqëror dhe personal në dobi të komunitetit dhe një dëshirë e pakushtëzuar që buron nga vetë individi dhe nevoja për të qenë i dobishëm në komunitet. Ndonëse nuk ka një pagesë monetare, vullnetarët përfitojnë më shumë njohuri dhe përvoja jetësore të dobishme të tilla si: mundësi për rrjetëzim, përmes përvojave të reja dhe njohjeve me njerëz të rinj, perspektiva për zhvillim të aftësive ndërpersonale dhe profesionale, mundësi për argëtim, udhëtime dhe shkëmbim kulturor. Në aspektin e aftësive personale, vullnetarizmi ndikon pozitivisht në përmirësimin e aftësive në komunikim dhe prezantim, aftësive bashkëpunuese dhe ndërvepruese si dhe në zhvillimin e mendimit kritik. Puna vullnetare rrit, gjithashtu, gjasat për t'u integruar më shpejt në tregun e punës në të ardhmen. Megjithatë, koncepti i vullnetarizmit ka ndryshuar dhe evoluar me kalimin e kohës.

Përpos këtyre qëndrimeve, pjesa më e madhe e të pyeturve (77%) besojnë se **kontributi vullnetar në Shqipëri** është shumë i nevojshëm, edhe pse pjesa dërrmuese e tyre nuk kanë mjaftueshëm njohuri në lidhje me institucionet që mund të ofrojnë praktikat e punës vullnetare. Pjesa më e madhe e të pyeturve, 90%, shprehen se nuk kanë informacion se ku dhe si mund të japin kontributin e tyre vullnetar. Më pak të orientuar dhe informuar rreth praktikave vullnetare janë të rinjtë e grupmoshës 18-19 vjeç. Ko tregon nevojën emergjente për të sensibilizuar dhe rritur nivelin e informacionit te të rinjtë në lidhje me orientimin për vullnetarizmin. Institucionet më të përmendura nga pjesëmarrësit që kanë zgjedhur vetëm një alternativë janë: Organizata të shoqërisë civile, bashkinë/njësinë administrative dhe qendrat rinore. Pjesa më e madhe e të anketuarve nuk janë në dijeni të librezës

së vullnetarit, 87%, dhe një pjesë e konsiderueshme 2/3 nuk kanë informacion as për Ligjin mbi Vullnetarizmin. Të pyetur në lidhje me përvojën vullnetare, pjesa më e madhe e të pyeturve, 89%, pohojnë se janë të kënaqur nga kjo eksperiencë. Me rritjen e nivelit të edukimit rritet edhe predispozita për të përjetuar më pozitivisht një përvojë vullnetare.

Për **personat që nuk kanë pasur eksperienca vullnetare**, disa nga arsyet më të shpeshta për mungesën e kësaj përvojë janë: Mungesa e rregulloreve mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e vullnetarëve (67%); mosnjohja dhe mosvlerësimi i kontributit vullnetar në Shqipëri (47%); mungesa enjohurive (45%); mosorientimi apo kërkesa (42%); pakënaqësia me organizimin. Megjithatë, studimi tregoi se ka ende perspektivë për punë vullnetare dhe se qytetarët duan të japin kontributin e tyre vullnetar në 12 muajt e ardhshëm (68%), ndonëse ata që preferojnë vullnetarizmin shprehin dëshirën për një periudhe relativisht të shkurtër kohore. Disa nga target grupet më të përzgjedhura për të cilat do të dëshironin të jepnit kontributin vullnetar, nga pjesëmarrësit në studim ishin banorët e komunitetit/lagjes, fëmijët dhe të rinjtë, minoritetet, persona në vështirësi ekonomike dhe të moshuarit.

Praktikat e menaxhimit dhe organizimit të vullnetarizmit nga institucione të ndryshme tregojnë se vullnetarizmi shihet si një aktivitet i cili nuk është i mirorganizuar apo i strukturuar sipas një modeli të caktuar. Mënyrat e angazhimit të vullnetarëve nga OSHC-të janë kryesisht me bazë projektesh apo forma spontane afatshkurtra të organizimit. Vullnetarizmi kryhet në mënyra sporadike dhe merr hov gjatë situatave të caktuara, siç është rasti i tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë, emergjencave natyrore. Megjithatë, përvoja me këto dy situata në vend tregoi që në përgjithësi ka interes për t'u përfshirë në punë vullnetare, edhe pse nuk ka orientim nga institucionet dhe angazhimi apo procedurat e rekrutimit apo organizmit mbeten krejtësisht *ad hoc*. Ndonëse këto procedura janë më strikte në rastin kur vullnetarët punojnë me target grupe sensitive, siç janë për shembull fëmijët, përveç rregulloreve të brendshme apo marrëveshje me anëtarët, OSHC-të nuk kanë mekanizma apo protokolle të tjerë të brendshëm rregullues.

Në tërësi, disa ndër **sfidat kryesore që institucionet** përballen janë: skepticizmi ndaj konceptit të vullnetarizmit, mungesa e kapaciteteve të organizatave për t'i mbajtur vullnetarët dhe për të krijuar sisteme të qëndrueshme të vullnetarizmit, në aspektin e promovimit dhe rritjes profesionale të individëve, mungesa e informacionit dhe ndërgjegjësimi i ulët mbi mundësitë e vullnetarizmit, koordinim jo fort i mirë me operatorët privatë apo bizneset për të përfshirë vullnetarët. Infrastruktura jo e duhur ligjore, strukturore dhe burokracia e institucioneve bëhet shpeshherë pengesë për organizatat joqeveritare, të cilat konstatojnë se ekziston në përgjithësi një klimë jofavorizuese dhe burokratike në lidhje me procedurat që duhet të ndiqen apo edhe me mungesë informacioni. Institucionet përgjegjëse për monitorimin e punës vullnetare, siç është Shërbimi Kombëtar i Punësimit nuk i ka kapacitetet e duhura

njerëzore dhe teknike për të monitoruar vullnetarizmin në terren. Nga ana tjetër, koordinim *ad hoc* dhe jo i qëndrueshëm i praktikave vullnetare është element tjetër pengues. Qëndrueshmëria financiare e OSHC-ve është një pengesë tjetër kryesore për qëndrueshmërinë dhe nxitjen e praktikave vullnetare.

Miratimi i Ligjit të Vullnetarizmit vlerësohet si një nismë e mirë, që duhet të ndihmonte dhe zhvillonte këtë sektor, por mënyra se si ligji u përgatit, mënyra se si u miratua dhe më pas zbatimi efektiv i ligjit në praktikë përballet me shumë sfida, dhe shpeshherë është një pengesë për nxitjen e vullnetarizmit në vend. Një ndër problemet kryesore që konstatohet nga pjesa dërrmuese e pjesëmarrësve në fokus grupe është dokumentimi i punës vullnetare, një eksperiencë që vlerësohet dhe njihet nga të gjitha institucionet. Duke qenë se praktika vullnetare nuk dokumentohet formalisht në Zyrat e Punësimit, ajo nuk njihet si praktikë pune në Librezën e Punës dhe, për rrjedhojë, nuk njihen dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Një pjesë e përfaqësueseve nga OSHC-të shprehen se pagesa e siguracioneve të vullnetarëve është një kosto tepër e lartë për t'u përballuar nga ata vetë dhe, për rrjedhojë, nuk i kanë ndjekur procedurat e regjistrimit të vullnetarëve. Pra, sfida kryesore mbetet krijimi i një strukture të qartë dhe të qëndrueshme që rekruton, orienton dhe menaxhon vullnetarët. Vullnetarizmi duhet të konsiderohet një aktivitet i paanshëm nga ndikimi i politikës dhe stereotipat që ajo mbart.

Pjesa dërmuese e te pyeturve dakortësohen me idenë që vullnetarizmi në Shqipëri duhet të nxitet, fuqizohet dhe promovohet (93%). Disa nga faktorët shtytës që rrisin qëndrueshmërinë e praktikave vullnetare dhe shërbejnë si faktor nxitës kanë të bëjnë me ofrimin e iniciativave dhe instrumenteve që rrisin motivimin te vullnetarët, të tilla si: mundësi punësimit pas punës vullnetare, përfshirje në aktivitete ndërkombëtare apo ndarja dhe promovimi i praktikave më të mira vullnetare te të rinjtë, iniciativa financiare. Vullnetarizmi i qëndrueshëm nxitet kur të vullnetarët kanë benefite të ndryshme, të të gjitha llojeve, duke filluar nga shkëmbimi i eksperiencave me grupe rinore, që rezultojnë të suksesshme në fushën e vullnetarizmi e deri në përfitime të trajnimeve e njohje me pikë vlerësuese për çdo aplikim që të rinjtë mund të bëjnë për një vend pune në të ardhmen.

Një sërë institucionesh perceptohen se mund të luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e vullnetarizmit, ndër të cilat rolin kryesor duhet ta luajnë organizatat e shoqërisë civile. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm, pasi perceptohen si ofruesit e shërbimeve në nivel vendor dhe pushteti më afër qytetarëve. Pushteti vendor perceptohet shpesh si një instrument si lehtësues/ koordinues, për shkak të veprimit të drejtpërdrejtë me qytetarët, OSHC-të apo shkollat në njësitë e vendore. Gjithashtu, institucionet arsimore perceptohen se kanë një rol tepër të rëndësishëm në nxitjen e vullnetarizmit përmes edukimit të brezave të rinj.

Rreth gjysma e të anketuarve (49%) pohojnë se pandemia COVID-19 ka pasur një rol negativ në sektorin e vullnetarizmit. Për këtë arsye, të anketuarit shprehen se gjatë pandemisë është rritur vullnetarizmi digjital. Pjesa më e madhe e të pyeturve, 73%, pohojnë se vullnetarizmi digjital është i nevojshëm/domosdoshëm në kohët që po jetojmë, duke e konsideruar atë si një alternativë të re për të ardhmen. Pjesëmarrësit në fokus grupe shprehen se një platformë kombëtare për menaxhimin dhe organizimin e praktikave vullnetare do të ishte një mjet efikas me shumë përfitime për vetë vullnetarët, por edhe për OSHC-të apo institucione të tjera që kanë nevojë për të rekrutuar vullnetarë.

Ndonëse në botë vullnetarizmi konsiderohet një përvojë tepër e rëndësishme në kurrikulën personale të çdo individi, në Shqipëri kjo eksperiencë nuk ka ende rëndësinë e duhur. Së pari, kjo vjen edhe për shkak të konotacionit negativ që mbart kjo fjalë dhe lidhjes së saj me të shkuarën komuniste, periudhë gjatë të cilës puna vullnetare ishte punë e detyruar pa kompensim. Ekziston, në përgjithësi, një perceptim dhe ndërgjegjësim i ulët për përfitimet e punës vullnetare. Për këtë arsye, një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve preferojnë që t'i përkufizojnë vullnetarët me termin "aktivistë". Së dyti, puna vullnetare është modeluar dhe formësuar përmes ndryshimeve politike, ekonomike dhe sociale që ka përjetuar vendi pas regjimit komunist. Së treti, vetë infrastruktura dhe mjedisi jo mundësues janë faktor pengues që nuk stimulojnë promovimin dhe nxitjen e aktivitetit vullnetar.

Studimi tregon se dëshira e qytetarëve për të bërë punë vullnetare nuk mungon, përkundrazi, pjesa dërrmuese e të pyeturve janë të gatshëm të kryejnë punë vullnetare në vitin në vijim, edhe pse janë të paorientuar në lidhje me mundësitë që ekzistojnë apo edhe institucionet që ofrojnë këto praktika. Po ashtu, studimi tregoi që, edhe pse ka praktika pozitive të menaxhimit të vullnetarëve në institucione, mungojnë tërësisht protokollet apo rregulloret e brendshme, çka bën që vullnetarët të shprehin skepticizën në lidhje me organizimin e këtyre praktikave. Mbi të gjitha, studimi tregoi që në ditët e sotme vullnetarizmi perceptohet si angazhim qytetar dhe lidhet me aktivizmin për përmirësimin e mirëqenies në komunitet. Për rrjedhojë, nevojitet më shumë vëmendje nga institucionet shtetërore për të krijuar një mjedis më mundësues dhe nxitës për praktikat vullnetare.

REKOMANDIME

Rekomandimet e sjella në këtë studim janë të grupuara sipas aktorëve kyçë, ashtu dhe për vullnetarët. Megjithatë, disa rekomandime gjejnë vend në më shumë se një grup apo ndoshta në të gjitha, disa janë të ndërthurura, pasi bashkëpunimi ndërsektorial është kyç për inkurajimin dhe nxitjen e vullnetarizmit në vend.

Për politikëbërësit në nivel qendror dhe vendor

- Institucionet duhet të adresojnë dhe nxisin vullnetarizmin në strategjitë e tyre, planet e veprimit apo dokumentet politikë. Krijimi i një politike të qëndrueshme do të krijonte një standard, i cili inkurajon politikat e vullnetarizmit.
- Rishikimi i ligjit mbi vullnetarizmin, me qëllim implementimin e tij në praktikë në mënyrë eficiente dhe për t'u bërë më fleksibël me qëllim adresimin e nevojave të vullnetarëve dhe institucioneve. Rekomandohet specifikisht:
  - Hartimi i akteve nënligjore që rregullojnë vullnetarizmin përmes një procesi konsultues gjithëpërfshirës dhe transparent.
  - Ngritja dhe ndarja e qartë e funksioneve dhe mekanizmave të duhur për ta realizuar këtë shërbim.
  - Rishikimi i dispozitave në lidhje me pjesën e pagimit të sigurimeve shoqërore/shëndetësore, me qëllim që kjo pagesë të jetë sa më modeste për organizatat dhe në bazë të qëndrueshmërisë së tyre financiare. Kostoja duhet të llogaritet të jetë minimale, por me një bazë analize të qartë.
  - Të krijohet mundësia që vullnetarët të kenë një status të zyrtarizuar të vullnetarit, nëpërmjet njohjes së praktikave të vullnetarizmit.
  - Përcaktimi i përgjegjësive, detyrave dhe linjës së komunikimit dhe koordinimit për menaxhimin e vullnetarizmit në nivel qendror.
  - Ligji duhet të përjashtojë kategori të caktuara nga pagesa e detyrimeve për kontribute shëndetësore/shoqërore , p.sh., të punësuarit apo pensionistët vullnetarë.
- Ngritja e një grupi pune shumaktorialësh, i cili do të shërbejë si një mekanizëm/ organ ndërinstitucional për mbledhjen dhe shkëmbim të rregullt të informacionit në lidhje me çështjen e vullnetarëve apo regjistrimit të tyre (duke përfshirë database, të dhënat mbi vullnetarët, etj). Anëtarët e grupit të punës duhet të përfshijnë përfaqësues nga OSHC-të, institucionet në nivel qendror, vendor, institucionet e varësisë dhe aktorë të shoqërisë civile e vullnetarë.

- Sugjerohet që Ministria e Financave të listojë vullnetarët si një kategori e veçantë në listëpagesa, në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i tyre të bëhet me referencë me pagën minimale.
- Sistemi i tatimeve duhet të krijojë një kategorizim për vullnetarët, në mënyrë që ata që derdhin sigurimet shoqërore/shëndetësore si vullnetarë të mos penalizohen dhe të mos humbin të drejtën për benefite të tjera si kredi të buta apo asistencë sociale për shkak se figurojnë të siguruar në sistem.
- Krijimi i mundësive për trajnime profesionale për menaxhimin e vullnetarëve apo në lidhje me trajnime për formate të strukturuara dhe formatizuara për sa i përket vullnetarizmit në qendrat komunitare apo institucionet lokale.
- Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe financiare të institucioneve përgjegjëse për monitorimin e vullnetarizmit, siç është Shërbimi Kombëtare i Punësimit.
- Të promovohet sa më shumë statusi dhe qëndrueshmëria e vullnetarizmit në qeverisjen lokale. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të luajnë një rol më proaktiv në nxitjen dhe promovimin e praktikave vullnetare. Bashkitë duhet të hartojnë ose nxisin politikat që promovojnë vullnetarizmin, duke bërë pjesë të planeve strategjike, planeve vendore rinore apo politikave të këshillave rinor vendorë.
- Rritja e nivelit të motivimit të vullnetarëve përmes krijimit të iniciativave të ndryshme, të cilat stimulojnë dhe ndërgjegjësojnë të rinjtë për t'u bërë pjesë e punës vullnetare: iniciativa të tilla si kthimi i orëve/ praktikave vullnetare në kredite, iniciativa dhe stimuj financiarë,
- Bashkëpunimi më i hapur dhe më produktiv me aktorët kyçë, ofrues të vullnetarizmit: OSHC-ve, shkollat, institucionet arsimore, medias dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të jetë më i qëndrueshëm dhe më sistematik. Duhet të krijohet një mekanizëm koordinimi ndërinstitucional.
- Krijimi i Regjistrit Kombëtar të Vullnetarizmit, i cili përmban në mënyrë të mirorganizuar dhe strukturuar databazën e vullnetarëve, përfshirë të dhëna mbi gjeneralitetin e vullnetarëve, përvojën vullnetare dhe institucionin. Databaza të ofrojë të dhëna mbi temat apo çështjet ku vullnetarët janë të gatshëm të kontribuojnë. Njëkohësisht, rekomandohet që kjo databazë të përditësohet vazhdimisht dhe/ose të menaxhohet nga njësitë përkatëse pranë bashkive, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në nxitjen e vullnetarizmit dhe promovimin e politikave për rininë apo mbrojtjen sociale. Ky databazë duhet të jetë i aksesueshëm dhe interaktiv nga të gjitha organizatat.
- Njohja e vlerave, impaktit dhe nevojës për kontribut vullnetar.
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i institucioneve për mënyrat e menaxhimit dhe organizimit të praktikave vullnetare do të krijonte më shumë gjasa për një vullnetarizëm më të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Promovimi i konceptit te qytetarisë aktive dhe kohezionit social dhe lidhja direkte që ka me vullnetarizmin.

- Nevojitet një ndërgjegjësim më i madh i opinionit publik në lidhje me benefitet e vullnetarizmit dhe nevojën për infrastrukturë të përshtatshme dhe praktike në ushtrimin e vullnetarizmit. Vullnetarizmi duhet të perceptohet si një aktivitet gjithëpërfshirës dhe, për rrjedhojë, të targetojë njerëz të moshave, etnive apo gjinive të ndryshme, të cilët punojnë në dobi të të mirës së përbashkët.
- Të rriten kapacitetet e burimeve njerëzore, për të kuptuar impaktin e vullnetarizmit dhe nxitur atë në praktikë, duke qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme, vizitave studimore, ndarjes së praktikave me vende të tjera etj.
- Të krijohen sisteme të qëndrueshme të promovimit dhe vlerësimit të vullnetarëve në bazë të kontributit, angazhimit dhe performancës që japin.

Shoqëria civile

- Shoqëria civile duhet të lobojë pranë institucioneve për të njohur, nxitur dhe përmirësuar infrastrukturën e vullnetarizmin në Shqipëri.
- Lançimi dhe koordinimi efektiv i një platforme multifunksionale dhe dinamike për menaxhimin dhe koordinimin e vullnetarëve. Platforma do t'i jepte kujtdo që dëshiron të vullnetarizojë, të ketë mundësi zgjedhje midis organizatave të nivelit lokal ose kombëtar dhe fushën e interesit. Platforma duhet, gjithashtu, të adresojë format e riskut, të bëjë një filtrim të vullnetarëve, ashtu dhe të ofruesve të vullnetarizmit.
- Të nxisë dhe të koordinojë ngritjen e grupeve të punës dhe bashkëpunimit për përmirësimin e rregullimeve ligjore dhe institucionale të vullnetarizmit.
- Të rriten kapacitetet e sektorit në standardizimin e politikave dhe procedurave të rekrutimit, menaxhimit dhe fuqizimit të vullnetarëve.
- Nxitja e bashkëpunimeve më të mira dhe të qëndrushme mes sektorit të shoqërisë civile, institucioneve vendore e qendrore, medias, komunitetit, biznesit privat dhe individëve.
- Ngritja dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve/ OSHC-ve që menaxhojnë dhe koordinojnë praktikat vullnetare në lidhje me menaxhimin e riskut në raste të aksidenteve nga vullnetarët.
- Rekomandohen më shumë studime të thelluara në fushën e vullnetarizmit për të kuptuar në mënyrë të thelluar impaktin social dhe ekonomik.
- Rritje e ndërgjegjësimit në nivel kombëtar, duke targetuar individët dhe institucionet rreth rëndësisë së vullnetarizmit, përfitimeve, mundësive konkrete.
- Rekomandohet ngritja e kauzave relevante dhe vazhdimësia në qëndrueshmëria e kauzave të ngritura, si dhe ndikimi për të lidhur më shumë individin me komunitetin dhe kontributin e vullnetarëve në zhvillim komunitar, zhvillim shoqëror dhe solidaritet.

- Te lobohet me donatorët për të pasur një përqasje të fokusuar në vullnetarizëm, si dhe njohjen e kostove të vullnetarizmit të buxhetohen dhe njihen si kosto në projekte të ndryshme.

Media

- Rritja e ndërgjegjësimit të përfaqësuesve të medias rreth vullnetarizmit dhe impaktit të tij, veçanërisht rolit shumë të rëndësishëm që media luan në promovimin e kauzave.
- Rritja e kapaciteteve të përfaqësuesve të medias për të trajtuar me profesionalizëm çështjet e vullnetarizmit, për të promovuar në mënyrë shumëdimensionale nxitjen e vullnetarizmit vulkenrzmit si te qytetarët, te ofruesit e vullnetarizmit, ashtu dhe tek institucionet politikëbërese.
- Media duhet t'i japë më shumë hapësirë vullnetarizmit në tërësi, të sjellë më shumë të dhëna dhe të promovojë modelet pozitive të individëve, grupeve apo institucioneve.

Institucione arsimore

- Zhvillimi i aktiviteteve ekstrakurrikulare nëpër shkolla dhe universitete, të cilat rrisin mundësinë e angazhimit në praktika vullnetare përmes njohjes së krediteve apo stimujve të tjerë, që nxisin dhe promovojnë rëndësinë e vullnetarizmit. Nxitja nëpërmjet edukimit formal, joformal dhe eksperiencave të punës synon të nxisë një vullnetarizëm të qëndrueshëm.
- Promovimi dhe nxitja e rol-modeleve pozitive. Promovimi i të rinjve që kanë dhënë një kontribut, i cili ka pasur impakt në komunitet, do të krijonte gjasa për nxitjen e punës vullnetare te grupet rinore.
- Praktikat e punës vullnetare duhet të njihen si shërbim në nivel kombëtar dhe vullnetarëve t'u paguhen sigurimet shëndetësore bazuar në një numër të caktuar orësh.
- Realizimi i fushatave të ndryshme, advokimi në shkolla, në lidhje me mundësitë që kanë të rinjtë për të bërë punë vullnetare dhe benefitet e vullnetarizmit. Shkolla është institucion shumë i rëndësishëm për të promovuar vullnetarizmin.
- Institucionet arsimore, si universitetet, duhet t'i japin rëndësi vullnetarizmit, duke lidhur marrëveshje mirëkuptimi me organizatat, për t'i stimuluar studentët të bëjnë vullnetarizëm.
- Orët e qytetarisë të bëhen më praktike dhe të tregohen eksperienca të mirëfillta vullnetare të njerëzve që kanë lënë një impakt në komunitet.

REFERENCAT

Bino, B. Xhaferaj,O., Lula, L. **(2020).** ROLI I SHOQËRISË CIVILE DHE MEDIAS NË MENAXHIMIN E KRIZAVE NË SHQIPËRI: Tërmeti shkatërrimtar i 26 nëntorit

2019 dhe pandemia COVID-19. Tiranë: *Fondacionin Westminster për Demokraci.*

Dhëmbo, E., Duci, V., Ajdini, J. (2015). "Why do I have to trust you?" The perspective from civil society on active citizenship in post–communist Albania. CIRR XXI. Vol 3, Nr.66 (73) 2015, 131-154. DOI 10.1515/cirr-2015-0014

Çeku, H. (2013). Analizë vullnetarizëm për zhvillim Zhvillimi i kornizës ligjore për njohjen dhe promovimin e vullnetarizmit në Kosovë. CiviKos: Kosova

EEAS. (2011). 2011Viti evropian i Vullnetarizmit. Vullnetarizmi kontribuon për një shoqëri më të mirë https://eeas.europa.eu/archives/delegations/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/documents/more_info/volunteering_sq.pdf

https://www.balkanweb.com/vullnetarizmi-ne-shqiperi-kuvendi-i-jep-ok-nismes-sedeputeteve-mehmetaj-e-caka/

Meyer,M., Moder, C.M. neumayr,M., Traxler,n., vandor, P.(2016). Patterns in Civil Society in Central and Eastern Europe: A Synthesis of 16 Country Reports and an Expert Survey. In vandor, P., Traxler, n., Reinhard Millner and Meyer, M. (eds). Civil Society in Central and Eastern Europe: Challenges and Opportunities. ERSTE Foundation: Vienna.

Partnerët Shqipëri (2019b). Matrica e Monitorimit mbi mjedisin mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile. Raporti për Shqipërinë Maj 2018-Maj 2019. Tiranë: Partnerët Shqipëri

Rama, O. dhe Xhaho, A.(2020). Vullnetarizmi dhe të rinjtë: Perceptimet dhe përvojat mbi kontributin vullnetar në Shqipëri. Studim Kombëtar. Impakt: Tirana.

State of the World's voluntarism report, United Nations Volunteers (UNV) 2011

REC- Qendra Rajonale e Mjedisit. Mjedisi prioriteti i heshtur. Vullnetarizmi mjedisor dhe sfidat e tij në Shqipëri. Nr. 148| 2015Botim periodik i Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) - Shqipëri

Qendra Rinore , 2015. Aksesuar më 14 Shkurt 2020 nga http://tiranarinore.gov.al/tag/rini/

Qendra Burimore. 2020. Aksesuar më 14 Shkurt 2020 nga https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2020/08/Mbi-Vullnetarizmin_AL-.pdf

EC. 2019. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf

UN Volunteers. 2007. Volunteers count. Their ëork deserves to be counted. ILO Department of Statistics.

https://www.unv.org/swvr/volunteers-count-their-work-deserves-be-counted#:~:text=Global%20estimates%20place%20the%20number%20of%20volunteers%20worldwide%20at%20970%20million.&text=In%20terms%20of%20economic%20impact,of%20the%20entire%20global%20economy.

https://www.balkanweb.com/vullnetarizmi-ne-shqiperi-kuvendi-i-jep-ok-nismes-sedeputeteve-mehmetaj-e-caka/

Social Impact of Volunteerism, Points of Light Institute 2011/8/30

The Johns Hopkins University Center for Civil Society Studies (ÇSS), "ILO Manual on the Measurement of Volunteer Work", 2011;

http://www.cev.be/113-economic_value_of_volunteering-en.html

Eleanor Brown, "Assessing the Value of Volunteer Activity", 1999; http://nvs.sagepub.com/content/28/1/3.full.pdf

Corporation for National and Community Service, "Research Brief: Volunteering in America Research Highlights", 2010; http://www.volunteeringinamerica.gov/assets/resources/IssueBriefFINALJune14.pdf

Nick Ockenden, "Volunteering works -- Volunteering and social policy", 2007; http://www.ivr.org.uk/NR/rdonlyres/2918E900-A0Ç-4483-ADC3- 02D6AB52C422/0/Final_Volunteering_Works.pdf

National Report – Ireland http://ec.europa.eu/citizenship/eyv2011/doc/National%20report%20IE.pdf Donoghue, F. (2001) 'Changing Patterns of Civic Engagement and Community Ties in Ireland',

Peter Mayer, "The Wider Economic Value of Social Capital and Volunteering in South Australia", 2003; http://www.ofv.sa.gov.au/pdfs/mayer_report.pdf

SHTOJCA

Shtojca 1: Pyetësori

PYETËSOR : PERCEPTIMI I QYTETARËVE MBI VULLNETARIZMIN NË SHQIPËRI

Ky pyetësor realizohet në kuadër të Projektit "**VullnetarizmiPikëAL**", i cili ka si qëllim krijimin e një mjedisi mundësues shumëdimensional, ku vullnetarizmi inkurajohet, mbështetet, njihet si mekanizëm kyç për nxitjen e qytetarisë aktive, solidaritetit dhe kohezionit social në Shqipëri. Ky projekt zbatohet nga organizata "Përtej Barrierave", organizata "Projekte Vullnetare Ndërkombëtare" dhe Qendra "Progres dhe Zhvillim", me mbështetjen financiare të "LëvizAlbania", një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

Studimi kombëtar synon të kuptojë perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve mbi vullnetarizmin, arsyet kryesore që i motivojnë apo pengojnë në ofrimin e shërbimeve vullnetare, si dhe të kuptojë se cilat janë mundësitë dhe tendencat rreth shërbimeve vullnetare në të ardhmen. Të dhënat e mbledhura do të na shërbejnë për të ndërmarrë hapa konkretë drejt një vullnetarizmi më cilësor dhe të organizuar.

Pyetësori është përgatitur për çdo qytetar mbi 18 vjeç, që ka ose jo eksperiencë vullnetare. Pyetësori përmban vetëm pyetje me alternativa dhe merr maksimumi 10 minuta kohë. Ju lutemi, jepni përgjigjet tuaja sa më të sinqerta, të cilat ndihmojnë që studimi të sjellë të dhëna objektive.

Ju garantojmë se të gjitha të dhënat janë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për efekt të këtij studimi.

Ju faleminderit paraprakisht për kontributin tuaj!

I. TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

1. Mosha:

a. 18 – 29 vjeç
b. 30 - 45 vjeç
c. 46 - 65 vjeç
d. Mbi 65 vjeç

2. Arsimi

a. Arsimi fillor
b. Arsimi 8/9-të vjeçar
c. Arsimi i mesëm
d. Arsimi i lartë
e. Studime pasuniversitare

4. Qarku/qyteti:

5.Gjinia:

a. Mashkull
b. Femër
c. Tjetër (specifiko)

5. Profesioni Aktual:

a. Student
b. I papunë
c. I vetëpunësuar
d. I punësuar në sektorin publik
e. I punësuar në sektorin e OSHC-ve
f. I punësuar në sektorin privat
g. Pensionist
h. Tjetër

II.NJOHURITË E PËRGJITHSHME DHE PERCEPTIMET

1. Në një shkallë nga 1- 5 (1-Aspak dakord - 5 plotësisht dakord) deri në çfarë mase pajtoheni me qëndrimet e mëposhtme në lidhje me kontributin vullnetar?

a. Vullnetarizmi sjell përfitime për vullnetarët dhe komunitetin;
b. Vullnetarizëm do të thotë të ndihmosh të tjerët;
c. Vullnetarizmi nënkupton angazhimin qytetar në dobi të komunitetit;
d. Vullnetarizëm do të thotë angazhim me vullnet të lirë;
e. Vullnetarizmi nxit ndjenjën e solidaritetit në komunitet;
f. Kontributi vullnetar krijon mundësi për rrjetëzim, përmes përvojave të reja dhe njohjeve me njerëz të rinj;
g. Vullnetarizmi krijon perspektiva për zhvillim të aftësive ndërpersonale;
h. Kontributi vullnetar ndikon në përmirësimin e shëndetit emocional dhe psikologjik personal;
i. Vullnetarizmi krijon mundësi për zhvillim profesional dhe krijon më shumë mundësi për t'u integruar në tregun e punës në të ardhmen;
j. Vullnetarizmi krijon mundësi për argëtim, udhëtime dhe shkëmbim kulturor;
k. Vullnetarizmi në Shqipëri nuk ekziston;

l. Vullnetarizmi në Shqipëri mund të bëhet vetëm kur ke plotësuar të gjitha nevojat ekonomike personale;
m. Është punë e papaguar;
n. Tjetër.

2. A keni informacion se ku mund të drejtoheni në rast se doni të jepni kontributin tuaj vullnetar?

a. Po
b. Jo

3. Në rast se dini ku të drejtoheni për të dhënë kontributin tuaj vullnetar, ku e gjeni këtë informacion? Ju lutem, zgjidhni deri në 3 alternativa:

a. Në Organizata të shoqërisë civile
b. Në bashkinë/njësinë tuaj administrative
c. Në qendrat qinore
d. Në median kombëtare apo lokale
e. Në median sociale
f. Nëpërmjet kontakteve shoqërore apo familjare
g. Tjetër_____

4. Sipas këndvështrimit dhe informacioneve tuaja, cilët janë sektorët që ofrojnë mundësi vullnetarizmi në Shqipëri? Ju lutem, zgjidhni deri në 3 alternativa:

1. Organizatat e shoqërisë civile
2. Institucionet arsimore (shkollat, universitetet)
3. Sektori i shëndetësisë (spitalet, qendrat shëndetësore)
4. Institucionet publike në nivel qendror (ministritë)
5. Institucionet publike në nivel vendor (bashkitë/njësitë administrative)
6. Qendrat rinore/sociale/komunitare/multidisiplinare
7. Institucion të kujdesit ditor apo rezidencial (shtëpitë e të moshuarve, shtëpitë e fëmijëve)
8. Tjetër_____

5. Në opinionin tuaj, a është i nevojshëm kontributi vullnetar në Shqipëri? Ju lutem, zgjidhni vetëm një alternativë.

a. Shumë i nevojshëm
b. I nevojshëm
c. Aspak i nevojshëm

6. Sipas këndvështrimit tuaj, si ndikon vullnetarizmi tek INDIVIDI/VULLNETARI ? (1 aspak dakord - 5 plotësisht dakord) Vullnetarizmi ndihmon në:

a. Rritje personale, njohjen më të mirë të vetvetes dhe vetëpërmbushje;
b. Përmirësimin e shëndetit psikologjik, mendor;
c. Përmirësimin e aftësive të të komunikuarit;
d. Nxit të menduarin kritik;
e. Përfitimin e eksperiencave dhe aftësive praktike;
f. Integrimin më të shpejtë në tregun e punës/rrit mundësitë për punësim;
g. Rritjen e socializimit, krijimin e kontakteve me njerëz të rinj;
h. Rritjen e vetëbesimit (të ndjerit i/e vlerësuar, i dobishëm për punën e bërë).

7. Në këndvështrimin tuaj, cili është ndikimi i vullnetarizmit në SHOQËRI? Ju lutem, vlerësoni nga 1= aspak dakord në 5= plotësisht dakord.

- Vullnetarizmi nxit solidaritetin dhe kohezionin social;
- Vullnetarizmi fuqizon grupet në nevojë;
- Vullnetarizmi përmirëson jetën në komunitet;
- Vullnetarizmi sjell ndryshime pozitive në çdo institucion;
- Vullnetarizmi ndikon në rritjen ekonomike në vend;
- Tjetër _____

8. A jeni në dijeni për Librezën e Vullnetarit?

a. Po
b. Jo

9. A keni ju informacion rreth Ligjit të Vullnetarizmit? Ju lutem, zgjidhni vetëm një alternativë.

a. Po, kam shumë informacion.
b. Kam informacion, por dua të di me shumë.
c. Jo, nuk kam informacion.

III. EKSPERIENCAT, SFIDAT DHE MUNDËSITË/PREFERENCAT PËR KONTRIBUT VULLNETAR NË TË ARDHMEN

10. A keni ju eksperienca vullnetare?

a. Po
b. Jo...kalo tek pyetja 14

11. Në përgjithësi, a jeni i/e kënaqur me përvojën tuaj vullnetare? Ju lutem, zgjidhni vetëm një alternativë.

a. Shumë i/e kënaqur
b. I/e kënaqur
c. Jo i/e kënaqur
d. I/e zhgënjyer

12. Në rast se keni pasur eksperienca vullnetare, ku i keni pasur ato? Ju lutem, zgjidhni deri në 3 alternativa.

a. Komunitetin tuaj
b. Shkollë/Universitet
c. Organizata të Shoqërisë Civile
d. Bashki/Njësi administrative
e. Institucione qendrore (Ministri)
f. Tjetër

13. Sa ju ka ndihmuar eksperienca juaj vullnetare? Në një shkallë nga 1-aspak dakord në 5-plotësisht dakord, për secilin pohim:

a. Më ka ndihmuar për të përmirësuar aftësitë në komunikim dhe prezantim
b. Më ka ndihmuar për të rritur aftësitë bashkëpunuese dhe ndërvepruese
c. Më ka ndihmuar për të zhvilluar aftësitë e mendimit kritik
d. Rritjen e socializimit, krijimin e kontakteve me njerëz të rinj;
e. Përmirësimin e shëndetit psikologjik, mendor;
f. Kam njohur më shumë veten time dhe kam reflektuar;
g. Jam bërë person më i/e mirë;
h. Kam mësuar si t'i menaxhoj emocionet e mia;
i. Jam bërë më i/e lumtur dhe i/e pavarur;
j. Jam bërë më mendjehapur dhe më tolerant/e;
k. Jam bërë më empatik/e;
l. Kam njohur më mirë problematikat dhe mundësitë e komunitetit /shoqërisë
m. Më ka ndihmuar në tregun e punës (për të reflektuar, përgatitur, si dhe për të gjetur një punë)
n. Më ka ndihmuar për studimet e mia;
o. Nuk më ka ndihmuar aspak;
p. Askush nuk më ka pyetur/ nuk është interesuar për përvojat e mija vullnetare;

14. Në rast se nuk keni eksperienca vullnetare, ju lutem, vlerësoni disa nga arsyet/ pohimet e mëposhtme, 1-aspak dakord dhe 5-plotësisht dakord:

a. Nuk kam informacion se ku dhe si mund të jap kontributin tim vullnetar;
b. Nuk kam pasur kohë;
c. Nuk kam dashur të kem një angazhim të vazhdueshëm;
d. Nuk më ka tërhequr asnjëherë;
e. E konsideroj humbje kohe;
f. Asnjëherë nuk më kanë ftuar/ ofruar të jem vullnetar;
g. Nuk e kam menduar asnjëherë;
h. Nevoja për të bërë punë që paguhet;
i. Sepse kontributi vullnetar në Shqipëri nuk njihet dhe nuk vlerësohet;
j. Mungesa e rregulloreve mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e vullnetarëve;
k. Nuk ndihem i/e kënaqur me mënyrën se si puna vullnetare është menaxhuar/ organizuar.

15. A do të donit të jepni kontributin tuaj vullnetar në 12 muajt e ardhshëm ?

a. Po
b. Jo
c. Nuk jam i/e sigurt

16.Cilat janë disa nga target grupet për të cilat ju do të dëshironit të jepnit kontributin tuaj vullnetar? Ju lutem, zgjidhni deri ne 3 alternativa.

a. Tek banorët e komunitetin tim/lagjes sime
b. Fëmijët dhe të rinjtë
c. Minoritetet
d. Persona në vështirësi ekonomike
e. Persona me nevoja të veçanta
f. Emigrantë, refugjatë dhe azilkërkues
g. Të moshuarit
h. Tjetër_____

17.Cilat janë fushat ku ju do të preferonit të jepnit kontributin tuaj vullnetar? Ju lutem, zgjidhni më shumë se një alternativë.

a. Fuqizimi i të rinjve
b. Të drejtat e njeriut
c. Demokracia
d. Promovimi i vullnetarizmit

e. Gjithëpërfshirja dhe mbështetja e grupeve në nevojë
f. Bashkëpunimi rajonal
g. Arti dhe krijimtaria
h. Aktivitetet sportive
i. Aktivitetet fetare
j. Mjedisi dhe ndryshimet klimaterike
k. Politika
l. Edukimi
m. Shëndetësia/aftësi të kufizuara
n. Bamirësia
o. Raste emergjencash
p. Tjetër ____

18. Cilat janë disa nga opsionet ku do të preferoni të jepnit kontributin tuaj vullnetar?

a. Në lagjen time/komunitet
b. Në shkolla
c. Në universitete
d. Në qendra rinore apo sociale
e. Në shtëpitë e të moshuarve
f. Në qendra rezidenciale apo ditore për grupe në nevojë
g. Në organizata e shoqërisë civile
h. Në spitale apo qendra shëndetësore
i. Në institucione shtetërore lokale
j. Në institucione shtetërore qendrore
k. Përmes internetit (vullnetarizëm digjital)
l. Tjetër _____

19. Cila është periudha kohore gjatë së cilës ju do të preferonit të angazhoheshit vullnetarisht.

a. Deri në 1 muaj
b. 1-3 muaj
c. 3-6 muaj
d. Më shumë se 6 muaj
e. Tjetër _____

IV. PERSPEKTIVAT DHE NXITJA E VULLNETARIZMIT

20. A ka nevojë që vullnetarizmi të nxitet, fuqizohet dhe promovohet në Shqipëri?

a. Po
b. Jo
c. Nuk e di.

21. Kush mendoni se ka më shumë përgjegjësi dhe rol në nxitjen dhe ushtrimin e vullnetarizmit në vend? Ju lutem, zgjidhni vetëm një alternativë.

a. Individi
b. Organizatat e shoqërisë civile
c. Institucionet qendrore (ministritë)
d. Pushteti vendor (bashkitë/komunat)
e. Media

22. Si mund të **motivohen qytetarët** për të bërë punë vullnetare? Jepni përgjigjen tuaj:
_____

23.Cilat do të ishin mënyrat më të mira për të promovuar vullnetarizmin në Shqipëri? (1 aspak dakord- 5 plotësisht dakord)

a. Platformat online dhe faqe interneti;
b. Rrjetet sociale (facebook, twitter, linked-in)
c. E-mail;
d. Media lokale apo kombëtare;
e. Takimet informuese ballë për ballë (informimi personal)
f. Qendrat rinore
g. Broshura apo materiale të tjera informuese
h. Bordet/këshillat e studentëve apo grupe të tjera informale
i. Tjetër_____

24. Mendoni se vullnetarizmi digjital është i nevojshëm/domosdoshëm në kohët që po jetojmë?

a. Po
b. Jo
c. Nuk e di

25. Nëse do të krijohet një bazë të dhënash/platformë për vullnetarët, cilin informacion do të ishit të interesuar të përmbante? (1 aspak dakord- 5 plotësisht dakord)

a. Informacion mbi mundësitë për vullnetarizëm;

b. Informacion mbi vullnetarët potencialë/të interesuar;

c. Informacion mbi vullnetarët (një biografi e shkurtër e CV-së tyre);

d. Institucionet që kërkojnë vullnetarë, duke përfshirë programin e detajuar të aktiviteteve;

e. Tjetër

26. Çfarë roli mendoni se ka pasur pandemia COVID-19 në sektorin e vullnetarizmit?

a. Ka pasur rol pozitiv, është rritur interesi për vullnetarizëm.

b. Ka pasur rol negativ, ka limituar angazhimin vullnetar.

c. Gjatë pandemisë është rritur vullnetarizmi digjital;

d. Tjetër.

27. A e shihni ju vullnetarizmin digjital (angazhimin vullnetar nga interneti) si një alternativë të re për të ardhmen?

a. Po, sepse zhvillimet digjitale po përparojnë gjithnjë e më shumë.

b. Jo, sepse vullnetarizmi bëhet në komunitet dhe me target grupe specifike.

c. Nuk e di.

d. Nuk e di çfarë është vullnetarizmi digjital.

d. Tjetër (shkruani mendimin tuaj) _____

28. Në rast se keni çështje shtesë dhe sugjerime ne lidhje me vullnetarizmin në Shqipëri, ju lutem, i adresoni këtu.

Shtojca 2: Fokus grupet

Qëllimi i fokus grupeve është të kuptojë dhe të analizojë praktikat, sfidat dhe mundësitë e ofruesve të vullnetarizmit në Shqipëri. Do të organizohen rreth 12 fokus grupe, duke përfshirë aktorë potencialë të ndryshëm të shoqërisë nga 12 qarqe të Shqipërisë. Fokus grupet do të realizohen veçanërisht për përfaqësues të bashkive, shoqërisë civile, shkollat, universitetet, media etj.

Duke përfshirë aktorë të ndryshëm, ne synojmë të kuptojmë se cilët janë sektorët, tematikat, kohëzgjatja, trendet e shërbimeve vullnetare.

Studimi kombëtar realizohet në kuadër të Projektit "**VullnetarizmiPikëAL**", i cili ka si qëllim krijimin e një mjedisi mundësues shumëdimensional, ku vullnetarizmi inkurajohet, mbështetet, njihet si mekanizëm kyç për nxitjen e qytetarisë aktive, solidaritetit dhe kohezionit social në Shqipëri. Studimi kombëtar ka ngritur 3 instrumente bazë në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave: Intervistat (me institucionet qendrore), Fokus grupet (institucione qendrore, vendore, aktorë kyçë në ofrimin e vullnetarizmit) dhe Pyetësor (për qytetarët mbi 15 vjeç). Ky projekt zbatohet nga organizata "Përtej Barrierave" në bashkëpunim me "Projekte Vullnetare Ndërkombëtare" dhe Qendra "Progres dhe Zhvillim", me mbështetjen financiare të "LëvizAlbania", një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

Ju garantojmë se të gjitha të dhënat janë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për efekt të studimit.

Ju faleminderit paraprakisht për kontributin tuaj!

1. PERCEPTIMET DHE NJOHURITË

Çfarë do të thotë për ju vullnetarizëm?

Si mendoni që kanë ndryshuar shërbimi vullnetar gjatë këtyre viteve të fundit?

Cilat janë grupmoshat që përfshihen më shumë në shërbime vullnetare dhe pse?

Cilat janë arsyet që nuk përfshihen grupet e tjera në shërbime vullnetare?

Cilat janë disa nga sfidat që hasin vullnetarët në Shqipëri?

Cilat janë sfidat që hasin aktorët/ofruesit e vullnetarizmit në Shqipëri?

2. PËRVOJAT: MENAXHIMI I VULLNETARËVE NË INSTITUCIONIN TUAJ

A ka pasur institucioni juaj vullnetar?

- ❑ Po
- ❑ Jo
- ❑ Nuk e di

A keni mekanizma të brendshëm rregullues p.sh., ndonjë strukturë, departament apo program më vete; A keni rregullore të brendshme apo rregulla për organizmin e vullnetarëve? Kontrata me vullnetarët?

- ❑ Po
- ❑ Jo
- ❑ Nuk e di

Nëse po, çfarë rregulloresh keni?

- ➢ Cilat janë vështirësitë për përfshirjen e vullnetarëve në projektet dhe aktivitetet tuaja?
- ➢ Çfarë roli kanë pasur vullnetarët, çfarë detyrash/aktivitetesh?
- ➢ Si janë rekrutuar, mbështetur dhe menaxhuar vullnetarët në institucionin tuaj?
- ➢ Çfarë impakti kanë lënë në institucionin?
- ➢ Nëse nuk keni pasur vullnetar, cilat janë disa nga arsyet?

3. PERSPKTIVAT E SË ARDHMES NË INSTITUCIONIN TUAJ

- ➢ A keni interes dhe nevojë për vullnetarë?
  1. Po
  2. Jo
  3. Ndoshta
  4. Nuk e di
- ➢ Në cilat fusha? Çfarë programesh? Cilat profile?
- ➢ A ka institucioni juaj kapacitete për t'i rekrutuar, mbështetur, orientuar dhe menaxhuar vullnetarët. Nëse po, si, dhe nëse jo, si mund të rregullohet kjo pjesë?
- ➢ Si mund të informohen vullnetarët për mundësitë ekzistuese dhe si të jenë në kontakt me institucionin për të kontribuar vullnetarisht, dhe kush dotë ishte personi/ personat më të përshtatshëm për të menaxhuar vullnetarët?
- ➢ Sa gjatë do të ishte efektive që institucionet të kenë vullnetar?
- ➢ Çfarë impakti mund të kenë vullnetarët në institucion?

4. PERSPKTIVAT E SË ARDHMES NË SHOQËRI

- ➢ A duhet të krijohen programe të nxitjes së vullnetarizmit? Si mund të nxitet vullnetarizmi?

Si mund të përmirësohet **qasja e institucioneve** në programet e nxitjes së vullnetarizmit?

Si mund të përmirësohet **qasja e qytetarëve** në programet e nxitjes së vullnetarizmit?

- ➢ Cilat janë format e vullnetarizmit që duhen nxitur në vendin tonë? Dhe si?
- ➢ Cilët sektorë apo fusha kanë nevojë më shumë për kontributin e vullnetarëve në Shqipëri?

- ➢ Cilët janë dhe çfarë mund të bëjnë aktorët kryesorë në përmirësimin dhe nxitjen ë vullnetarizmit në Shqipëri?
- ➢ Çfarë mund të bëjë institucioni juaj konkretisht?

4.1 A duhet të përmirësohet informacioni/ndërgjegjësimi i shoqërisë mbi vullnetarizmin? Si? Jepni disa rekomandime?

5. A KENI NJOHURI MBI LIGJIN E VULLNETARIZMIT?

- ❑ Po
- ❑ Jo
- ❑ Kam dëgjuar, por nuk kam shumë informacion

5.1 Çfarë mund të përmirësohet në të?

- Ligji dhe aktet nënligjore
- Kodi i etikës
- Libreza e vullnetarit

Për çfarë mendoni se do të shërbejë Libreza e vullnetarit?

6. PANDEMIA DHE VULLNETARIZMI

- Si ndikojë pandemia në aktivitetet tuaja vullnetare?

7. VULLNETARIZMI DIGJITAL

- A është i nevojshëm vullnetarizmi digjital?
- Cilat janë disa nga nevojat?
- Cilat mund të jenë disa nga mënyrat e nxitjes?

9. CILAT MUND TË JENË DISA HAPA KONKRETE QË JU MUND TË JENI TË GATSHËM TË NDËRMERRNI PËR PËRMIRËSIMIN E VULLNETARIZMI NË SHQIPËRI?

SUGJERIME DHE REKOMANDIME

Shtojca 3: Intervistat

Kjo intervistë realizohet në kuadër të Projektit **"VullnetrarizmipikeAL"**, i cili ka si qëllim krijimin e një mjedisi mundësues shumëdimensional, ku vullnetarizmi inkurajohet, mbështetet, njihet si mekanizëm kyç për nxitjen e qytetarisë aktive, solidaritetit dhe kohezionit social në Shqipëri.

Studimi kombëtar do të krijojë mundësinë për të analizuar situatën, perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve mbi vullnetarizmin, çfarë i shtyn që të marrin pjesë në programet e vullnetarizmit, pengesat për pjesëmarrje në vullnetarizëm. Gjithashtu, ky studim, do të analizojë infrastrukturën, mjedisin mundësues që përfshin politikat, ligjet dhe instrumentet e tjerë kryesorë që përcaktojnë dhe rregullojnë vullnetarizmin; strukturat operacionale që përfshijnë skemat e vullnetarëve, rrjetet përkatëse, programet; kapacitetet zbatuese të ofruesve të vullnetarizmit, ku përfshihen mekanizmat e financimit, kanalet e komunikimit për konsultime të institucionalizuara, standardet dhe dokumentet që përdorin për evidentimin e punës vullnetare

Kjo intervistë u drejtohet veçanërisht hartuesve të politikave dhe ofruesve të vullnetarizmit në Shqipëri, duke qenë se ata kanë rol kyç në krijimin e një mjedisi mundësues.

Të gjitha të dhënat janë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për efekt të këtij studimi.

Pyetje të përgjithshme

1. **A mund të jepni një panoramë të përgjithshme të statusit aktual dhe mundësive për vullnetarizëm në Shqipëri?**
   - *Çfarë do të thotë për ju vullnetarizëm?*
   - *Cilat janë praktikat e mira të vullnetarizmit ?*
   - *Cilat janë disa nga sfidat kryesore që ju hasni?*
   - *Cilat janë grupmoshat që përfshihen më shumë në shërbime vullnetare dhe pse?*
   - *Cilat janë arsyet që nuk përfshihen grupet e tjera në shërbime vullnetare?*

2. **Cili është roli i institucionit tuaj në lidhje me promovimin, nxitjen dhe praktikimin e vullnetarizmit në Shqipëri?**
   - *Çfarë lloj të dhënash mblidhni dhe raportoni në lidhje me vullnetarizmin?*
   - *A ka pasur iniciativa nga ana e institucioneve shtetërore që kanë pasur në fokus mbështetjen e programeve dhe nismave të vullnetarizmit? Nëse po, cilat kanë qenë ato?*

3. **Cilat janë institucionet që kanë rol kyç në promovimin, nxitjen dhe praktikimin e vullnetarizmit në Shqipëri?**

   3.1 Çfarë mendoni që duhet bërë akoma më shumë nga institucionet politikëbërëse dhe ato që ofrojnë mundësi vullnetarizmi për rritjen e pjesëmarrjes qytetarë në shërbime vullnetare?

Kuadri ligjor

5. **A mund të përmendni disa nga politikat kombëtare dhe instrumentet kryesore në mbështetje të vullnetarizmit?**

6. **Cili është kuadri strategjik?**

   - (P.sh., Strategjia për Rininë: Objektivi 6, Kultura dhe Vullnetarizmi; Roadmap for CSOs)

   - A mendoni që duhet të ketë prioritete/objektiva të tjera, të qarta?

7. **Si vlerësohet kuadri ligjor/nënligjor për çështjet e vullnetarizmit?**
   - *(Ligji për vullnetarizmin; kodi i etikës së vullnetarëve; regjistri i kontratave; libreza e vullnetarëve*
   - *A është ai i qartë dhe i plotë për të adresuar nevojat e grupeve të interesit? I përditësuar dhe në përputhje me standardet?*
   - *Cilat janë mangësitë kryesore ligjore në drejtim të zhvillimit dhe implementimit të politikave? (P.sh.,* në lidhje me pagesën e sigurimeve shoqërore/shëndetësore; ngritjen e kapaciteteve; regjistrimi i vullnetarëve;)
   - *A duhet të ketë më shumë gjithëpërfshirje në proceset konsultuese të këtyre draft-akteve?*

Kuadri institucional

8. **Në nivel qendror, cilat janë disa nga institucionet apo mekanizmat kombëtare që hartojnë, promovojnë apo implementojnë politikat për vullnetarët?**

   Nëse përmenden disa institucione:
   - *Çfarë sfidash hasni në drejtim të koordinimit institucional, ndarjen e informacionit mbi këto grupe?*
   - *Cilat janë problematikat në lidhje me funksionalitetin e institucioneve/mekanizmave?*
   - *A ka ndonjë rekomandim për ta bërë sistemin më efikas?*
   - *A janë burimet njerëzore të përshtatshme dhe të mjaftueshme?*
   - *A janë kapacitetet financiare të mjaftueshme?*
   - *A është infrastruktura adekuate?*
   - *A ka procedura standarde të qarta në lidhje me funksionimin dhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive?*
   - *Cilat janë nevojat më imediate të përmirësimit të kapaciteteve?*

9. **A jeni në dijeni të ndonjë mekanizmi në nivel vendor dhe si funksionon?**
   - *Nëse po (parashtrohen pyetjet si më sipër)*
   - *Cilat janë disa nga rekomandimet për të përmirësuar funksionalitetin e tyre?*

10. **A ka mekanizma mbikëqyrëse apo institucione ligjzbatuese për të monitoruar aspekte të vullnetarizmit?**

11. **A duhet të ketë një institucion të dedikuar kombëtar që mbron, promovon, ofron këshillim në çështjet e vullnetarizmit ?**
   - *Në opinionin tuaj, si duhet të funksionojë ky institucion dhe cilat duhet të jenë detyrat e tij?*
   - *A duhet të jetë i pavarur dhe si mund të sigurohet gjithëpërfshirja e vullnetarëve?*

12. **A ka programe të strukturuara për menaxhimin e vullnetarizmit në nivel kombëtar/ lokal?**
   - *Mund të përmendni ndonjë iniciativë dhe si funksionon?*

13. **A ka ndonjë mekanizëm ose ndonjë organ ndërinstitucional për mbledhjen dhe shkëmbim të rregullt të informacionit në lidhje me çështjen e vullnetarëve apo regjistrim** të tyre (duke përfshirë database, të dhënat mbi vullnetarët, etj)?
   - *Shërbimi Kombëtar i Punësimit: Cilat janë sfidat që has ky institucion në mbledhjen e të dhënave?*
   - *Si mendoni që mund të rregullohet mbledhja dhe shkëmbimi i informacionit?*

14. **Rekomandime**

Ky studim u realizua në kuadër të projektit

Vullnetarizmi•AL

Projekt i implementuar nga:

Beyond Barriers

CPD QPZH

Financuar nga LevizAlbania

LEVIZ Albania
Local Democracy in Action

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Vullnetarizmi në Shqipëri : studim kombëtar / përgat.
Oltiana Rama, Armela Xhaho ; red. Miranda Goleci.
– Tiranë : M & B, 2021
124 f. ; 20.5 x 29 cm.

ISBN: 978-9928-353-16-0

1.Zhvillimi shoqëror 2.Vullnetarizmi 3.Studime 4.Shqipëri

316.354.4(496.5)

ISBN 978-9928-353-16-0

Botimet M&B